



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Psikologji”

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.As.Dr. Valentina Haxhiymeri

Dr. Jonida Lesha

Shkurt / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Psikologji"**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Pedagogjisë Psikologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Psikologji
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Udhëzimi Nr. 7, datë 10.06.1996
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr. 297, datë 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i I - rë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2021-2022 18 PAE / 28 PAK Mbulimi i ngarkesës mësimore rezulton: 45.8 % PAE / 54.2 % PAK
18	Numri i studentëve:	<ul style="list-style-type: none">• 2021-2022 - 117 studentë;• 2020-2021 - 117 studentë;• 2019-2020 - 116 studentë;
19	Komente / të tjera:	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.a

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës (UT) është institucion publik i arsimit të lartë, hapur me Vendim nr.207, datë 30.05.1957 të Këshillit të Ministrave. Përgjatë viteve, ky institucion ka pësuar një sërë ndryshimesh kryesisht në strukturën e tij. Pavarësisht kësaj, UT mbetet institucioni i arsimit të lartë më i madh në vend. UT është akredituar institucionalisht me Vendim nr. 84, datë 27.10.2018 të Bordit të Akreditimit, me kohëzgjatje 4 vite. Afati i vlefshmërisë së akreditimit institucional përfundon në 26.10.2022.

Fakulteti i Shkencave Sociale, ku ofrohet programi i studimit i marrë në vlerësim është pjesë përbërëse e strukturës akademike të Universitetit të Tiranës. Fillimisht, ky fakultet është hapur me VKM nr. 348, datë 31.07.1992 me emërtim "Fakulteti i Punës Sociale". Në vitin 1993, me Urdhër nr.18 date 31.07.1993, të Ministrisë së Arsimit, fakulteti emërtohet "Fakulteti i Shkencave Sociale" duke përfshirë në strukturën e tij edhe departamentin e "Psikologjisë dhe Pedagogjisë".

Hapja e programit të studimit në "Psikologji" shënon prej vitit akademik 1996-1997, referuar Udhëzimit nr. 7 të MAS, datë 10.06.1996 "Për pranimet në shkollat e larta për vitin mësimor 1996/1997 në sistemin me shkëputje nga puna" (*Dokumenti DOC009.pdf, Pasqyra 1, Kuotat dhe datat e konkurseve (fq. 7), Rubrika: Vizita dy ditore ne IAL dhe dokumentacioni shitesë, e-ASCAL*). Bazuar në informacionin e dhënë verbalisht nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale, gjatë vizitës në institucion, datë 20.07.2022, mësohet se programi studimit në "Psikologji" është fryt i një bashkëpunimi në kuadër projekti të FSHS me fakultetet simotra të disa prej universiteteve në vendet e BE-së, i cili nisi në vitin 1993 dhe u finalizua në 1996. Fillimisht, programi u realizua me kohëzgjatje 4 vite akademike dhe përgatiti psikologë të cilët vitin e fundit të studimeve, zgjidhnin të diplomoheshin në një prej dy drejtimeve të specialitetit: psikolog klinik ose psikolog shkollor. Në vitin akademik 1999-2000 janë diplomuar studentët e parë në fushën e psikologjisë.

Aktualisht, programi i studimeve Bachelor në "Psikologji", është program i ciklit të parë të studimeve universitare, i klasifikuar në nivelin 6 të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Ky program synon të formojë psikologë të përgjithshëm. Ai përman 180 kredite ECTS, zhvillohet me një kohëzgjatje 3 vite akademike, në formën me kohë të plotë.

Programi studimeve të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji" ofrohet nga Departamenti i Pedagogjisë Psikologji, i cili vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore në fushën e psiko-pedagogjisë, në përbërje të Fakultetit të Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës (sipas Statutit të UT, 2018, Kreu II "Organizimi dhe strukturat përbërëse", Neni 11 "Njësitë përbërëse të UT", Pika 2, fq. 7).

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Ky raport prezanton rezultatet e procesit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë së programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji”, në FSHS, të UT, kryer nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), i mandatuar nga ASCAL.

Qëllimi i këtij procesi është që të sigurojë një vlerësim profesional, të pavarur dhe objektiv, të bazuar në tregues real dhe të matshëm të nivelit të arritjes së standardeve dhe garantimit të cilësisë së programit të studimit të përfshirë në vlerësim, mbi të cilin do të ngrihet gjykimi i Bordit të Akreditimit të ASCAL për akreditimin e tij. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UT, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof.As.Dr. Valentina Haxhiymeri dhe Dr. Jonida Lesha. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demireli. Vizita u realizua në datat 20 dhe 21 Korrik 2022. Për të përmbushur me sukses këtë qëllim, GVJ mori në konsideratë udhëzimet etike dhe metodologjike të bëra me dije përmes trajnimeve paraprake nga specialistë të sektorit përkatës të ASCAL.

Dokumentacioni bazë, mbi të cilin u mbështet procesi i vlerësimit të jashtëm për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji”, në FSHS, të UT, është:

- Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”,
- “Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë” miratuar me VKM Nr.824, datë 24.12.2021,
- “Raporti i Vlerësimit të Breshëm”(mars, 2022),
- Dosja e VV me një tërësi të dispozitave normative,akteve dhe dëshmime të ngarkuara nga IAL nëe-ASCAL, si dhe të dhëna të tjera të siguruar nga vizita në institucion, ushtruar në datat 20 dhe 21 korrik, 2022, sipas një agjende të paracaktuar nga ASCAL, dhe informacioni i publikuar në faqen e webit-it të IAL-së.

Parimet kryesore që udhëhoqën veprimtarinë e GVJ janë:

- Qëndrim korrekt, pa paragjykime dhe plot respekt ndaj drejtuesve të IAL-së, stafit, studentëve dhe përpjekjes së tyre për të arritur standardet dhe cilësinë e dëshiruar;
- Bashkëpunim i sqertë, nën frymën e besimit reciprok, për të siguruar një vlerësim të paanshëm, real, të mbështetur në dëshmi dhe tregues të matshëm të cilësisë;
- Objektivitet në shqyrtimin dhe prezantimin e rezultateve të vlerësimit të jashtëm lidhur me nivelin e arritjes së standardeve dhe cilësisë;
- Transparencë për të mundësuar një proces konstruktiv të rishikimit të RVJ përpara publikimit të tij.

Për mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit të jashtëm, kontribuan jo vetëm ekipi i caktuar nga ASCAL, por edhe autoritetet drejtuese, stafi dhe studentët e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji”, të FSHS, në UT, për të cilët GVJ shpreh vlerësime të posacme për gatishmërinë dhe frymën e bashkëpunimit të treguar, si dhe për sensin e mirëkuptimit dhe

besueshmërinë që ata i dhanë GVJ, duke vënë në dispozicion të tyre dokumentacionet e nevojshme për vlerësim.

Universiteti i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 06.01.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 1/4 Prot, datë 06.01.2023. Universiteti i Tiranës më datë 25.01.2023, njofton me anë të shkresës Nr. 45/3 Prot, datë 24.01.2023, "Mbi Draft Raportet e Vlerësimit të Jashtëm për programet e studimit Bsc në "Psikologji" dhe Msc në "Psikologji, me profil Psikologji Klinike".

Referuar shkresës së Institucionit të Arsimit të Lartë Publik, Universitetit të Tiranës, me Nr. 45/3 Prot., datë 24.01.2023, drejtuar Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, në përgjigje të procesit të rishikimit të përmbajtjes së Draft/Raportit të Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë së programit të studimit Bachelor në Psikologji, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shqyrtoi me vëmendje të posaçme momentet e diskutueshme të përshkruara në këtë shkresë dhe konkludoi si më poshtë:

1. Të konsiderojë pikën (a) të kësaj shkrese dhe të reflektojë duke qartësuar rekomandimin përkatës në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm (Standardi I.2, kriteri 3), në adresë të sigurimit të cilësisë së brendshme të programit të studimit të marrë në vlerësim, si vijon: *Nisur nga këto raste, GVJ rekomandon të rishikohen me kujdes lapsuset/gabimet e ndeshura në të gjitha dispozitat rregullatore dhe aktet e tjera në nivel institucional, lidhur me emërtimin e njësisë bazë që ofron programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, për të siguruar pajtueshmëri me cilësimin e shprehur në Urdhrin nr. 18 datë 31.07.1993, të Ministrisë së Arsimit dhe në Statutin e UT (2018).*
2. Përsa i përket pikës (b) të kësaj shkrese, GVJ respekton hapat e ndërmarra nga institucioni, në prill-maj, 2022, për të siguruar harmonizimin e komponentëve të Planit Mësimor (2022-2023), me bazën ligjore përkatëse, dhe e konsideron këtë iniciativë si një tregues pozitiv të kulturës së vetëpërmirësimit të vazhdueshëm. Institucioni përmend si referencë në diskutimin e tij, dokumentin "Relacion për ndryshim të planit mësimor 2022-2023 Bachelor në Psikologji", i cili nuk gjendet në e-ASCAL. GVJ sqaron se rekomandimi përkatës lidhur me Standardin II.1, kriteri 6, është bazuar në vlerësimin e Planit Mësimor që IAL ka dorëzuar në e-ASCAL me synim vlerësimin e jashtëm të cilësisë së programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji (Dokumenti 133/ 4.2 Plani mësimor i programit të studimit.pdf) dhe në këto kushte, **ky rekomandim mbetet i pandryshuar.**
3. Në pikën (c), institucioni ka komentuar mbi një kriter të cilin GVJ e ka përshkruar të përmbushur lidhur me numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, të angazhuar për realizimin e programit të studimit Bachelor në Psikologji (shiko Standardin II.2). Përsa i përket komenteve të institucionit lidhur me raportin për mbulimin e ngarkesës mësimore (orë) nga PAE/PAK (Standardi II.5), GVJ sqaron se analiza e të dhënave të vjela nga dokumenti (nr. 5/1. Te dhena te stafit te Fakultetit, Departamentit dhe programit te studimit per vitin akademik 2021-2022.pdf, fq.1-23; 32-37, Rubrika: Vizita dy ditore në institucion dhe dokumentacioni shtesë, e-ASCAL), tregon se personeli akademik me kohë të plotë (PAE) mbulon më pak se 70% të ngarkesës mësimore (orë) të programit të marrë në vlerësim. Prandaj, GVJ vendos që të **mbetet i pandryshuar rekomandimi** në adresë të institucionit për

të respektohet përcaktimet e VKM Nr. 418, datë 10.5.2017, Pika 2 (b) e tij, "Standardet për personelin akademik të IAL-së", ku specifikohet se: Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi".

4. Përsa i përket pikës (d), institucioni pranon se mospërputhjet e hasura në llogaritjen në total të ngarkesës mësimore të pasqyruar në Planin Mësimor të programit të studimit Bachelor në Psikologji, janë pasojë e një gabimi njerëzor dhe do të adresohet si duhet në të ardhmen. **Rekomandimi i GVJ për këtë çështje mbetet i pandryshuar.**
5. GVJ konstaton të drejtë sugjerimin e institucionit për pikën (e) të shkresës dhe vlerëson nevojën për të ndërhyrë në përmbajtjen e RVJ, lidhur me shtrirjen e praktikës profesionale në Planin Mësimor, duke specifikuar si vijon: *Praktika Profesionale përmban 6 kredite (150 orë) dhe zhvillohet në semestrin e parë dhe të dytë, të vitit të tretë, në përputhje përcaktimet në Nenin 23, të Rregullores së programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, 2018.*
6. Referuar pikës (g) të shkresës, GVJ e konsideron një tregues pozitiv praktikën e mirë që institucioni ka themeluar lidhur me procedurën e komunikimit individual të rezultateve të provimit të studentëve, duke vënë në rifunksionim sistemin elektronik. Por, rekomandimi nuk ka të bëjë me praktikën/procedurat konkrete që zbaton institucioni, por me dokumentet rregullatore ku bazohet kjo praktikë/procedurë (Rregullore e UT (2015), Neni 49, shprehet: *Rezultatet e provimit afishohen për çdo grup; Rregullore e FSHS (2018), Neni 36 shprehet: Rezultatet komunikohen individualisht*). **GVJ vendos që ky rekomandim të mbetet i pandryshuar** (Standardi III.6, Kriteri 8).
7. Në përgjigje të pikës (h) të shkresës, GVJ sqaron se sugjerimi përkatës është rrjedhojë e analizës së të dhënave bazuar në Standardin III.3, kriteri 4 dhe Standardin IV.3, kriteri 2. Në këtë kuadër, GVJ ka konstatuar se "...Një pjesë e syllabuseve kanë nevojë të përditësojnë literaturën duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse kryesisht të 5 viteve të fundit, janë vërejtur raste kur literatura bazë e detyruar dhe ndihmëse/rekomanduar dominohen kryesisht nga botime në gjuhë të huaj angleze (*Materiali 136/4.3.3 "Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit 2020-2021", fq. 150-151; 161; 242-243; e-ASCAL*)". Gjithashtu, referuar vizitës në IAL, GVJ ka konstatuar se mungon literatura e detyrueshme për disa lëndë në Bibliotekën e FSHS-së (element i përmendur në syllabus nga vetë lektori i lëndës). Prandaj, GVJ këshillon institucionin që të marrë në konsideratë këtë rekomandim me përmbajtjen si vijon: *Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë fondin e të librave (fizik dhe elektronik) që numëron aktualisht biblioteka e institucionit, GVJ sugjeron që të rritet përpjekja e përbashkët e stafit akademik për të siguruar përditësimin në vazhdimësi të literaturës bazë dhe ndihmëse në syllabuset lëndore, si dhe t'ju vihet në dispozicion studentëve në gjuhën e programit të studimit.* (Standardi III.3, kriteri 4).
Ndërsa, rekomandimi lidhur me Standardin IV.3, kriteri 2, **mbetet i pandryshuar në RVJ.**

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Psikologji”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti i Tiranës është një Institucioni Arsimit të Lartë i cili ofron programe studimi në përputhje tërësore me vlerat dhe interesat më të larta kombëtare. Në Statutin e UT (2018), Neni 5 i tij “Misioni”, deklarohet se “ <i>Universiteti i Tiranës është një universitet publik që ofron një gamë të plotë të programeve të nivelit bachelor, master dhe studime doktorale. Universiteti kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, përmes tre shtyllave të misionit të arsimit të lartë: kërkim shkencor, edukim, si dhe shërbim ndaj publikut...</i> ”. Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në “Psikologji” ofruar nga Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë (DPP), në FSHS, të UT-së, është në përputhje me interesat kombëtare, me Ligjin Nr.80/2015 “ <i>Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë</i> ”, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tij. Sipas “ <i>Kornizëskonceptuale të programit të studimit Bachelor në Psikologji</i> ”, ky program ka për mision ofrimin e “ <i>një programi mësimor konkurrues bazuar në cilësinë e mësimdhënies dhe kurrikulën bashkohore, për të kontribuar në përmirsimin e cilësinë e jetës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Republikës së Shqipërisë</i> ”. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji” i referohet nivelit 6 të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. (Dokumentit 4.1, e-ASCAL, fq.4).
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programet e studimeve të ofruara nga UT, përfshi edhe programin e ciklit të parë Bachelor në “Psikologji”, synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Ky synim gjen shprehje në dokumentin “ <i>Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës, 2018-2023</i> ”, seksioni “ <i>Mësimdhënia dhe Studentët</i> ”, ku mes të

<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>tjerash, theksohet se “Programet e studimit në UT kanë për qëllim të përbashkët zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për ndërtimin e konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor për rritjen e mirëqënies e dinjitetit njerëzor...”, si edhe në dokumentin “Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Pedagogji-Psikologjisë, 2020-2024”, ku shprehimish thuhet se “Në programet e ofruara, DPP është përpjekur të përshtasë traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, si dhe të praktikojë modelet më të mira kurrikulare të vendeve perndimore” (fq.7).</p>
	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin, si dhe fushën e veprimtarisë së UT-së, Fakultetit të Shkencave Sociale, Departamentit të Pedagogjisë Psikologjisë dhe (DPP). Ky kriter pasqyrohet qartë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Statutin e UT (2018), Neni 5 i tij “Misioni”, ku mes të tjerash, IAL delaron se “Ne ofrojmë edukim me në qendër studentin, si dhe nxisim rritjen personale dhe intelektuale për të përgatitur studentë për karrierë produktive dhe qytetare, të përgjegjshëm në një shoqëri globale” (fq.3); - Dokumentin “Strategjia e zhvillimit të FSHS, 2018-2023”, ku përshkruhet se “FSHS ka si mision që nëpërmjet ndërthurjes së mësimdhënies cilësore me kërkimin shkencor dhe shërbimet, të përgatisë specialistë të aftë, të pajisur me dije, aftësi dhe qëndrime që mund të marrin vendime të përgjegjshme në një botë diverse dhe që ndryshon; qytetarë me një perspective globale që mendojnë në mënyrë kritike, kanë përgjegjësi sociale, që pranojnë diversitetin dhe synojnë të ushtrojnë ndikim në zhvillimin e shoqërisë; t’i shërbejnë komunitetit akademik dhe shoqërisë si një burim informimi për shkencat sociale duke adresuar çështje me interes të përbashkët” ; - Dokumentin “Strategjia e zhvillimit të DPP, 2020-2024”, ku theksohet se nëpërmjet programeve të studimit të ofruara “DPP synon të përgatisë jo vetëm profesionistë të kualifikuar në fushën e kërkimeve psikologjike, por edhe studentë të përgjegjshëm e të kulturuar të një shoqërie që reflektojnë vlerat më të larta, morale dhe etike, në shërbim të shoqërisë, të zhvillimit cilësor dhe të qëndrueshëm të vendit”.

	<p><i>Kornizën konceptuale të programit të studimit Bachelor në Psikologji, Pika 2, e tij theksohet se “Parimet dhe kërkesat themelore të programit burojnë nga kuadri ligjor për arsimin e lartë, Statuti dhe rregullore të UT në lidhje me rregullat dhe objektivat e zhvillimit të arsimit të lartë dhe specifikisht të shprehura në formimin e psikologëve” (fq.2). Dokumentin “Rregullore e programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, 2018”, Neni 10 i tij, ku theksohet se “Misioni i programit Bachelor në Psikologji është ofrimi i njohurive bazë në fushat që lidhen drejtpërsëdrejti me shkencën e psikologjisë, si dhe i njohurive mbi degët më të aplikuara aktualisht të psikologjisë në botë e në vendin tonë. Gjithashtu, programi e pajis studentin me aftësitë kryesore të një psikologu të përgjithshëm”.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji” është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar. Fillimisht, programi është hartuar në kuadër projekti (1993-1996) në përgjigje të nevojës së ngutëshme që kishte shoqëria e kohës për specialistë në fushën e shërbimeve të shëndetit mendor (<i>informacion nga vizita në institucion, 20.07.2022</i>). Referuar dokumentit “Strategjia e zhvillimit të FSHS, 2018-2023” vërehet se një nga drejtimet e zhvillimit strategjik të institucionit është “Zhvillimi dhe përmirësimi i programeve të studimit në përgjigje të kërkesave të tregut të punës” (fq.7). Në dokumentin “Strategjia e zhvillimit të DPP, 2020-2024, Prioriteti IV, Obejktivi 8”, njësia bazë ka shpallur si objektiv strategjik “Rishikimin e kurrikulave me qëllim përshtatjen e tyre me nevojat e tregut, prioritetet e zhvillimit kombëtar, rajonal” (fq.8).</p> <p>Për të garantuar hapa të sigurt në procesin e hartimit, ristrukturimit, përmirësimit të programeve të studimit, FSHS ka përpiluar dokumentin me titull “<i>Informacion mbi politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të kurrikulave</i>” i cili i përmbahet bazës rregullatore dhe udhëzimeve përkatëse në nivel universiteti (<i>e-ASCAL, 2.16 pdf</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Institucioni ka hartuar dokumentin “Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës, 2018-2023” i cili përcakton “<i>parimet udhëzuese për zhvillimin e mëtejshëm dhe liston masat bazë që duhet të merren në mënyrë që UT-ja të përballojë sfidat e të ardhmes</i>”. Referuar këtij dokumenti institucional, FSHS ka projektuar “Strategjinë e zhvillimit të FSHS-së, 2018-2023”, dhe në vijim DPP-ja, përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në “Psikologji”, ka përshtatur “Strategjinë e zhvillimit të DPP, 2020-2024” dhe “Strategjinë e zhvillimit të programit të studimit Bachelor në Psikologji, 2020-2024”.</p> <p>Përmbajtja e këtyre dokumenteve, tregon se programi i studimit “Bachelor” në “Psikologji” është hartuar dhe ofrohet në përshtatje me me strategjinë për zhvillim të UT dhe FSHS. Megjithatë, vërehet nevoja për të harmonizuar vitet e parashikuara për zhvillim të vetë institucionit në dokumentet të prodhuara nga DPP, me dokumentet strategjike të zhvillimit të hartuara nga UT dhe FSHS.</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Në Statutin e UT (2018), Neni 89, “Për programet e studimit në ciklin e parë”, përcaktohet se “<i>Programet e studimit në ciklin e parë synojnë të japin njohuri bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithëshme dhe aftësi të caktuara në një larmi të gjërë profesionesh dhe specialitetesh</i>”. Në “Rregulloren e UT” (e ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik, nr. 26, datë 02.07.2015), Neni 31 “Për organizimin e studimeve përcaktohet se “<i>UT ofron programe studimi të akredituara, të organizuara me module dhe të vlerësuara me kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS)</i>”. Në Rregulloren e FSHS (2018), Kreu IV “Për organizimin e studimeve” përcaktohen rregullat për organizimin dhe ofrimin e programeve të studimit. Ndërsa, “Rregullore e programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji” (2018) hartuar nga DPP, ka për objekt rregullimin e veprimtarisë akademike-shkencore të programit të studimit të marrë në vlerësim (Neni 2, fq. 2).</p> <p>Statuti i UT-së dhe Rregulloret përkatëse kanë përcaktuar drejtimit prioritar akademike të institucionit dhe demonstrojnë se programet e studimit, përfshi edhe programin e ciklit të parë të studimit Bachelor në Psikologji, hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre dokumenteve.</p>

<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p><i>Megjithatë, ky kriter ka nevojë të forcohet duke siguruar koherencë institucionale përsa i përket vitit të miratimit të Rregullores së UT (2015), dhe vitit të miratimit të Statutit të UT (2018). Është e pritshme që Rregullore e UT të burojë nga Statuti i UT, dhe Rregullore e FSHS të bazohet në Rregulloren e UT. Këto dokumente rregullatore kanë nevojë të harmonizohen/rishikohen.</i></p>
	<p>Referuar Statutit të UT (2018), Kreu II “Organizimi dhe strukturat përbërëse”, Neni 11 “Njësitë përbërëse të UT”, Pika 2, përcakton se “UT përbëhet nga 8 njësi kryesore, njësitë bazë dhe njësitë e tjera”. Një nga njësitë kryesore të UT është Fakulteti i Shkencave Sociale (FSHS). Fakulteti ka në përbërje të tij 5 departamente që ushtrojnë veprimtarinë e tyre akademiko-shkencore në drejtime të caktuara të fushës sociale. Sipas Statutit (2018), njësia bazë e emërtuar “Departamenti i Psikologji-Pedagogjisë” është në përbërje të Fakultetit të Shkencave Sociale (fq. 7).</p> <p>Në Rregulloren e UT (2015) Neni 13, “Struktura Qendrore dhe e Njësive Përbërëse Kryesore”, specifikohen se një prej njësive bazë të Fakultetit të Shkencave Sociale është “Departamenti i Pedagogji Psikologjisë” (fq. 11).</p> <p>Në Rregulloren e FSHS (2018), Neni 9 “Organizimi akademik”, cilësohet se një nga njësitë bazë të FSHS është “Departamenti i Pedagogjisë dhe i Psikologjisë” (fq. 4).</p> <p>Kjo njësi bazë është përfshirë në strukturën e Fakultetit të Shkencave Sociale, me Urdhër nr. 18 datë 31.07.1993, të Ministrisë së Arsimit, nën emërtimin “Departamenti i Psikologjisë dhe Pedagogjisë”.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Psikologji” ofrohet nga “Departamenti i Pedagogjisë Psikologjisë (DPP), pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës. Kjo gjen pasqyrim në Rregulloren e ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018), Neni 8, “Statusi i programit”, pika 8.1, ku cilësohet se “Programi të jetë pjesë e ciklit të parë të studimit në Departamentin e Pedagogjisë Psikologjisë, të FSHS, në UT”.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e Departamentit të Pedagogji-Psikologjisë (2021), Neni 5, Pika 5.1, “DPP është njësi bazë që përgjigjet për cilësinë e programeve të studimit që mbulon, për kryerjen e aktivitetit mësimdhënës dhe shkencor, si edhe për shërbimet administrative që mbulon” dhe sipas Nenit 6, “Për funksionet e DPP”, ky departament “nxit, programon,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.a

bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies, veprimtarinë kërkimore-shkencore, si edhe veprimtarinë administrative”.

Referuar dokumentit “Strategjia e zhvillimit të Departamenti Pedagogji-Psikologjisë 2020-2024” mësohet seDPP ka një histori të gjatë kontributesh në fushën e pedagogjisë dhe psikologjisë .(fq.2).

Pavarësisht varietetit të emërimit të departamentit të shprehur në dokumentet rregullatore të UT/FSHS/DPP (si: *Departamenti i Psikologji-Pedagogjisë / Departamenti i Pedagogji Psikologjisë/ Departamenti i Pedagogjisë dhe i Psikologjisë” /“Departamenti i Psikologjisë dhe Pedagogjisë*), vlerësohet se emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Psikologji”të cilin ky departament ofron është në përputhje me fushat e drejtimet akademiketë vetë institucionit, pra DPP, FSHS, UT.

Megjithatë, shqyrtimi në tërësi i dokumenteve rregullatore, evidentoi se gjenden raste ku brenda një dokumenti rregullator, madje në të njëjtat Nene, emërtimi e departamentit ndryshon (p.sh. *Rregullore e ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018)*, Neni 8, pika 8.1, shprehet se “Programi të jetë pjesë e ciklit të parë të studimit në *Departamentin e Psikologjisë dhe Pedagogjisë, të FSHS, në UT*”, ndërsa pika 8.3 “Për mbarëvajtjen e zbatimit të Programit të përgjigjen Dekanati dhe *Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë*”.

Nisur nga këto raste, GVJ rekomandon të rishikohen me kujdes lapsuset/gabimet e ndeshura në të gjitha dispozitat rregullatore dhe aktet e tjera në nivel institucional, lidhur me emërtimin e njësisë bazë që ofron programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, për të siguruar pajtueshmëri me cilësimin e shprehur në Urdhrin nr. 18 datë 31.07.1993, të Ministrisë së Arsimit dhe në Statutin e UT (2018).

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi I.3

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.a

Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.


Referuar “Kornizës konceptuale të programit të studimit Bachelor në Psikologji”, Pika 3(fq.4) dhe “Rregullores së programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, 2018”, Neni 10 i tij (fq. 6), përcaktohet se programi i studimit ka për qëllim/mision “ofrimin e njohurive bazë në fushat që lidhen drejtpërsëdrejti me shkencën e psikologjisë, si dhe të njohurive mbi degët më të aplikuara aktualisht të psikologjisë në botë e në vendin tonë. Gjithashtu, programi e pajis studentin me aftësitë kryesore të një psikologu të përgjithshëm”.

Objektivat e programit të studimit janë përkrahur si më poshtë:

- Të stimulojë e të çojë në një nivel edhe më të lartë mendimin kritik nëpërmjet krijimit, zhvillimit dhe përcjelljes së dijeve, duke kontribuar në profilizimin gjithnjë e më të dallueshëm e profesional të profesionit të psikologut në shoqërinë shqiptare;
- Të lidhë fuqishëm e qartazi anën teorike me aftësimin praktik për të formuar studiues, psikologë dhe specialistë të lartë në fushën e psikologjisë, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit;
- Të ofrojë një proces koherent edukues e arsimor për studentët, të cilët do të vazhdojnë kualifikimin në nivelet e tjera të studimit të profilizuar në fushën e psikologjisë.
- Të krijohet një vizion dhe traditë e re për studimin dhe kërkimin në fushën e psikologjisë në Shqipëri në përputhje me konceptimet dhe praktikat më të përparuara dhe të suksesshme bashkëkohore;

Sipas “Kornizës konceptuale të programit të studimit Bachelor në Psikologji”, Pika 3 (fq.5), studentët në përfundim të studimeve duhet të jenë të aftë:

- ✓ Të njohin me kompetencë metodat dhe instrumentet e kërkimit psikologjik;
- ✓ Të jenë të aftë të konceptojnë, ndërtojnë dhe zbatojnë një projekt kërkimi;
- ✓ Të zotërojnë koncepte, dije dhe njohuri të plota mbi teorinë dhe paradigmat bazë psikologjike;
- ✓ Të zhvillojnë analiza teorike dhe praktike, të dukurive dhe problemeve psikosociale e individuale;
- ✓ Të jenë të aftë të shfaqin standarde të larta etike dhe formimi psikologjik për të zhvilluar me dinjitet aktivitetin e tyre në shoqëri;
- ✓ Të njohin problematikën e punës në grup dhe të zbatojnë me korrektësi afatet e punës;



- ✓ Të orientojnë karrierën e tyre si psikologë në shërbim të interesave më të larta të shoqërisë.

Në vijim të dokumentit “Korniza konceptuale e programit të studimit Bachelor në Psikologji”, Pika 7, “Për njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin”, përshkruhet se “Dijet dhe njohuritë e përvetësuara në këtë program studimit janë të orientuara drejt përvetësimit të koncepteve bazë psikologjike, teorive klasike dhe analizave kryesisht makro e mikropsikologjike bazuar mbi paradigmen e zhvillimeve psikosociale të qënies njerëzore në disa drejtime si ai biologjik, konjitiv, psikosocial, mikrosistemet dhe makrosistemet. Lidhja e ngushtë e dijeve psikologjike me kontekstin bashkëkohor, teoritë dhe paradigmat e sipërpërmendura orientojnë zhvillimin e kompetencave për hulumtimin e dinamikave psikologjike në një premisë kryesisht shumë holistike. Ky program studimi orienton studentët edhe drejt praktikave kërkimore, për të rritur aftësitë përshtatëse me tregun e punës ku researcher-i psikosocial (psikologu) po bëhet gjithnjë e ,ë i domosdoshëm” (fq. 9).

Në dokumentin “Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Bachelor në Psikologji, 2020-2024”, seksioni III “Vizioni, misioni”, (fq. 4), përcaktohet se programi është konceptuar për të formuar studentë të rinj të pajisur me:

- Këndvështrim objektiv dhe kritik në shoqërinë tonë dhe shoqëritë e tjera;
- Aftësi dhe kapacitete për të qënë një qytetar i informuar dhe me mundësi për të ndikuar zhvillimet e individit dhe grupit social apo edhe më gjërë ato shoqërore dhe zhvillimin e politikave të ndryshme;
- Mjetet konceptuale dhe metodat për të kuptuar psikologjinë e individit në mesin e konteksteve biologjike, familjare, sociale, grupale apo edhe politiko-historike, si: njohja, zhvillimi psikosocial e ai konjitiv, sjelljet e pranueshme dhe normale dhe ato që shkaktojnë disfunktion tek individit, qëndrimet e grupeve të ndryshme, vlerat, sjelljet, proceset social-politike, marrëdhëniet në sistemin ekonomik, familjar, organizatat e ndryshme dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në grupe të ndryshme institucionale, etj;

Gjenden një tërësi dokumentesh ku programi i studimit i marrë në vlerësim, ka përcaktuar objektivat për formimin e studentëve të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që ata duhet të fitojnë përgjatë dhe në përfundim të programit të

<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>studimit, si dhe që karakterizojnë profilin e programit Bachelor në Psikologji.</p> <p>FSHS, në UT, në bashkëpunim me DPP, njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit, demonstroi se ka kryer studime dhe mbledhur informata mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit Bachelor në Psikologji, jo vetëm përpara hapjes së tij në kuadër projekti gjatë 1993-1996 (kohë kur nuk ishte kriter studimi i tregut të punës), por edhe pas daljes së studentëve të diplomuar dhe në mënyrë periodike. Këto studime dhe informata përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, vecanërisht me subjektet publike/private, me të cilët FSHS është në partneritet për realizimin e praktikës profesionale, për të identifikuar kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, si dhe për të siguruar informacion për zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p> <p>Një studim i tregut të punës i ndërmarrë nga DPP, në FSHS, “<i>Alumni Bachelor në Psikologji – Rezultate të punësimit</i>” (2021), përmban të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar në programet e studimit me profil profesionin e psikologut. Duke qenë se Ligji nr. 40/2016 “Për Urdhritin e psikologut në Republikën e Shqipërisë”, përcakton disa kritere për të ushtruar të drejtën e punësimit në profesionin e psikologut, studentët e diplomuar në programin e ciklit të parë Bachelor në Psikologji nuk mund të orientohen menjëherë drejt tregut të punës. Sipas Urdhrit të Psikologut në RSH (mars, 2016), aplikantit i nevojiten 2 nivele/cikle të studimeve për të përfituar licensën e profesionit të psikologut, pra niveli/cikli i parë Bachelor në Psikologji dhe niveli /cikli i dytë Master Profesional ose Master i Shkencave në Psikologji.</p> <p>Institucioni përfiton të dhëna për nevojat, kërkesat dhe zhvillimet e pritshme në sektorin e shërbimeve psikologjike edhe nga diskutimet me kolegët e FSHS (pedagogë me kohë të plotë ose të pjesëshme) të cilët janë përfshirë aktivisht në tregun lokal të shërbimeve psikologjike dhe kontribuojnë në agjensi private/publike me ekspertizën e tyre në këtë fushë (informacion i marrë nga vizita në institucion, datë 20.07.2022).</p> <p>Referuar dokumentit “<i>Relacion për përfitimet nga marrëveshjet e praktikës profesionale për ciklin e parë të studimeve Bachelor në Psikologji</i>” (materiali 3.19, e-ASCAL) hartuar nga DPP (dokumenti nuk mban datë), raportohet se “Çdo fillim të vitit shkollor mblidhet Bordi i Tregut të Punës në një takim të përbashkët për vijimin e bashkëpunimi midis institucioneve në</p>
--	--

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.a




	<p><i>funksion të praktikës profesionale dhe të diskutimit mbi nevojat për përditësim të shprehive dhe kompetencave që tregu i punës kërkon për psikologët. Ky Bord është një strukturë mbështetëse e integruar pranë lëndës së praktikës profesionale duke filluar nga viti 2015. Si pjesë e këtij Bordi janë anëtarë të stafit akademik të DPP të cilët janë të angazhuar në realizimin e lëndës “Praktikë profesionale” në programin Bachelor në Psikologji, drejtues ose përfaqësues të institucioneve bashkëpunuese të praktikës profesionale (kryesisht psikologë, ish-alumnitë DPP) që janë pozicionuar tashmë në tregun e punës dhe vijojnë të bashkëpunojnë dhe të mbështesin institucionin përmes supervizimit të praktikave profesionale me profesionist psikolog në institucionet e tyre” (fq. 1).</i></p> <p>Tre vitet e fundit, FSHS ka ngritur dhe vënë në funksion Qendrën e Karrierës e cila bashkëpunon me departamentet përkatëse, përfshi edhe DPP në fushën e studimit të tregut të punës. Shqyrtimi i mesazheve të shkëmbyera në rrugë elektronike të përfshira në materialin “Gjurmë të njohjes së kurrikulës jashtë vendit”, tregon se institucioni ruan komunikimin në distance me ish-studentë të diplomuar në programet e studimit të ofruara nga FSHS, DPP, të cilët kanë vijuar ose përmbyllur studimet e tyre në fushën e psikologjisë në universitete të tjera jashtë vendit dhe aktualisht janë përfshirë në tregun e punës në vendet ku jetojnë. Përmes këtij komunikimi, institucioni jo vetëm mbledh informata për tregun ndërkombëtar të punës, por edhe mat, krahason dhe vlerëson nivelin cilësisë së programeve të studimit që ofron.</p> <p>Në dokumentin “Strategjia e zhvillimit të të DPP, 2020-2024”, departmenti i cili ka në përgjegjësi programin e studimit Bachelor në Psikologji, mes të tjerash ka shpallur si pjesë të vizionit/misionit të tij, “të përmirësojë kurrikulat ekzistuese të programeve të studimit sipas kërkesave dhe zhvillimeve të reja shoqërore që kushtëzohen nga dinamikat e brendëshme të shoqërisë shqiptare, nga familja politike e BE, në të cilën synon të integrohet shoqëria shqiptare, nga zhvillimet globale” (fq. 6).</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u</p>	<p>Në dokumentin “Korniza konceptuale e programit të studimit Bachelor në Psikologji”, Pika 4, “Për strukturën”, përshtrohet se “Programi i studimeve të ciklit të parë Bachelor në Psikologji është program studimesh universitar i organizuar në lëndë dhe vlerësuar me kredite sipas Sitemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të krediteve ECTS (fq.5). Referuar strukturës dhe përmbajtjes së programit të studimit, si dhe rezultateve të pritshme të të nxënit në përfundim të tij, të</p>



<p>përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>përshkruara në këtë dokument, si dhe shqyrtimit të Planit Mësimor ekzistues dhe programeve mësimore të lëndëve (materialet 4.2; 4.3, të ngarkuara në e-ASCAL), vlerësohet se programi i studimit Bachelor në Psikologji garanton përftimin e dijeve, aftësive e shkathtësive që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtëson vijimin e studimeve të studentëve në programet e ciklit të dytë në fushën e psikologjisë.</p> <p>Institucioni deklaron në RVV se “Programi i studimit Bachelor në Psikologji synon të përgatisë studentët që në përmbyllje të këtij niveli të kenë marrë dije të përgjithshme për fushën e psikologjisë dhe nëndegët e saj dhe të vijojë studimet e tij në programet Master Profesional dhe Master i Shkencave”.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.4</p>	
<p>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Sipas Statutit të UT (2018), Universiteti i Tiranës është krijuar në vitin 1957, si institucioni i parë universitar i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Shqipëri. Mbështetur në traditat dhe arritjet arsimore dhe shkencore më të përparuara të vendit dhe ato botërore, UT është vlerësuar dhe ka zënë një vend të denjë ndër institucionet arsimore e shkencore në vend (fq.2). Ai përbëhet nga 6 njësi kryesore.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Sociale, ku ofrohet programi i studimit i marrë në vlerësim është pjesë përbërëse e strukturës akademike të Universitetit të Tiranës. Fillimisht, ky fakultet është hapur me VKM nr. 348, datë 31.07.1992 me emërtim “Fakulteti i Punës Sociale”. Në vitin 1993, me Urdhër nr.18 date 31.07.1993, të Ministrisë së Arsimit, fakulteti emërtohet “Fakulteti i Shkencave Sociale” duke përfshirë në strukturën e tij edhe departamentin e “Psikologjisë dhe Pedagogjisë”.</p> <p>FSSH dhe DPP demonstrojnë se kanë përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit. Referuar dokumentit të marrë gjatë vizitës në institucion (Te dhena te stafit te Fakultetit, Departamentit dhe programit te studimit per vitin akademik</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.a

Web site: www.ascal.al

	<p>2021-2022), rezulton se Fakulteti i Shkencave Sociale për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej 326 pedagogë, nga të cilët 73 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 10 Prof. Dr; - 20 Prof. Asoc; - 42 Dr; - 1 Msc; <p>dhe 253 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 9 Prof. Dr; - 12 Prof. Asoc; - 98 Dr; - 134 Msc; <p>Ndërsa departamenti përgjegjës për vitin akademik 2021-2022, ka 22 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët 6 me titullin “Profesor”, 4 me titullin “Profesor i Asociuar”, dhe 12 me gradën “Doktor”, si dhe 105 personel akademik me kontratë (PAK) nga të cilët janë 6 me titullin “Profesor”, 4 me titullin “Profesor i Asociuar”, 43 “Doktor” dhe 52 me “Master i Shkencave”. Raporti midis PAE dhe PAK është në favor të PAK. GVJ sugjeron të sigurohet përputhje e shifrave të deklaruara në dokumentet përkatëse lidhur me të dhënat/numrin e personelit akademik në nivel fakulteti dhe departamenti. (Shiko dokumentet “<i>Të dhënat e stafit të Fakultetit, Departamentit dhe programit të studimit për vitin akademik 2021-2022</i>”, Materiali nr. 5, Seksioni “<i>Vizita dy ditore në IAL, dhe domumentacioni shtesë, e-ASCAL</i>”).</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Në dokumentin “<i>Strategjitë e zhvillimit të FSHS, 2018-2023</i>”, FSHS, njësia kryesore ku ofrohet programi i studimit Bachelor në Psikologji, deklaroi se vizioni i saj është “<i>të jetë një institucion elitar në arsimin e lartë, vatër e mësimdhënies me standardet evropiane, qendër e rëndësishme e kërkimit shkencor në fushat sociale në Shqipëri dhe në Rajon, ofruar shërbimesh për komunitetin, agjent i ndryshimit të shoqërisë shqiptare</i>”. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në Psikologji është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të FSHS-së, njësisë kryesore përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me</p>	<p>Në Rregulloren e DPP, 2021, Neni 6, pika 6.2 (fq. 3) përcaktohet se:</p>

<p>fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>a) DPP ofron programe studimi të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, ku organizimi struktura dhe përmbajtja e këtyre programeve, ofrohen në përputhje të plotë me fushat dhe drejtimit akademike të DPP-së, si dhe në përputhje të plotë me klasifikimin/kodifikimin e programeve të studimit sipas legjislacionit shqiptar të fushës, si edhe direktivave evropiane në ato raste kur këto direktiva janë ratifikuar nga RSH;</p> <p>b) DPP përgjigjet për formulimin e profileve, si edhe të përmbajtjeve lëndore, për diplomat e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë së studimit që ndodhen nën administrimin e tij;</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në Psikologji është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të DPP, njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>FSHS, në UT, i cili ofron programin e studimit Bachelor në Psikologji, demonstroi angazhimin e tij, bazuar në Ligjin nr. 80/2015 për AL, Statutin e UT (2018), dokumentet rregullatore, udhëzimet dhe aktet të tjera ligjore e nënligjore, lidhur me hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit përkatës, sigurimin e marrëdhënieve të bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Sipas Rregullores së FSHS (2018), Neni 4 “Për rregulloret e brendshme”, deklarohet si vijon:</p> <p>1. FSHS përdor rregullore të brendshme për aspekte të ndryshme të veprimtarisë dhe për struktura të caktuara të cilat miratohen nga organet dhe autoritetet drejtuese përkatëse të FSHS;</p>

2. Rregulloret e njësive bazë dhe të strukturave ndihmësakadematike dhe administrative shtrijnë efektin në njësitë dhe strukturat përkatëse, mbi personelin, studentët dhe bashkëpunëtorët e tyre;

Në Rregulloren e DPP (2021), Neni 5 "Organizimi i DPP", përcaktohet se "DPP është njësia bazë që përgjigjet për cilësinë e programeve të studimit që mbulon, për kryerjen e aktivitetit mësimdhënës dhe shkencor, si edhe për shërbimet administrative që mbulon", dhe në Nenin 6, "Funksionet e DPP", pika 1 e tij, përkufizohet se "DPP nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies, veprimtarinë kërkimore-shkencore, si edhe veprimtarinë administrative", dhe në Nenin 8 "Përgjegjësitë e drejtuesit të DPP", Pika 8.1 "Kompetencat e Drejtuesit të Departamentit në drejtim të mësimdhënies", përshkruhet si vijon:

- a. Kujdeset për mbarëvajtjen e programeve të studimit të tre cikleve të studimit, si dhe programeve të lëndëve që menaxhon, duke bashkëpunuar me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Institucionit;
- b. Miraton dhe ndjek zbatimin e planit strategjik për zhvillimin e programeve të studimit të departamentit, në përputhje me planin strategjik të zhvillimit të FSHS, si edhe kryen studime periodike të tregut të punës. Etj;



Ndërsa në Nenin 11 të këtij dokumenti "Për përgjegjësitë e koordinatorëve të programeve të studimit që mbulon DPP", deklarohet se "Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin, për çdo program studimi cakton një person në rolin e Koordinatorit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse".

Në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në Psikologji (2018), Neni 2 i tij, përcakton se "Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë akademike-shkencore në programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor në Psikologji që DPP ofron" dhe në vazhdim, pika 1.1, nënvizon se "Rregullorja përcakton rregullat e zhvillimit të programit të studimeve Bachelor në Psikologji dhe të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve që ofrojnë dhe sigurojnë cilësinë e programit".

Në Nenin 12 të këtij dokumenti "Për koordinatorin e programit të studimit që mbulon DPP", përshkruhet se "Koordinatori i programit të studimit ka këto përgjegjësi:

	<p>1. <i>Raporton të gjitha problematikat në lidhje me programin e studimit të përgjegjësi i njësisë bazë dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me to.;</i></p> <p>2. <i>Disponon informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën, si dhe përmbajtjen e programit të studimit, etj.”;</i></p> <p>Përshkrimi i detyrave në ngarkim të koordinatorit të programit të studimit Bachelor në Psikologji, janë theksuar edhe me shkresë të posaçme të Drejtuesit të DPP (materiali 3.12, e-ASCAL)</p> <p>Relacioni mbi zhvillimin e mësimdhënies në programin Bachelor në psikologji, datë 17.09.2021 (materiali 3.18, e-ASCAL), përpiluar nga koordinatori i këtij programi, drejtuar përgjegjësit të DPP, përbën një praktikë të mirë pune dhe është një tregues tjetër i bashkëpunimit të frytshëm brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive, dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>FSHS, si pjesë përbërëse e UT, dëshmon përmes “<i>Listës së marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partnerëve për praktikën profesionale</i>” (materiali 4.17, e-ASCAL) se ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm të institucioneve homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me institucione publike, qendra të shërbimit psiko-sociale, agjensi e biznese private, organizata të ndryshme joqeveritare, etj, për të realizuar objektivat e procesit mësimor e formues të studentëve të cilët ndjekin programet e studimit të ofruara nga FSHS, duke përfshirë edhe ata që ndjekin programin e studimit Bachelor në Psikologji. Lista marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partnerëve për praktikën profesionale të UT/FSHS/DPP:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Qendra Jonathan 2. Shoqata Komuniteti Papa Xhovani i XXIII 3. Bashkia Tiranë 4. Universiteti i Lozanës 5. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë 6. Risi Albania 7. Komiteti Shqiptar i Helsinkit 8. Zyra Vendore Arsimore Tiranë 9. Shërbimi i Provës, Tiranë 10. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve 11. Universiteti i Studimeve në Tuscia (UNiTUS) 12. Universiteti "Nënë Tereza", Shkup 13. Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Shqipëri

	<ol style="list-style-type: none"> 14. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve 15. Albanian University 16. Agjensia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës 17. Universiteti i Europës Juglindore në Maqedoninë e Veriut 18. Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor Nr. 2 19. Shërbimi Social Shtetëror 20. Zurich University of Teacher Education 21. Albanian American Development Foundation 22. Save the Children 23. Universiteti i Zadarit 24. Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren 25. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve 26. Zyra Vendore Arsimore Tiranë 27. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>DPP, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të marrë në vlerësim, dëshmon se harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve, përfshi edhe programin e studimit Bachelor në Psikologji.</p> <p>Referuar dokumentit “<i>Relacion për përfitimet nga marrëveshjet e praktikës profesionale për ciklin e parë të studimeve Bachelor në Psikologji</i>” (materiali 3.19, e-ASCAL) hartuar nga DPP (dokumenti nuk mban datë), raportohet se “<i>Çdo fillim të vitit shkollor mblidhet Bordi i Tregut të Punës në një takim të përbashkët për vijimin e bashkëpunimi midis institucioneve në funksion të praktikës profesionale dhe të diskutimit mbi nevojat për përditësim të shprehive dhe kompetencave që tregu i punës kërkon për psikologët.</i> (fq. 1)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>FSHS dëshmon se vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit Bachelor në Psikologji.</p> <p>Formati standardi aplikuar nga FSHS/DPP “<i>Marreveshje bashkëpunimi ndërmjet FSHS/DPP dhe institucionit për zhvillimin e praktikës në institucion</i>” (materiali 3.27, e-ASCAL), dokumenton bashkëpunimin ndërinstitucional mbi bazën e përgjegjësisve reciproke lidhur me kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës profesionale. Pavarësisht se formati i ngarkuar në e-ASCAL, i adresohet marrëveshjes ndërinstitucionale për zhvillimin e praktikës profesionale me studentë të programit Master Shkencor, është e mundur se një format i ngjashëm</p>

	<p>ekziston edhe për zyrtarizimin e marrëveshjes për praktikën profesionale të studentëve të programit Bachelor në Psikologji. Gjithashtu, angazhimi i FSHS/DPP për të institucionalizuar bashkëpunimin me punëdhënësit për mbarëvajtjen e praktikës profesionale të programit të studimit Bachelor në Psikologji, dëshmohet edhe me ngritjen e një strukture të posaçme mbështetëse të integruar pranë lëndës së praktikës profesionale, të quajtur Bordi i Tregut të Punës, i cili “Çdo fillim të vitit shkollor mbledhet në një takim të përbashkët për vijimin e bashkëpunimit midis institucioneve në funksion të praktikës profesionale...” (sipas dokumentit “Relacion për përfitimet nga marrëveshjet e praktikës profesionale për ciklin e parë të studimeve Bachelor në Psikologji” (materiali 3.19, e-ASCAL).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Dokumenti i hartuar nga DPP, datë 16.12.2021 “Raport përmbledhës për trajnimet profesionale për studentët e diplomuar apo në proces diplomimi në programet Bachelor në Psikologji dhe Master Shkencor Klinik ofruar nga stafi i DPP” (2018 – 2021) (materiali 4.15, e-ASCAL), dëshmon se FSHS/DPP ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar dhe ata në proces diplomimi, në bashkërendim me punëdhënësit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Niveli i Përbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	Niveli i Përbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR


Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuaranë lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Ligji nr. 80/2015 për AL, Kreu VII “Për organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë”, Neni 69 “Për format e studimeve dhe pranimit në institucionet e arsimit të lartë”, Pika 2 e tij, mes të tjerash përcakton se “Programet e studimit, që japin të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, organizohen vetëm në formën e studimeve me kohë të plotë”. Në Nenin 70 të Ligjit nr. 80/2015 për AL, “Për ciklet dhe programet e studimeve”, Pika 1, 2 dhe 4, shprehen si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë programe të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);</i> 2. <i>Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite;</i> <p>Në Nenin 73, “Për programet e ciklit të parë të studimeve”, Pika 1, përcaktohet se “Programet e ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike”;</p> <p>Përcaktimet e Ligjit nr. 80/2015 për AL janë pasqyruar në “Rregulloren e UT” (e ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik, nr. 26, datë 02.07.2015), ku përmes Nenit 31 “Për organizimin e studimeve” deklarohet se “UT ofron programe studimi të akredituara, të organizuara me module dhe të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS)”.</p> <p>Në Rregulloren e FSHS (2018), Kreu IV “Për organizimin e programeve”, Neni 21, pika 2, shprehet se “FSHS ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sipas pikës 2 të këtij neni, “Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite. Një krediti të studimeve universitare i korrespondojnë 25 orë</p>

	<p><i>mësimore pune të studentit, ku 10 deri 12 orë punë duhet të jenë në auditor”.</i></p> <p><i>Referuar dokumentit “Korniza konceptuale e programit të studimit Bachelor në Psikologji”, Pika 4, “Për strukturën”, përshkruhet se “Programi i studimeve të ciklit të parë Bachelor në Psikologji është program studimesh universitar i organizuar në lëndë dhe vlerësuar me kredite sipas Sitemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të krediteve ECTS (fq.5).</i></p> <p><i>Sipas Rregullores së ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018), Neni 8 “Për statusin e programit”, Pika 8.2, cilësohet se “Programi është me kohë të plotë me 180 ECTS”.</i></p> <p><i>Bazuar në dokumentet e cituara më sipër, programi i studimit Bachelor në Psikologji është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji” i referohet nivelit 6 të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p><i>Programi i studimeve të ciklit të parë Bachelor në Psikologji synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në fushën e psikologjisë. Ky synim gjen shprehje në dokumentet rregullatore të UT/FSHS/DPP.</i></p> <p><i>Në Statutin e UT (2018), Neni 89, “Për programet e studimit në ciklin e parë”, përcaktohet se “Programet e studimit në ciklin e parë synojnë të japin njohuri bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithëshme dhe aftësi të caktuara në një larmi të gjërë profesionale dhe specialitetesh”.</i></p> <p><i>Në Rregulloren e programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, (2018), Neni 10 i tij, ku theksohet se “Misioni i programit Bachelor në Psikologji është ofrimi i njohurive bazë në fushat që lidhen drejtpërsëdrejti me shkencën e psikologjisë, si dhe i njohurive mbi degët më të aplikuara aktualisht të psikologjisë në botë e në vendin tonë. Gjithashtu, programi e pajis studentin me aftësitë kryesore të një psikologu të përgjithshëm”.</i></p> <p><i>Në dokumentin “Strategjia e zhvillimit të DPP, 2020-2024”, ku shprehet se nëpërmjet programeve të studimit të ofruara “DPP synon të përgatisë jo vetëm profesionistë të kualifikuar në fushën e kërkimeve psikologjike, por edhe studentë të përgjegjshëm e të kulturuar të një shoqërie që reflektojnë vlerat më të larta, morale</i></p>

<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p><i>dhe etike, në shërbim të shoqërisë, të zhvillimit cilësor dhe të qëndrueshëm të vendit”.</i></p>
	<p>Programi i studimeve të ciklit të parë Bachelor në Psikologji jep njohuri të përparuara në fushën e studimit përkatës dhe punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. Ky kriter është përshkruar në:</p> <p>1) Dokumentin “<i>Korniza konceptuale të programit të studimit Bachelor në Psikologji</i>”, Pika 3 (fq.4) dhe “<i>Rregullores së programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, 2018</i>”, Neni 10 i tij (fq. 6), ku përcaktohet se programi i studimit ka për qëllim/mision “<i>ofrimin e njohurive bazë në fushat që lidhen drejtpërsëdrejti me shkencën e psikologjisë, si dhe të njohurive mbi degët më të aplikuara aktualisht të psikologjisë në botë e në vendin tonë</i>”;</p> <p>Sipas këtij dokumenti, objektivat e programit të studimit janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Të stimulojë e të çojë në një nivel edhe më të lartë mendimin kritik nëpërmjet krijimit, zhvillimit dhe përcjelljes së dijeve, duke kontribuar në profilizimin gjithnjë e më të dallueshëm e profesional të profesionit të psikologut në shoqërinë shqiptare; ✓ Të lidhë fuqishëm e qartazi anën teorike me aftësimin praktik për të formuar studiues, psikologë dhe specialistë të lartë në fushën e psikologjisë, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit; ✓ Të ofrojë një proces koherent edukues e arsimor për studentët, të cilët do të vazhdojnë kualifikimin në nivelet e tjera të studimit të profilizuar në fushën e psikologjisë; ✓ Të krijohet një vizion dhe traditë e re për studimin dhe kërkimin në fushën e psikologjisë në Shqipëri në përputhje me konceptimet dhe praktikatat më të përparuara dhe të suksesshme bashkëkohore; <p>2) Dokumentin “<i>Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Bachelor në Psikologji, 2020-2024</i>”, seksioni III “<i>Vizioni, misioni</i>”, (fq. 4), përcaktohet se programi është konceptuar për të formuar studentë të rinj të pajisur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Këndvështrim objektiv dhe kritik në shoqërinë tonë dhe shoqëritë e tjera; ✓ Aftësi dhe kapacitete për të qënë një qytetar i informuar dhe me mundësi për të ndikuar zhvillimet e individit dhe grupit social apo edhe më gjërë ato shoqërore dhe zhvillimin e politikave të ndryshme;




	<p>✓ Mjetet konceptuale dhe metodat për të kuptuar psikologjinë e individit në mesin e konteksteve biologjike, familjare, sociale, grupale apo edhe politiko-historike, si: njohja, zhvillimi psikosocial e ai konjitiv, sjelljet e pranueshme dhe normale dhe ato që shkaktojnë disfunkcion tek individit, qëndrimet e grupeve të ndryshme, vlerat, sjelljet, proceset social-politike, marrëdhëniet në sistemin ekonomik, familjar, organizatat e ndryshme dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në grupe të ndryshme institucionale, etj;</p> <p>3) <i>Rregulloren e programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, (2018), Neni 19 "Plani mësimor",</i> ku shprehet se "Plani mësimor ka karakter shumëdisiplinar. Bachelor në "Psikologji" është një program studimi, i cili ofron udhëkryqet e disa disiplinave njëherazi me një gamë të përgjithshme dhe karakterizuese (histori e psikologjisë, psikologjia sociale, teoritë e personalitetit, sociologjia, psikologjia e zhvillimit, psikologjia anormale, ajo kognitive, e shëndetit, psikologjia e punës, psikofiziologjia, psikologjia shkollore, këshillimi e psikoterapia, etj.) integruese duke i lidhur të gjitha këto me shumë disiplina të tjera (metoda kërkimi, përpunim statistikor i të dhënave, hyrje në ekonomi, psikologji gjinore, psikologji sportive, komunikim, biologji e anatomi e sistemit nervor, menaxhim stresi), apo edhe disiplina që formojnë aftësim (shkrim akademik, metoda kërkimi, gjuhë e huaj) dhe praktikë.</p> <p>Kurrikula e studimeve në Ciklin Bachelor në Psikologji kombinon dhe harmonizon dimensionin teorik në fushën e psikologjisë botërore me kontekstin shqiptar. Ky program i mundëson studentit që të njihet me fushat e thelluara të studimit pasuniversitar, duke bërë të mundur një zgjedhje më të informuar në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimeve të ciklit të parë Bachelor në Psikologji zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike përkatëse dhe profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. Ky kriter dëshmohet në:</p> <p>Dokumentin "<i>Korniza konceptuale të programit të studimit Bachelor në Psikologji</i>", Pika 3(fq.5), ku deklarohet se: Studentët, në përfundim të studimeve, duhet të jenë të aftë:</p> <p>✓ Të njohin me kompetencë metodat dhe instrumentet e kërkimit psikologjik;</p>

- ✓ Të jenë të aftë të konceptojnë, ndërtojnë dhe zbatojnë një projekt kërkimi;
- ✓ Të zotërojnë koncepte, dije dhe njohuri të plota mbi teorinë dhe paradigmat bazë psikologjike;
- ✓ Të zhvillojnë analiza teorike dhe praktike, të dukurive dhe problemeve psikosociale e individuale;
- ✓ Të jenë të aftë të shfaqin standarde të larta etike dhe formimi psikologjik për të zhvilluar me dinjitet aktivitetin e tyre në shoqëri;
- ✓ Të njohin problematikën e punës në grup dhe të zbatojnë me korrektësi afatet e punës;
- ✓ Të orientojnë karrierën e tyre si psikologë në shërbim të interesave më të larta të shoqërisë.

Në vijim të dokumentit “Korniza konceptuale e programit të studimit Bachelor në Psikologji”, Pika 7, “Për njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin”, ku përshkruhet se “Dijet dhe njohuritë e përvetësuara në këtë program studimit janë të orientuara drejt përvetësimit të koncepteve bazë psikologjike, teorive klasike dhe analizave kryesisht makro e mikropsikologjike bazuar mbi paradigmen e zhvillimeve psikosociale të qënies njerëzore në disa drejtime si ai biologjik, konjitiv, psikosocial, mikrosistemet dhe makrosistemet. Lidhja e ngushtë e dijeve psikologjike me kontekstin bashkëkohor, teoritë dhe paradigmat e sipërpërmendura orientojnë zhvillimin e kompetencave për hulumtimin e dinamikave psikologjikenë një premisë kryesisht shumë holistike. Ky program studimi orienton studentët edhe drejt praktikave kërkimore, për të rritur aftësitë përshtatëse me tregun e punës ku researcher-i psikosocial (psikologu) po bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm” (fq. 9).

Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.

Ligji nr. 80/2015 për AL, Neni 71, “Për programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë”, Pika 2 e tij, përcakton se “Elementet, që duhet të përmbajnë programet e studimit, të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Sipas VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, Pika 2, shprehet se: Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të, konsistojnë në:

- a) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);
- b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;
- c) objektivat formues dhe kompetencat profesionale;

	<p>c) <i>veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;</i></p> <p>d) <i>kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;</i></p> <p>dh) <i>planin mësimor;</i></p> <p>e) <i>kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;</i></p> <p>ë) <i>programin lëndor (Syllabus-et);</i></p> <p>f) <i>profilin e programit;</i></p> <p>g) <i>diplomën dhe suplementin</i></p> <p>Programi i studimeve të ciklit të parë Bachelor në Psikologji përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, Pika 2.4/a “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, përcakton se: Veprimtaritë formuese që karakterizojnë një program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në:</p> <ol style="list-style-type: none"> i. mësim në auditor, si leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor; ii. studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektsh; iii. përgatitje për provime; iv. përgatitje e tezës së diplomës; v. veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private; <p>Referuar dokumentit “Korniza konceptuale e programit të studimit Bachelor në Psikologji”, Pika 4 (fq.6) “Struktura dhe karakteristikat e programit të studimit” shprehet se: Veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime) - studimi individual (hulumtimi, kërkimi, studimi individual, punim relacionesh, detyrat apo projektet, përgatitjet e provimeve, përgatitja e tezës së diplomës, etj.) - veprimtari të tjera të lidhura ngushtësisht me aspekte profesionale, si praktika jashtë auditorit pranë institucioneve, sipërmarrjes private dhe organizatave të ndryshme joqeveritare.

Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera janë organizuar në disa kategori lëndësh me 180 kredite.

Të dhënat e paraqitura në dokumentin "Korniza konceptuale e programit të studimit Bachelor në Psikologji" dhe në Planin Mësimor 2020-2021 (Material, 84, 85, e-ASCAL), janë analizuar, organizuar në % dhe krahasuar me përcaktimet në VKM nr. 41/2018, për kategorizimin e komponentëve mësimorë të programit të ciklit të parë, rezultatet e të cilave janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Kateg.	Përshkrimi	Sipas VKM 41/2018	Sipas planit mësimor	Sipas kornizës konceptuale
A	Lëndë Bazë	15%-20%	8.9 %	8.8 %
B	Lëndë karakterizuese	50%-55%	54.5 %	54.44 %
C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12%-15%	30 %	29 %
D	Lëndë plotësuese	10%-15%	3.3 %	5.5
E	Detyrime përmbyllëse	3%-5%	3.3 %	3.3 %

Krahasimi i krediteve të shprehura në % për çdo kategori të programit të studimit Bachelor në Psikologji të përshkruara në dokumentin "Korniza konceptuale..." me kreditet e shprehura në % të paraqitura në Planin Mësimor 2020-2021 dhe krediteve shprehura në % të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018, Shtojca (Tabela 1) për programet e ciklit të parë, nxjerr në pah se disa të dhëna që nuk përquasen.

Shqyrtimi i tyre tregon se gjenden më pak lëndë mësimore të kategorisë A (Lëndë bazë) në Planin Mësimor të shprehura në 8.9% të krediteve, në raport me 15% - 20% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori;

Gjithashtu, gjenden më shumë lëndë mësimoretë kategorisë C (Lëndë ndërdisiplinore) në Planin Mësimor të shprehura në 30% të krediteve, në raport me 12% - 15% kredite të përcaktuara në VKM, nr. 41/2018 për këtë kategori;

Në përmbajtjen e "Planit Mësimor, 2020-2021" konstatohet se gjenden 12 lëndë/module të kategorisë C (7 lëndë të detyrueshme

dhe 5 lëndë me zgjedhje), nga 7 lëndë të deklaruara nga institucioni në dokumentin “Korniza konceptuale e programit të studimit Bachelor në Psikologji”, duke ndikuar në rritjen e % së kësaj kategorie (fq.5-6);

Si dhe, gjenden më pak lëndë mësimore të kategorisë D (Lëndë plotësuese) në Planin Mësimor të shprehura në 3.3% të krediteve, në raport me 10% - 15% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori;

Rezultatet e vlerësimit për kriterin 6, të standardit II.1, tregojnë se programi i studimeve të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, ka të specifikuar veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, por vërehet se disa kategori të programit nuk përqasen me përcaktimet lidhur me ngarkesën respektive në kredite.

Për sa më sipër GVJ sugjeron, që të rishikohet shpërndarja e ngarkesës përkatëse në kredite me qëllim që të për afrohet / pajtohet me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, si dhe të harmonizohen të dhënat në dokumentet bazë të programit të studimit, si Korniza konceptuale e programit dhe Plani Mësimor.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet		
	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
		X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Struktura akademike e Fakultetit ndahet në Departamente, me personel akademik efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK). Fakulteti i Shkencave Sociale përbëhet nga 5 departamente. Programi i studimi Bachelor në Psikologji, ofrohet nga Departamenti i Pedagogjisë Psikologjisë. Referuar të dhënave në DVV, ky departament plotëson detyrimin ligjor duke patur numrin prej 22 pedagogësh me tituj dhe grada, në kuadër të vlerësimit dhe akreditimit.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo	Në Rregulloren e Departamentit të Pedagogji-Psikologjisë (2021), Neni 11, dhe në Rregulloren e ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018), Neni 12, “Përgjegjësitë e koordinatorëve të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.a

Web site: www.ascal.al

program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.

programeve të studimit që mbulon DPP” përcaktohet se “Njësisia kryesore/bazë përgjegjëse për programin, për çdo program studimi cakton një person në rolin e Koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse”.

Në zbatim të Rregulloreve respektive, DPP ka marrë “Vendim për caktimin e Koordinatorit të Bachelor në Psikologji” (2020) (aktit administrativ i mungon data, shiko material, 3.11, e-ASCAL).

Bazuar në këto dokumente, Përgjegjësi i DPP ka hartuar një shkresë të posaçme “Për përshkrimin e detyrave të koordinatorit të programit Bachelor në Psikologji” (akti administrativ nuk mban datë/vit, shiko material, 3.12, e-ASCAL). Sipas këtij akti administrativ, koordinatori i programit të studimit ka këto përgjegjësi: raporton të gjitha problematikat në lidhje me programin e studimit te përgjegjësi i njësisë bazë dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me to; disponon informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën, si edhe përmbajtjen e programit të studimit; koordinatori i programit të studimit në fillim të çdo semestri njofton me përgjegjshmëri në mënyrë individuale në adresat e tyre elektronike, stafin akademik me kohë të pjesshme të programit të studimit, në lidhje me fillimin e procesit mësimor, ngarkesën mësimore të parashikuar për ta, sylábusin e lëndës që do të mbulojnë, si edhe orarin mësimor. Për çdo komunikim elektronik të bërë, përgjegjësi i njësisë bazë duhet të jetë me lidhje cc., etj.

Referuar dokumentit “Relacion mbi zhvillimin e mësimdhënies në programin Bachelor në Psikologji” (17.09.2021) (materiali 3.18, e-ASCAL), dëshmohet se Koordinatori i Programit përpilon relacion vjetor për mbarëvajtjen e procesit mësimor të programit.

Gjatë vizitës në institucion (20-21, korrik, 2022), Koordinatorja e Programit “Bachelor në Psikologji”, shpjegoi se “Caktimi i Koordinatorit të Programit ka për qëllim të lehtësojë punën e DPP dhe të sigurojë mbarëvajtjen e programit të studimit, ecurinë e mësimdhënies në program, si dhe të raportojë Përgjegjësi i Departamentit mbi problematikat e ndeshura në procesin mësimor, për të marrë masa e nevojshme dhe siguruar zgjidhje në kohë sa të shpejtë”.

Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, edhe studentët e programit të studimit Bachelor në Psikologji, konfirmuan ruajtjen e komunikimit të vazhdueshëm me Koordinatorin e Programit

	përkatës. Ata u shprehën se “ <i>Problemet e tyre kanë marrë zgjidhje të shpejtë, për raste të tilla si: mbingarkesa me detyra, orari mësimor, nevoja për konsultime shtesë, rishikim i vlerësimeve, etj.)</i> ”.															
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Në Ligjin nr. 80/2015 të AL, Neni 23, “Fakulteti”, përkufizohet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura; 2. Fakulteti ofron programe të studimeve të cikleve të ndryshme, në përputhje me llojin e institucionit të arsimit të lartë; 3. Fakulteti organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente; 															
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>FSHS i cili ofron programin e studimit të marrë në vlerësim, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike, të përshkruara edhe në Statutin të UT-së (2018), Neni 11 “<i>Njësitë përbërëse të UT</i>”, ku shprehimisht përcaktohet se “FSHS përbëhet nga:</p>															
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Psikologji-Pedagogjisë; 2. Departamenti i Punës dhe Politikave Sociale; 3. Departamenti i Filozofisë; 4. Departamenti i Sociologjisë; 5. Departamenti i Shkencave Politike. <p>Dekanati është organ iolegjial që drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Dekani b) Zëvendësdekanët c) Administratori i njësisë kryesore d) Drejtuesit e njësive bazë <p>Referuar dokumentit (nr. 5/1. <i>Te dhena te stafit te Fakultetit, Departamentit dhe programit te studimit per vitin akademik 2021-2022.pdf, fq.1, Rubrika: Vizita dy ditore ne institucion dhe dokumentacioni shtese, e-ASCAL</i>), Fakulteti i Shkencave Sociale në vitin akademik 2021-2022, ka 326 staf akademik gjithsej, ku 73 janë pedagogë efektiv, dhe 253 pedagogë me kontratë.</p> <table border="1" data-bbox="528 1615 1350 1921"> <thead> <tr> <th>Fakulteti i Shkencave Sociale</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td>10</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>Prof. As. Dr.</td> <td>20</td> <td>12</td> </tr> <tr> <td>Dr. / PhD.</td> <td>42</td> <td>98</td> </tr> <tr> <td>MSc.</td> <td>1</td> <td>134</td> </tr> </tbody> </table>	Fakulteti i Shkencave Sociale	PAE	PAK	Prof. Dr.	10	9	Prof. As. Dr.	20	12	Dr. / PhD.	42	98	MSc.	1	134
Fakulteti i Shkencave Sociale	PAE	PAK														
Prof. Dr.	10	9														
Prof. As. Dr.	20	12														
Dr. / PhD.	42	98														
MSc.	1	134														

Në total	73	253
Totali	326	

GVJ konstaton se Departamenti i Psikologji Pedagogjisë, në vitin aktual 2021-2022, ka **127 personel akademik gjithsej**, 22 pedagogë me kohë të plotë dhe 105 pedagogë me kohë të pjesshme.

Njësia bazë Departamenti i Psikologji Pedagogjisë, përgjegjës për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin minimal të përcaktuar në nenin 25 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë:

Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021		2019-2020	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	6	6	2	-	2	-
Prof. Asoc.	4	4	1	-	1	-
Dr./PhD.	12	43	6	3	6	3
Msc.	-	52	-	3		3
Totali	22	105	9	6	9	6

Tabela pasqyron të dhënat sipas dokumentit nr. 5/1. Te dhëna te stafit te Fakultetit, Departamentit dhe programit te studimit per vitin akademik 2021-2022.pdf, fq.1, Rubrika dy ditore në institucion dhe dokumentacioni shtesë, e-ASCAL, dhe dokumentit nr. 81/4.6 Te dhenat tabekore per personelin akdemik te programit te studimit.pdf, “Tabelat përmbledhëse” (fq. 7, 9), postuar nga DPP per programin MSc ne Psikologji Klinike, e-ASCAL.

Për sa më sipër Njësia kryesore (FSHS) dhe njësia bazë (DPP) përgjegjëse për programin e studimit të marrë në vlerësim, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për:

- numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme;
- organizimin dhe strukturën akademike;

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.

Në Rregulloren e FSHS (2018), Kreu IV “*Organizimi i studimeve*”, në tërësinë e neneve të tij, përcaktohet baza rregullatore për organizimin dhe zhvillimin e programeve të studimit të ofruara nga FSHS.

Nëpërmjet “*Kornizës konceptuale të programit të studimit Bachelor në Psikologji*”, FSHS/DPP ofron informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit të ciklit të parë të marrë në vlerësim.

Në Rregulloren e programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018), Neni 2 i tij, “*Objekti*”, pika 1.2 shprehet se “*Rregullorja përcakton misionin dhe qëllimin e programit, organizimin e kurrikulës së tij, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, personelit akademik dhe administrative që ofrojnë dhe sigurojnë programin, të studentëve, të bashkëpunëtorëve të jashtëm, raportet midis tyre, rregullat e pranimit të studentëve, procesin e të nxënies, kërkimin shkencor, praktikën, vlerësimin, diplomimin, publikimet, të drejtat dhe detyrimet e studentëve, rekrutimin e personelit dhe sanksionet në rastin e shkeljes së rregullores*” (fq.3)

Gjithashtu, Plani Mësimor i programit të studimit Bachelor në Psikologji (2021-2022) përmban informacionet e nevojshme për strukturën dhe përmbajtjen e programin e studimit të ciklit të parë të marrë në vlerësim.

FSHS/DPP ka publikuar dokumentin “*Rregullore e diplomimit*” (2020), ku përshkruhen procedurat e diplomimit të studentëve në programeve të studimit Bachelor, Master professional, Master i Shkencave dhe përcaktohen përgjegjësitë e strukturave akademike, ndihmësakadematike dhe administrative të përfshira në procesin e diplomimit...” (Materiali 2.11, e-ASCAL).

DPP ka përgatitur dokumentin “*Paketa e provës finale për mbrojtjen e diplomës Bachelor në Psikologji*” (2018) (Materiali 4.5, e-ASCAL).

Bazuar në dokumentet e mësipërme, FSHS/DPP përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të parë të marrë në vlerësim,

dëshmojnë se disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.

Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.

Referuar dokumentit “Korniza konceptuale e programit të studimit Bachelor në Psikologji”, Pika 4 “Struktura dhe karakteristikat e programit të studimit”, mes të tjerash, cilësohet se “Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera janë organizuar në disa kategori lëndësh me 180 kredite” (fq.6).

Në Rregulloren e programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018), Neni 19 “Plani mësimor”, në pikën 19.1, përcaktohet se “Plani mësimor përfshin 38 lëndë, bashkë me praktikën dhe proven finale: provim final/temë diplome. Plani mësimor ka karakter shumëdisiplinar”... Në pikën 19.2, përcaktohet se “Plani mësimor ndryshohet vetëm kur ndryshimi është i argumentuar dhe duke ndjekur të gjitha rrugët, rregulloret dhe amendimet e aprovuara” (fq. 10).

Sipas Planit Mësimor të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, rezulton se programi i studimit është i organizuar në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, të ndara në vite dhe semestra.

Në mënyrë më specifike, lëndët e programit të studimit janë ndarë sipas kategorive të parashikuara në VKM nr. 41/2018, si në tabelën e paraqitur më poshtë:

Kateg.	Përshkrimi	Sipas VKM 41/2018	Sipas planit mësimor
A	Lëndë Bazë	15%-20%	8.9 %
B	Lëndë karakterizuese	50%-55%	54.5 %
C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12%-15%	30 %
D	Lëndë plotësuese	10%-15%	3.3 %
E	Detyrime përmbyllëse	3%-5%	3.3 %

Shënim: Përqindjet sipas tipologjisë së lëndëve mësimore janë përllogaritur bazuar në Planin Mësimor 2020-2021 (Material, 84, 85, e-ASCAL)

Krahasuar me përcaktimet në VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, Pika 2.4/a "Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit", Shtojca 1, Tabela 1, për Ciklin e parë, konstatohet një mospërputhje në % për kategorite A, C dhe D.

- Gjenden më pak lëndë mësimore të kategorisë A (Lëndë bazë) të shprehura në 8.9% të krediteve, në raport me 15% - 20% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori;
- Gjenden më shumë lëndë mësimore të kategorisë C (Lëndë ndërdisiplinore) të shprehura në 30% të krediteve, në raport me 12% - 15% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori;
- Gjenden më pak lëndë mësimore të kategorisë D (Lëndë plotësuese) të shprehura në 3.3% të krediteve, në raport me 10% - 15% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori;

Lidhur me kategorinë D, vërehet se përveç praktikës profesionale, është përfshirë një lëndë me zgjedhje: Gjuhë e huaj e specialitetit (4 kredite), kreditet e të cilës nuk mund të llogariten dy herë, edhe në kategorinë C edhe në kategorinë D.

Në përmbajtjen e Planit Mësimor 2020-2021, lënda/moduli "Gjuhë e huaj e specialitetit" (4 kredite), rezulton e llogaritur si pjesë e totalit me 60 kredite që duhet të fitojë studenti në përfundim të vitit të parë të programit Bachelor në Psikologji.

Sipas përcaktimeve të VKM nr.41/2018, lëndët/modulet me zgjedhje i përkasin kategorisë C. Ndërkohë, në Planin Mësimor, "Gjuha e huaj e specialitetit" specifikohet si lëndë në kategorinë D.

Gjithashtu, referuar VKMnr.41/2018, "Shtojca", shënohet se "Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70% në rastin e programeve "Bachelor". Në Planin Mësimor Bachelor në Psikologji, përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B rezulton **63.4 % kredite**.

Për sa më sipër GVJ rekomandon, që të rishikohet rigrupimi i lëndëve sipas ngarkesës përkatëse në kredite, me qëllim që të përafrohet/pajtohet me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit" (Shtojca, Tabela 1, Për ciklin e parë).


Në vijim, institucioni mund të rishikojë me qëllim përmirësimi përmbajtjen e programit të studimit të marrë në vlerësim, për të konsideruar përfshirjen në kategorinë D, të lëndëve plotësuese: 1)

	<p>Gjuhë e huaj; 2) Njohuri informatike. Lidhur me kriterin 2, të standardit II.3, institucioni tregon se është i vetëdijshëm për nevojën për përmirësim. FSHS/DPP raporton në RVB, se “Për t’iu përgjigjur më mirë VKM-së në lidhje me përqindjet e gruplëndëve, janë marrë në konsideratë edhe disa ndryshime brenda masës 20% të planit mësimor, të cilat janë dërguar për miratim në organet e Dekanatit FSHS dhe Rekoratit UT”.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Sipas Rregullores së FSHS (2018), Kreu IV, “Organizimi i studimeve”, Neni 21, Pika 3 shprehet se “FSHS ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS)” (fq. 7).</p> <p>Neni 23, i kësaj Rregullore, pika 1, përkufizon se “Studimet në FSHS zhvillohen me bazë vitin akademik...” pika 2, “Viti akademik organizohet në dy semestra” (fq. 7).</p> <p>Referuar dokumentit “Korniza konceptuale e programit të studimit Bachelor në Psikologji”, Pika 4, “Për strukturën”, përshkruhet se “Programi i studimeve të ciklit të parë Bachelor në Psikologji është program studimesh universitar i organizuar në lëndë dhe vlerësuar me kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të krediteve ECTS (fq.5).</p> <p>Sipas Rregullores së ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018), Neni 8, “Për statusin e programit”, në pikën 8.2, cilësohet se “Programi është me kohë të plotë me 180 ECTS”.</p> <p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, dëshmohet se komponentët mësimorë (lëndët / modulet) janë klasifikuar dhe vlerësuar me kredite, sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në tre vite dhe dy semestra për çdo vit akademik.</p> <p>Nga kjo pikëpamje, programi studimit i marrë në vlerësim rezulton në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, me Pikën 2.6 “Plani mësimor” ku theksohet se: Në planin mësimor të çdo programi studimi përcaktohen: i) lëndët e programit të studimit, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra; ii) kreditet përkatëse.</p> <p>Megjithatë, sikurse është argumentuar edhe në Standardin II.3, kriteri 2, sugjerohet që të rishikohet rigrupimi i lëndëve në Planin Mësimor sipas kategorive të veprimtarive formuese dhe ngarkesës përkatëse në kredite, me qëllim që të përafrohet/pajtohet me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë</p>

<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p><i>formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit</i>" (Shtojca, Tabela 1, Për ciklin e parë).</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Psikologji përmban planin mësimor, ku përfshihen informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, tipin e veprimtarisë mësimore, dhe komponentë të tjerë. Dokumenti "<i>Korniza konceptuale e programit të studimit Bachelor në Psikologji</i>", pika e 6 e tij, përcakton qartë "<i>Format e kontrollit të dijeve. Frekuentimi dhe kontrolli i vazhdueshëm</i>" (fq. 8).</p> <p>Në Rregulloren e ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018), Kreu II "<i>Organizimi i programit të studimit</i>", mes të tjerash, përfshihet informacion për politikat e frekuentimit, procedurat e frekuentimit/ndjekjes së programit, mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, etj.</p> <p>Sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, "<i>Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit</i>", pika 2.1/dh "<i>Kreditet sipas ECTS-së</i>", mes të tjerash specifikohet se "<i>Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar (i cili mund të jetë provim, por jo vetëm)</i>".</p> <p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor 2020-2021 vërehet nevoja për të përfshirë informacion edhe për formën e kontrollit të dijeve/shlyerjes së lëndëve/moduleve, duke specifikuar lëndët që shlyen me provim (P) dhe lëndët/modulet apo praktika që shlyen me firmë (F).</p> <p><u><i>GVJ sugjeron, që të pasqyrohen në mënyrë të plotë dhe korrekte në Planin Mësimor, informacionet lidhur me ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve me zgjedhje.</i></u></p> <p>Nëse plani parashikon një lëndë/modul me zgjedhje në vitin e parë, semestri i dytë, atëherë për korrektesë, nevojitet që të shmanget vendosja në mënyrë të përsëritur e krediteve për çdo lëndë/modul të ofruar me zgjedhje (<i>Shiko Planin Mësimor, 2020-2021, viti i parë, rendi 12-13 për "Module me zgjedhje: 1 lëndë në semestrin e dytë"</i>).</p> <p>Në rast se plani parashikon dy lëndë/module me zgjedhje në një vit akademik, ose një lëndë/modul me zgjedhje për çdo semester, atëherë është e nevojshme që të pasqyrohen të gjitha elementet e ngarkesës mësimore (<i>kredite, orë gjithsej, orë leksione, orë seminare, orë brenda dhe jashtë auditorit, forma e kontrollit të dijeve/shlyerjes, etj.</i>) për dyja lëndët/modulet me zgjedhje. (<i>Shiko</i></p>
---	---

	<p><i>Planin Mësimor, 2020-2021, viti i dytë dhe viti i tretë, rendi 11-12/10-11 për "Module me zgjedhje: 1 lëndë / semestër").</i></p> <p>Përsëritja e informacionit të panevojshëm ose mungesa e elementeve të nevojshme në Planin Mësimor për lëndët/modulet me zgjedhje, krijon konfuzion lidhur me llogaritjen në total të ngarkesës së orëve mësimore për çdo vit akademik. (<i>Shiko Planin Mësimor, 2020-2021, viti i tretë, rreshti fundit: Viti I+II+III=180, kolona: Orë leksione 1140; kolona: Orë seminare 645; kolona: Orë jashtë auditorit 2565, shifrat për ngarkesën në orë mësimore rezultojnë të llogaritura gabim. Verifikimi i të dhënave, tregoi se janë: Orë leksione 1170; Orë seminare 600; Orë praktike 150; Orë jashtë auditorit 2580, dhe në total 4500 orë).</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit", pika 2.1 "Kreditet sipas ECTS-së", germa (e) dhe (ë), lidhur me kriterin 5, shprehen si më poshtë:</p> <p>e) <i>Njohja e plotë apo e pjesshme e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në një program tjetër studimi në të njëjtin IAL, si dhe në të njëjtin apo një tjetër program studimi në një IAL tjetër, bëhet nga njësia bazë që pret studentin, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në rregulloren mësimore të institucionit.</i></p> <p>ë) <i>IAL-të mund të njohin si kredite të formimeve universitare në një program të caktuar studimi, sipas kriterëve të përcaktuara, njohuri dhe aftësi profesionale të certifikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe njohuri të veprimtarive formuese të nivelit pas shkollës së mesme, që janë në përputhje me objektivat specifike të programit përkatës të studimit. Në këtë rast, numri maksimal i krediteve të njohura nuk i kalon 60 (gjashtëdhjetë) kredite për programet e studimit të ciklit të parë dhe 40 (dyzet) kredite për programet e studimit të ciklit të dytë.</i></p> <p>Këto përcaktime gjejnë pasqyrim në Rregulloren e FSHS (2018), Kreu V "Ekuivalentimet, Transferimet dhe ndërrimi i sistemit të studimeve", Neni 49 "Ekuivalentimi", Neni 50 "Llojet e transferimeve", Neni 51 "Procedura e kërkesës për transferim", Neni 52 "Propozimi dhe miratimi i transferimit", ku janë përshkruar të gjitha modalitetet, rregullat dhe informacionet e nevojshme për programin e studimit që lidhen me procedurën e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Dokumenti "Korniza konceptuale e programit të studimit Bachelor në Psikologji", pika e 5 e tij, përfshin informacion të nevojshëm për "Kushtet e pranimit" dhe "Kriteret e pranimit" (fq.7-8).</p>

	<p>Gjithashtu, në Rregulloren e ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018), Kreu II “Organizimi i studimeve”, Neni 24 “Për kushtet e transferimit ndërmjet programeve”, si dhe Kreu V “Pranimi i studentëve”, Neni 33 “Për kriteret e pranimit”, Neni 34 “Për dokumentacionin e pranimit”, Neni 35 “Për procedurat e përzgjedhjes”, përcaktohen të gjitha modalitetet, rregullat dhe informacionet e nevojshme për programin e studimit, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit.</p> <p>Referuar dokumentit “Kriteret e pranimit në ciklin e parë të studimeve Bachelor dhe një program të integruar të ciklit të dytë në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2021-2022” dëshmohet se FSHS/DPP propozon dhe publikon edhe kritere specifike për pranimin e studentëve (fq. 3, materiali 3.14, e-ASCAL).</p> <p>Për sa më sipër, programi i studimit Bachelor në Psikologji përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me përmbushjen e kriterit 5.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Psikologji përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit.</p> <p>Referuar dokumentit “Programet mësimore të lëndëve të programit Bachelor në Psikologji” (Material 4.3/1.2.3, e-ASCAL), vërehet se të gjitha syllabuset përmbajnë informacion të detajuar, duke filluar me titullin e lëndës, titullarin/pedagogun e lëndës, ngarkesën mësimore dhe kreditet, tipologjinë, vitin akademik/semestrin kur zhvillohet, objektivat e përgjithshëm/specifikë të formimit në atë lëndë, nëndarjen e çështjeve, raportin e orëve të leksioneve dhe seminarëve apo orët e laboratorit për secilën lëndë, përfshi edhe praktikën profesionale, formën e kontrollit të dijes, bibliografinë e detyruar dhe atë të rekomanduar, etj. Modeli i programit të lëndës që përdoret për hartimin e syllabus-eve, në programin e studimit Bachelor në Psikologji përmban të gjitha elementet në përputhje me formatin e miratuar në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, shtojca nr. 2 “Programi i lëndës”.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti</p>	<p>Në Rregulloren e programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018), Neni 8, “Statusi i programi”, në pikën 8.3, përcaktohet se “Për mbarëvajtjen dhe zbatimin e programit përgjigjen Dekanati dhe Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë”.</p>

akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.

FSHS i përmbahet bazës rregullatore dhe udhëzimeve të UT për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave. Në dokumentin “*Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimin të kurrikulave*”, Seksionin 3 “*Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit*”, përshkruhet tërësia e procedurave dhe hapave që ndiqen për hartimin, ristrukturimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Në pikën 3.1.1 janë përshkruar kriteret dhe procedurat për përmirësimin e programeve të ofruara. Në këtë kuadër, janë specifikuar kategoritë e ndryshimeve. Ndryshimet në shkallë të madhe që përfshijnë ndryshime mbi masën 20 %, kanë të bëjnë me riorganizimin e programit të studimit dhe kërkojnë domosdoshmërisht miratim nga MASR. Ndryshimet në shkallë të vogël, përfshijnë ndryshime profilizuese, nën masën 20 %, miratimi i të cilave bëhet nga Senati Akademik mbi bazën e propozimit të paraqitur nga njësia kryesore dhe njoftohet MASR jo më vonë se gjashtë muaj para fillimit të vitit të ri akademik. (fq. 5, 6, Materiali 36, e-ASCAL).


DPP përgjegjës për ofrimin e programit të studimit të marrë në vlerësim ka publikuar gjithashtu dokumentin “*Politikat për përmirësimin e kurrikulës dhe sigurimin e cilësisë së mësimdhënies, viti akademik 2019-2020*”, ku mes të tjerash, përcaktohen objektivat dhe procedurat e përmirësimin dhe sigurimit të cilësisë së programeve të studimit.

Dy nga objektivat e DPP janë:

- *Të rishikohen kurrikulat me qëllim përshtatjen e tyre për të pasqyruar zhvillimet në shkencën e pedagogjisë dhe psikologjisë...;*
- *Të rishikohet oferta e studimeve në mënyrë të vazhdueshme me qëllim përshtatjen e tyre me nevojat e tregut, prioritetet e zhvillimit kombëtar, rajonal dhe European” (fq. 4).*



Sipas këtij dokumenti, objektivat rishikohen çdo fillim viti akademik (fq. 4-5). Në funksion të arritjes së objektivave, DPP:

- Rishikon çdo fillim viti syllabuse duke reflektuar mbi të gjitha elementet për përmirësimin e programit të studimit;
- Monitorton të gjitha proceset e veprimtarive akademike (leksione, seminare dhe praktikë mësimore) duke filluar që nga momenti i regjistrimit të studentit deri në diplomimin e tij, duke përfshirë monitorimin e zhvillimit të të gjithë procesit mësimor dhe cilësinë e procesit të vlerësimit;
- Reflektton mbi të dhënat e mbledhura nga evidencat (pyetësorë, focus grupe të realizuara me studentë) për të mbështetur stafin akademik në përmirësimin e



	<p>vazhdueshëm të zhvillimit profesional në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies (fq. 4-5, Materiali 3.15, e-ASCAL).</p> <p>FSHS /DPP janë të vetëdijshëm për nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të programit të marrë në vlerësim. Sipas RVB (2022), raportohet se “Për t’iu përgjigjur më mirë VKM-së në lidhje me përqindjet e gruplëndëve, janë marrë në konsideratë edhe disa ndryshime brenda masës 20% të planit mësimor, të cilat janë dërguar për miratim në organet e Dekanatit FSHS dhe Rekoratit UT”. Dokumentet e mësipërme dhe diskutimi gjatë vizitës në institucion, mbi praktikat konkrete që ndërmerr institucioni për përmirësimin e programit të studimit Bachelor në Psikologji, dëshmojnë se përmbajtja e këtij programi është në process përmirësimi dhe përditësimi të vazhdueshëm, dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		

Standardi II.4	
<p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit është e organizuar në 3 vite akademike, me 180 kredite në total dhe është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Në pikën 2.4/b të VKM/2018 përcaktohet se “Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila disiplinë”.</p> <p>Shqyrtimi i Planit Mësimor 2020-2021, lidhur me ngarkesën vjetore/javore të një studenti me orë mësimore brenda/jashtë auditorit për çdo vit akademik, tregoi si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Viti I përmban 60 kredite = 1500 orë në vit, nga të cilat 630 orë në auditor dhe 870 orë jashtë auditorit. Kjo ngarkesë

mësimore realizohet në dy semestra me nga 15 javë/semestri ose 30 javë /viti akademik. Sipas kësaj strukture, një student zhvillon mesatarisht 21 orë mësimore në javë brenda auditorit dhe 29 orë në javë jashtë auditorit;

- **Viti II**, përmban 60 kredite = 1500 orë, nga të cilat 585 orë në auditor dhe 915 orë jashtë auditorit. Kjo ngarkesë mësimore realizohet në dy semestra me nga 15 javë/semestri ose 30 javë /viti akademik. Sipas kësaj strukture, një student zhvillon mesatarisht 19.5 orë në javë brenda auditorit dhe 30.5 orë në javë jashtë auditorit;

- **Viti III**, përmban 60 kredite = 1500 orë, nga të cilat 705 orë në auditor dhe 795 orë jashtë auditorit. Kjo ngarkesë mësimore realizohet në dy semestra me nga 15 javë/semestri ose 30 javë /viti akademik. Sipas kësaj strukture, një student zhvillon mesatarisht 23.5 orë në javë brenda auditorit, duke përfshirë edhe praktikën profesionale, dhe 26.5 orë në javë jashtë auditorit;

Krahasimi i të dhënave për ngarkesën mësimore javore, për çdo vit akademik të pasqyruar në Planin Mësimor, tregon se në vitin e dytë të programit të studimit Bachelor në Psikologji gjendet një numër relativisht më i madh i orëve jashtë auditorit (30.5 orë /javë) krahasuar me orët brenda në auditor (19.5 orë/javë).

Në total ngarkesa mësimore brenda/jashtë auditorit, sipas Planit Mësimor 2020-2021 të programit Bachelor në Psikologji, viti i tretë, rreshti fundit: Viti I+II+III=180, kolona: Orë leksione 1140; kolona: Orë seminare 645; kolona: Orë jashtë auditorit 2565, rezultojnë të llogaritura gabim. Verifikimi i të dhënave tregoi se janë: Orë leksione 1170, Orë seminare 600, Orë praktike 150, dhe Orë jashtë auditorit 2580. Pra, 1920 orë në auditor, 2580 orë jashtë auditorit, dhe në total 4500 orë.

Raporti në total midis orëve në auditor dhe jashtë auditorit është në favor të orëve jashtë auditorit me një diferencë 660 orë (26.4 kredite) më shumë punë e pavarur/individuale e studentit.

Kjo situatë mund të perceptohet si një nivel i caktuar mbingarkese me orë pune jashtë auditorit për një student që ndjek programin e ciklit të parë Bachelor.

Sidoqoftë, në tërësinë e tij Plani Mësimor 2020-2021, respekton përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit", pikën 2.1/d ku shprehimisht thuhet se "Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të

	<p>zhvilluara në auditor, është deri në 25 (njëzet e pesë) orë mësimore 50-minutëshe”.</p> <p>Përgjithësisht, Plani Mësimor 2020-2021, reflekton Rregulloren e FSHS (2018), Kreu IV “Për organizimin e programeve”, Nenin 21, pikën 2, ku specifikohet se “Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite. Një krediti të studimeve universitare i korrespondojnë 25 orë mësimore pune të studentit, ku 10 deri 12 orë punë duhet të jenë në auditor”.</p> <p>Për sa më sipër <u>GVJ</u> u gjeron që të korrektohen gabimet teknike në llogaritjen e totalit të orëve mësimore në Planin Mësimor të programit të marrë në vlerësim, si dhe të merret në konsideratë nga institucioni mundësia për të rishikuar ngarkesën mësimore javore në Planin Mësimor, kryesisht në vitin e dytë akademik, me qëllim balancimin e numrit të orëve në auditor me orët jashtë auditorit.</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Referuar “Kornizës konceptuale të programit të studimit Bachelor në Psikologji”, Pika 3(fq.4) dhe “Rregullores së programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, 2018”, Neni 10 i tij (fq. 6), përcaktohet se programi i studimit ka për qëllim/mision “ofrimin e njohurive bazë në fushat që lidhen drejtpërsëdrejti me shkencën e psikologjisë, si dhe të njohurive mbi degët më të aplikuara aktualisht të psikologjisë në botë e në vendin tonë. Gjithashtu, programi e pajis studentin me aftësitë kryesore të një psikologu të përgjithshëm”.</p> <p>Në Rregulloren e programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018), Neni 19 “Plani mësimor “, përshkruhet se “Plani mësimor përfshin 38 lëndë bashkë me praktikën dhe provën finale: provim final/temë diplome. Plani mësimor ka karakter shumëdisiplinar. Bachelori në “Psikologji” është një program studimi, i cili ofron udhëkryqet e disa disiplinave njëherazi me një gamë të përgjithshme dhe karakterizuese (histori e psikologjisë, psikologjia sociale, teoritë e personalitetit, sociologjia, psikologjia e zhvillimit, psikologjia anormale, ajo kognitive, e shëndetit, psikologjia e punës, psikofiziologjia, psikologjia shkollore, këshillimi e psikoterapia, etj.) integruese duke i lidhur të gjitha këto me shumë disiplina të tjera (metoda kërkimi, përpunim statistikor i të dhënave, hyrje në ekonomi, psikologji gjinore, psikologji sportive, komunikim, biologji e anatomi e sistemit nervor, menaxhim stresi), apo edhe disiplina që formojnë aftësim (shkrim akademik, metoda kërkimi, gjuhë e huaj) dhe praktikë. Kurrikula e studimeve në Ciklin Bachelor në Psikologji kombinon dhe harmonizon dimensionin teorik në fushën e</p>

psikologjisë botërore me kontekstin shqiptar. Ky program i mundëson studentit që të njihet me fushat e thelluara të studimit pasuniversitar, duke bërë të mundur një zgjedhje më të informuar në të ardhmen”.

Në vijim të Rregullores së programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018), Neni 23 “Praktika”, specifikohet se “Komponenti i praktikës synon t’u japë studentëve një përvojë praktike të punës në sektorë të ndryshëm të psikologjisë. Praktika parashikon të mundësojë përdorimin e kompetencave të fituara në kurset teorike në një kontekst praktik profesional”

Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive të programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji është në përputhje me qëllimin misionin e tij për formimin e studentit me njohuritë dhe aftësitë kryesore të një psikologu të përgjithshëm.

Shqyrtimi i përmbajtjes së Planit Mësimor të programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2020-2021), tregon se lëndët rezultojnë, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese nga A në E të përcaktuara në VKM nr.41/2018, si dhe në vite e semestra dhe me kreditet përkatëse.

Lidhur me shpërndarjen e lëndëve dhe praktikëssipas kategorive nga A në E, për çdo vit akademik të Planit Mësimor, vërehet se:

- Në vitin e parë akademik zhvillohen 4 lëndë të kategorisë A (lëndë bazë/ 16 kredite), 5 lëndë të kategorisë B (lëndë karakterizuese/26 kredite), 4 lëndë të kategorisë C (lëndë ndërdisiplinore / integruese / me zgjedhje/ 18 kredite) dhe ndërmjet lëndëve me zgjedhje të kategorisë C, është ndërfutur një lëndë e adresuar për kategorinë D (lëndë plotësuese/? kredite);
- Në vitin e dytë akademik zhvillohen 8 lëndë të kategorisë B (lëndë karakterizuese/41 kredite) dhe 4 lëndë të kategorisë C (lëndë ndërdisiplinore / integruese / me zgjedhje/ 19 kredite);
- Në vitin e tretë akademik zhvillohen 7 lëndë të kategorisë B (lëndë karakterizuese/ 31 kredite), 4 lëndë të kategorisë C (lëndë ndërdisiplinore / integruese / me zgjedhje/17 kredite), 1 lëndë e kategorisë D (lëndë plotësuese/ 6 kredite) dhe 1 lëndë e kategorisë E (detyrime përmyllëse/ 6 kredite);

Praktika Profesionale (kategoria D / 6 kredite/150 orë), zhvillohet në semestrin e parë dhe të dytë të vitit e tretë. Ky komponent mësimor i programit të studimit, realizohet në përputhje me Nenin 23, të Rregullores së programit të ciklit të parë Bachelor në

Psikologji (2018), i cili përcakton se "Për të plotësuar kërkesat e parashikuara, studentët duhet të zhvillojnë praktikë në një ose disa institucione arsimore për një periudhë prej një viti akademik të ndarë në dy semestra.

Përgjithësisht, shpërndarja e lëndëve dhe praktikës në programin e ciklit të parë Bachelor në Psikologji ndjek një hierarki të caktuar e cila mundëson studentët që të përfitojnë njohuri dhe aftësi, si dhe të vijojnë studimet në programe specializimi të ciklit të dytë Master.

Kriteri 3.

Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të detajuar shtrirjen e lëndëve në Planin Mësimor 2020-2021, për çdo vit akademik, sipas kategorive përkatëse dhe krediteve respektive.

Kategoria e veprimtarive formuese A - E	Viti i I		Viti i II		Viti i III	
	lëndë	kredite	lëndë	kredite	lëndë	kredite
Kategoria A	4	16	-	-	-	-
Kategoria B	5	26	8	41	7	31
Kategoria C	4	18	4	19	4	17
Kategoria D	1	*	-	-	1	6
Kategoria E	-	-	-	-	1	6
Totali Lëndë/kredite	13	60	12	60	13	60

* *Shënim:* duke qenë se është me zgjedhje nuk mund të llogaritet në totalin e lëndëve/krediteve

Referuar tabelës së mësipërme, vërehet se lëndët bazë të programit të studimit (A), që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme, zhvillohen në vitin e parë, 3 prej tyre semestrin e parë dhe një semestrin e dytë. Gjenden pak lëndë mësimore të kategorisë A të shprehura në 8.9% të krediteve, në raport me 15% - 20% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori.

Lëndët karakterizuese (B), që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij janë shpërndarë në tre vite akademike (5/8/7 lëndë), me rritje të numrit të lëndëve/ krediteve nga viti i parë në të dytin, dhe një ulje të lehtë të numrit të lëndëve/krediteve në vitin e tretë. Pësha specifike në kredite e lëndëve të kategorisë B rezultojnë 54.5 % kredite.

Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B rezultojnë pak kredite (63.4 % kredite), krahasuar me përcaktimet e VKMnr.41/2018, "Shtojca", ku shënohet se "Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70% në rastin e programeve "Bachelor".

Për sa më sipër GVJ sugjeron që institucioni të konsiderojë rritjen me 15% - 20% kredite të lëndëve të kategorisë A, sipas përcaktimeve të VKM nr.41/2018.

Lëndët ndërdisiplinore (C) dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje janë shtrirë gjatë tre viteve akademike me numër të barabartë lëndësh (4/4/4 lëndë) dhe kredite të përafërta. Rezultojnë shumë lëndë mësimore të kategorisë C të shprehura në 30 % të krediteve, në raport me 12% - 15% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori.

Lidhur me këtë kategori të Planit Mësimor, rekomandohet që institucioni të ndërhyjë për të siguruar jo më shumë se 12% - 15% kredite të lëndëve të kategorisë C.



Lëndët plotësuese (D), të fokusuar në përfundimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim, zënë 3.3% të krediteve, në raport me 10% - 15% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori.

Në këtë kategori të lëndëve vërehet se përveç praktikës profesionale (6 kredite) e cila zhvillohet në vitin e tretë/semestri i parë dhe i dytë, është përfshirë si lëndë me zgjedhje "Gjuhë e huaj e specialitetit" (4 kredite), që ofrohet në vitin e parë/semestri i dytë, kreditet e të cilës nuk mund të llogariten dy herë, edhe në kategorinë C edhe në kategorinë D.



Ky aspekt i Planit Mësimor, ka nevojë të rishikohet. Për të mbështetur arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimit profesional, sugjerohet që institucioni të konsiderojë rritjen me 10% - 15% kredite të lëndëve të kategorisë D, si dhe/ose përfshirjen si lëndë plotësuese: 1) Gjuhë e huaj; 2) Njohuri informatike.

Në Planin Mësimor 2020-2021 të programit Bachelor në Psikologji është pasqyruar në mënyrë të plotë ngarkesa në orë

	<p>mësimore për çdo lëndë sipas krediteve respektive, të ndara në vite dhe semestra. Megjithatë, verifikimi i të dhënave në total për orët mësimore, tregoi se në rreshtin fundit: Viti I+II+III=180, kolona: Orë leksione 1140; kolona: Orë seminare 645; kolona: Orë jashtë auditorit 2565, rezultojnë të llogaritura gabim.</p> <p><u>Sugjerohet të korrektohet si vijon:</u> Orë leksione 1170, Orë seminare 600, Orë praktike 150, dhe Orë jashtë auditorit 2580. Pra, 1920 orë në auditor, 2580 orë jashtë auditorit, dhe në total 4500 orë.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Referuar “Kornizës konceptuale të programit të studimit Bachelor në Psikologji”, Pika 4 “Struktura dhe karakteristikat e programit të studimit”, cilëshet se “Programi të ciklit të parë Bachelor në Psikologji është program studimesh universitar, i organizuar në lëndë dhe i vlerësuar me kredite sipas “Sitemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve” (ECTS). Disiplinat mësimore janë organizuar në disa kategori lëndësh me 180 kredite”.</p> <p>Në Rregulloren e programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018), Neni 19 “Plani mësimor“, përkthehet se “Plani mësimor përfshin 38 lëndë bashkë me praktikën dhe provën finale: provim final/temë diplome. Plani mësimor ka karakter shumëdisiplinar. Kurrikula e studimeve në Ciklin Bachelor në Psikologji kombinon dhe harmonizon dimensionin teorik në fushën e psikologjisë botërore me kontekstin shqiptar. Ky program i mundëson studentit që të njihet me fushat e thelluara të studimit pasuniversitar, duke bërë të mundur një zgjedhje më të informuar në të ardhmen”.</p> <p>Në Planin Mësimor 2020-2021 të programit të studimit të marrë në vlerësim janë pasqyruar lëndët, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra, dheme kreditet përkatëse. Çdo lëndë në Planin Mësimor e parashikuar për t’u zhvilluar në auditor, përbëhet nga komponentët mësimore si “leksione” dhe “seminare”. Nuk konstatohen lëndë të cilat përveç leksioneve dhe seminareve, të përfshijnë edhe komponentin mësimor “laborator”.</p> <p>Praktika Profesionale përmban 6 kredite (150 orë) dhe zhvillohet në semestrin e parë dhe të dytë, të vitit të tretë, në përputhje me përcaktimet në Nenin 23, të Rregullores së programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, 2018. Nga kjo pikëpamje, raporti teori – praktikë në programin e ciklit të parë Bachelor në Psikologji (180 kredite) rezulton në favor të teorisë me 96.7 % kredite teori dhe 3.3 % kredite praktikë profesionale.</p>

	<p>Megjithatë, gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët e programit Bachelor në Psikologji, u shpjegua se “Detyrat lëndore / studimore që u jepen studentëve për t’u punuar në auditor ose jashtë auditoritsynojnë që të lidhin teorinë me praktikën”.</p> <p>Pavarësisht detyrave lëndore specifike që ndihmojnë studentët të lidhin teorinë me praktikën, <u>GVJ sugjejon të rishikohet komponenti mësimor “Praktikë Profesionale” në Planin Mësimor duke vlerësuar mundësinë për të rritur kreditet.</u></p> <p>Gjithashtu, mund të merren në shqyrtim komponentët mësimorë të disa lëndëve profesionale në Planin Mësimor, të cilat janë parashikuar të zhvillohen vetëm me leksione dhe seminare, për të gjykuar mbi nevojën e përfshirjesedhe të komponentit “laborator”.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Sipas Rregullores së programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, Neni 19, ky program “<i>ofron udhëkryqet e disa disiplinave njëherazi me një gamë të përgjithshme dhe karakterizuese (histori e psikologjisë, psikologjia sociale, teoritë e personalitetit, sociologjia, psikologjia e zhvillimit, psikologjia anormale, ajo kognitive, e shëndetit, psikologjia e punës, psikofiziologjia, psikologjia shkollore, këshillimi e psikoterapia, etj.), integruese duke i lidhur të gjitha këto me shumë disiplina të tjera (metoda kërkimi, përpunim statistikor i të dhënave, hyrje në ekonomi, psikologji gjinore, psikologji sportive, komunikim, biologji e anatomi e sistemit nervor, menaxhim stresi), apo edhe disiplina që formojnë aftësim (shkrim akademik, metoda kërkimi, gjuhë e huaj) dhe praktikë... Programi i mundëson studentit që të njihet me fushat e thelluara të studimit pasuniversitar, duke bërë të mundur një zgjedhje më të informuar në të ardhmen”.</i></p> <p>Në Planin Mësimor 2020-2021 të programit të studimit të marrë në vlerësim janë pasqyruar 38 lëndë, të ndara sipas kategorive A-E të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra, dhe me kreditet përkatëse.</p> <p>Raporti teori – praktikë në programin e ciklit të parë Bachelor në Psikologji (180 kredite) rezulton me 96.7 % kredite teori dhe 3.3 % kredite praktikë profesionale. Praktika Profesionale përmban gjithsej 6 kredite (150 orë).</p> <p>Ky raport mundëson arritjen e objektivave formues të programit, si dhe lejon transferimin, mobilitetin dhe vijshmërinë e studimeve në programet e ciklit të dytë në degë të ndryshme të specialitetit. FSHS/DPP zotëron dokumentacionet përkatëse që tregojnë mbi praktikën e transferimit të studentëve në përputhje me përcaktimet në Nenin 24 “<i>Kushtet për transferim ndërmjet programeve</i>”, pikat: 1, 2, 3, 4, 5, të Rregullores së Programit të</p>

	<p>Ciklit të Parë Bachelor në Psikologji (2018). (Materiali 142/4.9 "Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit", e-ASCAL). Gjithashtu, FSHS/DPP dëshmon për praktika të mira të përfshirjes së studentëve në projekte mobiliteti, duke filluar nga viti 2016 deri në vitin 2022. (Materiali 124/ 3.20 "Të dhëna për mobilitetin e studentëve dhe të pedagogëve", e-ASCAL).</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Shqyrtimi i programeve lëndore (syllabuset) për tre vitet e studimit, tregoi se ato janë hartuar në përputhje me elementet e modelit sipas përcaktimeve në shtojcën nr. 2 që i bashkëlidhet VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit", Pika 2.8 "Programi lëndor (syllabus-et)", (i ndryshuar me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Shtojca 3 "Programi i lëndës").</p> <p>Në Rregulloren e DPP (2018), Neni 11 "Përgjegjësitë e koordinatorëve të programeve të studimit që mbulohen nga DPP", Pika 9 e tij, shprehimisht thuhet se "Koordinatori i programit të studimit në bashkëpunim me titullarët e lëndëve është përgjegjës për përditësimin e vazhdueshëm të syllabuseve të programit të studimit, duke u bazuar në literaturën e detyruar dhe ndihmëse të pesë viteve të fundit".</p> <p>Lidhur me këtë element të programit lëndor janë evidentuar praktika të mira të përditësimit të literaturës. Gjenden disa syllabuse që kanë përfshirë rishikimin e ciklit të leksioneve ose botime të 5 viteve të fundit si: 2017; 2018; 2019 dhe 2020 (Materiali 136/4.3.3 "Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit 2020-2021", fq. 167; 172; 178; 212; 229; e-ASCAL).</p> <p>Një pjesë e syllabuseve kanë nevojë që titullarët e tyre të rrisin përpjekjet dhe të përditësojnë në mënyrë të vazhdueshme literaturën bazë të detyruar dhe literaturën ndihmëse/ të rekomanduara botime të 5 viteve të fundit.</p> <p>Gjithashtu, janë vërejtur raste kur literatura bazë e detyruar dhe ndihmëse/e rekomanduar dominohen kryesisht nga botime në gjuhë të huaj angleze (Materiali 136/4.3.3 "Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit 2020-2021", fq. 150-151; 161; 242-243; e-ASCAL).</p> <p>Për këto raste, gjatë takimit në institucion, stafi akademik arsyetoi se studentët zotërojnë gjuhën angleze dhe punojnë lehtësisht me literaturën në gjuhë të huaj. Përvec kësaj, shpjeguan se titullarët e lëndëve kanë përgatitur cikle të leksioneve në gjuhën shqipe.</p>

	<p>Ndërkohë, studentët pohuan gjatë takimit në institucion se ata nuk ndihen të mbingarkuar me literaturën bazë dhe të rekomanduar në gjuhë angleze.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Referuar <i>“Kornizës konceptuale të programit të studimit Bachelor në Psikologji”</i>, Pika 3 (fq.4) dhe <i>“Rregullores së programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, 2018”</i>, Neni 10 i tij (fq. 6), përcaktohet se programi i studimit ka për qëllim/mision <i>“ofrimin e njohurive bazë në fushat që lidhen drejtpërsëdrejti me shkencën e psikologjisë, si dhe të njohurive mbi degët më të aplikuara aktualisht të psikologjisë në botë e në vendin tonë. Gjithashtu, programi e pajis studentin me aftësitë kryesore të një psikologu të përgjithshëm”</i>.</p> <p>Sipas Rregullores së programit të studimit (2018), Neni 19 <i>“Plani mësimor”</i>, përshkruhet se <i>“Plani mësimor përfshin 38 lëndë bashkë me praktikën dhe provën finale: provim final/temë diplome. Plani mësimor ka karakter shumëdisiplinar...Kurrikula e studimeve në Ciklin Bachelor në Psikologji kombinon dhe harmonizon dimensionin teorik në fushën e psikologjisë botërore me kontekstin shqiptar”</i>.</p> <p>Nga kjo pikëpamje, përmbajtja e programit të studimit të marrë në vlerësim garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përfundimi i studimeve në programin e ciklit të parë Bachelor në Psikologji nuk mundëson punësim të menjëhershëm për të diplomuarit, sepse prej vitit 2016, Ligji për profesionin e rregulluar të Psikologut në Republikën e Shqipërisë lejon punësimin vetëm nëse studenti ka plotësuar 2 cikle të plota studimi Bachelor në Psikologji dhe Master në një degë të specialitetit në Psikologji, si dhe ka fituar licensën përmes Urdhrit të Psikologut për ushtrimin e profesionit.</p> <p>Në dokumentin <i>“Alumni Bachelor në Psikologji: Rezultate mbi punësimin (2021)”</i>, FSHS/DPP prezanton rezultatet e punësimin të ish studentëve të programit Bachelor në Psikologji të cilët pas diplomimit kanë vijuar studimet në ciklin e dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike, dhe më tej, pas licensimit, janë punësuar ose vetëpunësuar. (Materiali 147/4.14 <i>“Të dhëna përmbledhëse për punësimin real të studentëve të programit”</i>, e-ASCAL).</p> <p>Bazuar në materialin <i>“Gjurmë të njohjes së kurrikulës jashtë vendit”</i>, mësohet se institucioni ruan komunikimin në distance me ish-studentë të diplomuar në programet e studimit të ofruara nga FSHS/ DPP, të cilët kanë vijuar ose përmbyllur studimet e tyre në</p>

	<p>fushën e psikologjisë në universitete të tjera jashtë vendit dhe aktualisht janë përfshirë në tregun e punës në vendet ku jetojnë. Rezultatet e studimit për punësimin e ish-studentëve të diplomuar në FSHS/DPP, janë një tregues real se përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës brenda dhe jashtë vendit.</p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Referuar materialit 119/3.15 “<i>Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit</i>”, depozituar në e-ASCAL, mësohet se Departamenti i Psikologjisë dhe Pedagogjisë (DPP), struktura përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Psikologji, ka përpunuar dokumentin “<i>Politika për përmirësimin e kurrikulës dhe cilësisë së mësimdhënies, viti akademik 2019-2020</i>”, që përfshin “<i>parimet dhe procedurat e vlerësimit, me qëllim garantimin e cilësisë, efektshmërinë e kërkuar dhe përmbushjen e standardeve</i>” (fq. 3).</p> <p>Në këtë dokument, ndër objektivat strategjike të zhvillimit, DPP ka parashikuar se duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të rishikohet oferta e studimeve në mënyrë të vazhdueshme me qëllim përshtatjen e tyre me nevojat e tregut, prioritetet e zhvillimit kombëtar, rajonal dhe Europian (fq. 4). <p>Për arritjen e objektivave formues dhe përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së programit të studimit Bachelor në Psikologji, FSHS/DPP, si pjesë përbërëse e UT, dëshmon përmes “<i>Listës së marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partnerëve për praktikën profesionale</i>” (materiali 4.17, e-ASCAL) se ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm të institucioneve homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me institucione publike, qendra të shërbimit psiko-sociale, agjensi e biznese private, etj. Gjithashtu, sipas dokumentit “<i>Relacion për përfitimet nga marrëveshjet e praktikës profesionale për ciklin e parë të studimeve Bachelor në Psikologji</i>” (materiali 3.19, e-ASCAL) hartuar nga DPP, mësohet se “<i>Çdo fillim të vitit shkollor mbledhet Bordi i Tregut të Punës në një takim të përbashkët për vijimin e bashkëpunimit midis institucioneve në funksion të praktikës profesionale dhe të diskutimit mbi nevojat për përditësim të shprehive dhe kompetencave që tregu i punës kërkon për psikologët.</i>” (fq. 1).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbyhet plotësisht</p>	<p>Përmbyhet pjesërisht</p>	<p>Përmbyhet kryesisht</p>	<p>Përmbyhet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Referuar dokumentit (nr. 139/4.6 Të dhëna tabelore për personelin akademik të programit të studimit.pdf, e-ASCAL, dhe nr. 5/1. Te dhëna te stafit te Fakultetit, Departamentit dhe programit te studimit per vitin akademik 2021-2022.pdf, fq.1, Rubrika: Vizita dy ditore në institucion dhe dokumentacioni shtesë, e-ASCAL), rezulton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në Psikologji, është:

1. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 46 pedagogë nga të cilët 18 PAE dhe 28 PAK.
2. Për vitin akademik 2020 - 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 43 pedagogë nga të cilët 18 PAE dhe 25 PAK.
3. Për vitin akademik 2019 - 2020 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 43 pedagogë nga të cilët 18 PAE dhe 25 PAK.
4. Për vitin akademik 2018 - 2019 kanë dhënë mësim në këtë

Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021		2019-2020		2018-2019	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	2	-	2	-	2	-	2	-
Prof. Asoc.	3	-	3	-	3	-	3	-
Dr./PhD.	13	5	13	10	13	11	12	8
Msc.	-	23	-	15	-	14	-	19
Totali	18	28	18	25	18	25	17	27

program studimi 44 pedagogë nga të cilët 17 PAE dhe 27 PAK.

Të dhënat e mësipërme tregojnë se personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, ka nivelin e duhur të kualifikimit

akademik për drejtimin e programit, dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Referuar tabelave përkatëse të dokumentit (nr. 5/1. Te dhena te stafit te Fakultetit, Departamentit dhe programit te studimit per vitin akademik 2021-2022.pdf, fq.1-23; 32-37, Rubrika: Vizita dy ditore në institucion dhe dokumentacioni shtesë, e-ASCAL), kolona “Ngarkesa mësimore (orë) në BSc” (2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022) e personelit akademik efektivë (PAE) dhe personelit akademik me kontratë (PAK), rezulton se raporti për mbulimin e ngarkesës mësimore (orë) PAE/PAK është si më poshtë:

Viti akademik	PAE	PAK
2018-2019	1883 orë (53.4%)	1647 orë (46.6%)
2019-2020	1988 orë (57.7 %)	1458 orë (42.3%)
2020-2021	1980 orë (57.5 %)	1464 orë (42.5%)
2021-2022	1285 orë (45.8%)	1520 orë (54.2%)

Analiza e të dhënave në tabelën e mësipërme tregon se personeli akademik me kohë të plotë (PAE) mbulon më pak se 70% të ngarkesës mësimore të programit të marrë në vlerësim.

GVJ sugjeron të respektohen përcaktimet e VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”, Pika 2 (b) e tij, “Standardet për personelin akademik të IAL-së”, ku specifikohet se: Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi.

Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Referuar CV-së personale të secilit nga personeli akademik i angazhuar në realizimin e programit të studimit, vërehet se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e tyre, është në përputhje me drejtimin e programit të studimit Bachelor në Psikologji, si dhe me natyrën dhe specifikën e lëndëve/moduleve në përmbajtje të tij. (Dokumenti 149/4.16.1 CV e personelit akademik te brendshem për programin e studimit.pdf; 150/ 4.16.2 CV e personelit akademik te jashtem për programin e studimit.pdf; 151/4.16.3 CV e personelit ndihmësakademik për programin e studimit.pdf, e-ASCAL).


Gjithashtu, ngarkesa mësimore lëndore e personelit akademik që mbulon programin e studimit Bachelor në Psikologji është përcaktuar në përputhje me specializimin e personelit akademik dhe zhvillimin e tyre në fushën përkatëse të kërkimit

<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>shkencor (<i>Dokumenti 139/4.6 Të dhëna tabelore të kualifikimit të stafit të programit të studimit Bachelor në Psikologji</i>).</p> <p>FSHS/DPP, ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi në nivel institucional për organizimin dhe përmbushjen e qëllimeve të praktikës profesionale, si dhe veprimtarive të tjera mësimore për realizimin e programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji (<i>Dokumenti 3.17 Lista e marrëveshjeve Institucionale të DPP e FSHS, e-ASCAL</i>).</p> <p>Sipas "Rregullores së programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji" (2018), Neni 23 "Praktika", theksohet se "Për të plotësuar kërkesat e parashikuara, studentët duhet të zhvillojnë praktikë në një ose disa institucione arsimore për një periudhë prej një viti akademik të ndarë në dy semestra. Praktika zhvillohet në vitin e tretë të studimeve. Për komponentin e praktikës janë caktuar 6 kredite. Udhëzimet më të hollësishme lidhur me praktikën jepen në paketën e praktikës".</p> <p>DPP ka hartuar një Rregullore të Praktikës Profesionale (2018) ku janë përcaktuar kriteret për zgjedhjen e institucioneve të praktikës vëzhguese, informacion për zgjedhjen e agjencisë së praktikës psikologjike, procedurat e vlerësimit të dosjes së praktikës dhe përmbajtja e saj, vlerësimi i praktikës, detyrimet e studentit, aspekte që lidhen me respektimin e kodit etik të profesionit, detyrimet e supervizorit të praktikës, grafiku i shlyerjes së detyrimeve, institucionet e mundshme për praktikën, si dhe literatura e nevojshme (<i>Dokumenti 137/4.4 Paketa e praktikës për programin e studimit, e-ASCAL</i>).</p> <p>DPP dëshmon se vë në dispozicion personel të mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve për praktikën profesionale. Në fillim të vitit akademik, përgjegjësi i departamentit, shpërndan ngarkesën mësimore të praktikës të stafi akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, i cili mbulon programin e studimit, si dhe cakton një supervizor të praktikës për studentët. Supervizori i praktikës është staf akademik me kohë të plotë pranë DPP. Ai mbështet formalizimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet FSHS/DPP dhe Institucionit ku studentët do të realizojnë praktikën profesionale. Marrëveshjet e bashkëpunimit institucional për zhvillimin e praktikës nga studentët, janë vjetore ose semestrale në varësi të nevojës dhe dëshirës së studentëve për të zhvilluar praktikën me rotacion ose në disa qendra praktike (<i>Dokumenti 131/3.27 Marrëveshje e praktikës profesionale e DPP për programin e studimit Bachelor në Psikologji, e-ASCAL</i>).</p>
---	--

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.a

Web site: www.ascal.al



	<p>Sipas Rregullores së Diplomimit (2020), Neni 2 “<i>Modalitetet e diplomimit</i>”, theksohet se “<i>Studimet e ciklit të parë Bachelor që ofron FSHS, përmbillen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. FSHS përcakton çdo vit pragun e notës mesatare që i jep të drejtë studentëve të ciklit të parë të diplomohen duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome</i>”.</p> <p>DPP ka hartuar një udhëzues të posaçëm “Paketa e provës finale për mbrojtjen e diplomës Bachelor në Psikologji” (2018), ku përshkruhen standardet lidhur me metodologjinë e punimit, mënyrën e prezantimit, kërkesat teknike dhe etikën e kërimit. Gjithashtu, në këtë dokument janë pasqyruar përgjegjësitë e studentit dhe udhëheqësit të tij, si dhe tërësia e procedurave të propozimit, paraqitjes dhe mbrojtjes së provës finale (<i>Dokumenti 138/4.5 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit; e-ASCAL</i>).</p> <p>Departamenti është angazhuar në rrjetin e bashkëpunimit akademik e kërkimor me pedagogë e studentë të Institucioneve Arsimore të Larta homologe. Ky bashkëpunim është konkretizuar me organizimin e konferencave, seminareve e tryezave të përbashkëta, duke synuar forcimin, zgjerimin dhe shkëmbimin e përvojave akademike dhe të rejtat shkencore në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Në përfundim, FSHS/DPP, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>DPP ka në përbërje të tij edhe 1 (një) Personel Ndhimësakademik (PN) me karakter mësimor, i cili ndihmon në realizimin e programit tëstudimit, si dhe mbështet stafin mësimdhënës efektiv dhe me kontratë lidhur me organizimit të orareve të mësimit, sallave të mësimit, gjithë procesit të organizimit të provimeve, sekretimit të tyre, si dhe mbështetjen e sistemi online dhe platformës elektronike të vendosur për shërbimin e mësimdhënies në këtë program studimi. Detyrat dhe përgjegjësitë e PN janë përshkruar në Rregulloren e DPP, Neni 12. Bazuar në CV e Personelit Ndhimësakademik, mësohet se është i kualifikuar për të suportuar gjithë procesin mësimor (<i>Dokument 151/ 4.16.3 CV e personelit ndihmësakademik për programin e studimit; e-ASCAL</i>).</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.a

XB

[Signature]

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Referuar dokumentit “<i>Format për raportin vjetor për veprimtaritë e kryera</i>”, pika 2 e saj, informohet se “<i>Departamenti nuk ka hartuar një udhëzues të veçantë në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, por i ka përfshirë këta tregues në çdo rregullore të programit</i>” (fq. 2). (Material 95/4.11; e-ASCAL).</p> <p>Në Rregulloren e programit të ciklit të parë (2018), Neni 21 “<i>Format e mësimi</i>” përshkruhet se “<i>Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, prezantimeve, projekteve të kërkimit, posterave, praktikës</i>. Në vijim të kësaj Rregullore, Neni 23 “<i>Praktika</i>”, theksohet se “<i>Praktika parashikon të mundësojë përdorimin e kompetencave të fituara në kurset teorike në një kontekst praktik profesional... Udhëzimet më të hollësishme lidhur me praktikën jepen në paketën e praktikës</i>”.</p> <p>FSHS/DPP ka hartuar Rregulloren e Praktikës Profesionale (2018) ku janë përcaktuar kriteret për zgjedhjen e institucioneve të praktikës vëzhguese, informacion për zgjedhjen e agjencisë së praktikës psikologjike, procedurat e vlerësimit të dosjes së praktikës dhe përmbajtja e saj, vlerësimi i praktikës, detyrimet e studentit, aspekte që lidhen me respektimin e kodit etik të profesionit, detyrimet e supervisorit të praktikës, grafiku i shlyerjes së detyrimeve, institucionet e mundshme për praktikën, si dhe literatura e nevojshme (Dokumenti 137/4.4 Paketa e praktikës për programin e studimit, e-ASCAL).</p> <p>DPP ka hartuar një udhëzues të dedikuar “<i>Paketa e provës finale për mbrojtjen e diplomës Bachelor në Psikologji</i>” (2018), ku përshkruhen standardet lidhur me metodologjinë e punimit, mënyrën e prezantimit, kërkesat teknike dhe etikën e kërkimit. Gjithashtu, në këtë dokument janë pasqyruar pergjegjësitë e studentit dhe udhëheqësit të tij, si dhe tërësia e procedurave të propozimit, paraqitjes dhe mbrojtjes së provës</p>

	<p>finale (Dokumenti 138/4.5 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit; e-ASCAL).</p> <p>Për të siguruar vijueshmërinë e mësimit në kushtet e pandemisë COVID-19, UT ka hartuar një udhëzues të posaçëm për realizimin e mësimit online përmes platformës elektronike Microsoft Teams. Dokumenti përmban udhëzime metodologjike mbi mënyrën se si të kryhet mësimi në distance, si të përditësohen programet e lëndëve, si të vlerësohen studentët, etj. (166/1.15 Udhëzues UT për përdorimin e sistemit të mësimit në distancë, e-ASCAL). Kjo platformë vazhdon të përdoret gjerësisht nga stafi akademik për nevoja të procesit mësues. Aktualisht ajo shërben si bazë dokumentacioni e vënë në dispozicion të studentëve për të aksesuar shpejt dhe në kohë reale materialet mësimore, literaturën online, apo ciklet e leksioneve, artikujt e ndryshëm shkencorë, detyrat e kursit, për të shkëmbyer njoftime të ndryshme, etj. Pavarësisht zotërimit të rregulloreve dhe udhëzuesve të ndryshëm për aspekte dhe situata të caktuara të mësimdhënies, FSHS/DPP i ka të gjitha kapacitetet pedagogjike për të hartuar në të ardhmen një udhëzues në nivel institucional dedikuar zhvillimit dhe përdorimit të metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve që ofron.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>UT ka ngritur organet, autoritetet dhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë; - Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Universiteti; - Ekipin e Vlerësimit të Brendshëm të UT; <p>UT ka hartuar “Manualin e vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT” (2021), ku përcaktohen mënyrat dhe metodat e vlerësimit të personelit akademik të UT të të gjitha kategorive, duke filluar nga personeli me i ri e deri tek profesorët (fq. 6). Vlerësimi i performancës individuale të personelit akademik krijon mundësinë që të rritet motivimi dhe shkalla e angazhimit të tij në realizimin e procesit mësues, si dhe kërkimit shkencor me standarde dhe cilësi të lartë. Niveli i arritjes që rezulton nga vlerësimi synon të reflektohet në përfitime, korrigjime ose rekomandime për të ardhmen ndaj anëtarëve të personelit akademik (fq.7).</p> <p>UT ka zhvilluar “Paketën e instrumenteve të cilësisë” (2020), ku janë pasqyruar pyetësorë, anketa, etj. që aplikohen në</p>

procesin e vlerësimit dhe monitorimit të punës së personelit akademik në drejtim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe kërkimit shkencor (Materiali 165/1.14 Paketa e instrumenteve të cilësisë, e-ASCAL).

Gjithashtu, UT ka miratuar në parim “Rregulloren mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmësakademik dhe administrativ të UT” (2022) 158/1.7 (Rregullore për vlerësimin e performancës së personelit ndihmësakademik dhe administrativ në UT, e-ASCAL).

FSHS ka ngritur organet, autoritetet dhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si:

Komisioni/Komiteti i Sigurimit të Cilësisë (KSC);

Njësia e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në nivel fakulteti e cila e bazon punën e saj në Rregulloren e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të UT, Rregulloren e NJSC (2020), dhe udhëzimet përkatëse të ASCAL;

Komisioni i përhershëm i sigurimit të cilësisë së FSHS përgjigjet për politikën e vlerësimit dhe zbatimit të procedurave të menaxhimit të cilësisë, si dhe këshillon dekanatin e FSHS për çeshtje të cilësisë (Urdhër i Brendshëm nr. 14/2, datë 15.07.2021, Materiali 32/2.12 ose 182/2.12 Vendim i FSHS për ngritjen e Njesise se Sigurimit te Cilesise; e-ASCAL).


NJSC është një strukturë ndihmësakadematike me karakter administrativ që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e FSHS. Kjo njësi ka si mision të planifikojë, të organizojë dhe të publikojë veprimtarinë në kuadër të sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti dhe për programet e studimit (Urdhër i Brendshëm nr. 14/1, datë 15.07.2021, Materiali 32/2.12 ose 182/2.12 Vendim i FSHS për ngritjen e Njesise se Sigurimit te Cilesise; e-ASCAL).

Në Rregulloren e DPP (2021), Neni 8, “Përgjegjësitë e drejtuesit të DPP”, pika 8.3, gërma “m”, “Për kompetencat administrative të drejtuesit të departamentit”, përkthuhet se “bën vlerësimin e performancës së personelit akademik të departamentit, bazuar në “Manualin e vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT” (në proces hartimi).

Referuar dokumentit “Format për raportin vjetor për veprimtarinë e kryera”, pika 2 e saj, informohet se “Përgjegjësi i departamentit përmes koordinatoreve të programeve dhe studentëve monitoron dhe vlerëson vazhdimisht mësimdhënien, ku çdo semester zhvillon pyetësorin e

<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p><i>studentëve, si dhe harton raporte mbi pyetësorin e studentëve dhe të pedagogëve” (fq. 2). (144/ 4.11 Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit; e-ASCAL).</i></p> <p>Në Rregulloren e NJSC (2020), Neni 6 “<i>Veprimtari monitorimi, vlerësimi dhe përmirësimi</i>”, pika 4 shprehet se “<i>Monitorimi, vlerësimi dhe përmirësimi bëhet në mënyrë periodike dhe për raste të vecanta</i>” (fq. 3). Në Nenin 7 të kësaj Rregullore “<i>Për Komitetin e sigurimit të cilësisë së FSHS</i>”, pika 2, shprehimisht thuhet se “<i>KSC-ja ka pesë anëtarë, një përfaqësues të dekanatit, dy përfaqësues të të personelit akademik, një personel ndihmësakademik dhe një përfaqësues të studentëve</i>” (fq. 4). (Materiali 184/2.14 Rregullore e NJSC (2020) e-ASCAL).</p> <p>Referuar dokumentit “<i>Përshkrim i veprimtarisë së NJSC së FSHS</i>”, lidhur me detyrat e NJSC, gërma “h”, specifikohet se “<i>Në fund të çdo semestri apo përpara sezonit të provimeve, sipas kalendarit përkatës, (njësia e sigurimit të cilësisë) organizon vlerësimin studentor për cilësinë e mësimdhënies</i>” (fq. 2). (Materiali 33/2.13, e-ASCAL)</p> <p>Sipas dokumentit “<i>Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së (2021), “Vlerësimi i personelit akademik në njësitë përbërëse të Universitetit bëhet nga grupe të ndryshëm vlerësuesish...”</i>” (fq.9). Në Tabelën nr. 1 “<i>Subjektet që bëjnë vlerësimin e personelit akademik</i>” (fq. 10), vërehet se pjesë e grupeve të vlerësimit janë edhe studentët me të cilët pedagogët zhvillojnë mësim. Në Aneksin nr. 3 të këtij Manuali, është pasqyruar “<i>Formati vlerësimit nga studentët</i>” (fq. 29), e cila tregon se UT/FSHS garanton të drejtën e përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve (Dokumenti 14/1.13 Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së (2021). Aneksi nr. 3, Format i vlerësimit nga studentët (fq. 29); e-ASCAL).</p> <p>Dokumenti “<i>Urdhër i KSC, nr. 7, datë 14.02.2021, “Për informimin e pedagogëve dhe drejtuesve të departamenteve për rezultatet e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies nga studentët për vitin akademik 2021-2022</i>”, bashkangjitur një kopje e Formularit të vlerësimit të lëndës nga studenti, formularit të vlerësimit për pedagogun dhe Tabela me rezultatet të organizuara në kategori dhe të paraqitura në %, janë dëshmi se FSHS që angazhohet për përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të</p>
---	---

	<p>mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. (Dokumenti 11/7. Kopje të formulareve të vlerësimit, e-ASCAL, Kategoria: Vizita dy ditore dhe dokumentacioni shtesë).</p> <p>Bazuar në deklaratimet e autoriteve drejtuese të FSHS/DPP, stafit akademik dhe studentëve të programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, pohohet se “Përfshirja e studentit në vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe përdorimi i formatit të vlerësimit të lëndës dhe vlerësimit për pedagogun, realizohet në fund të çdo semestri. Studenti ka mundësi të shprehet në mënyrë anonime për pedagogët e angzhuar në mësimdhënie, por edhe për stafin ndihmës në mbështetje të mësimdhënies. Administrimi i pyetësorit u lejon atyre ruajtjen e anonimatit gjatë dhënies së vlerësimit”. (informacion i konfirmuar në takimet gjatë vizitës në institucion, korrik 2022).</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSC e FSHS është një strukturë ndihmësakademike me karakter administrativ që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e FSHS. Kjo njësi ka si <i>mission</i> të planifikojë, të organizojë dhe të publikojë veprimtarinë në kuadër të sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti dhe për programet e studimit (Urdhër i Brendshëm nr. 14/1, datë 15.07.2021, Materiali 32/2.12 ose 182/2.12 Vendim i FSHS për ngritjen e Njesise se Sigurimit te Cilesise; e-ASCAL).</p> <p>Referuar dokumentit “Përshkrim i veprimtarisë së NJSC së FSHS”, mësohet se “Në fillim të çdo viti akademik, njësia e sigurimit të cilësisë harton planin e veprimtarisë monitoruese dhe vlerësuese dhe ia paraqet dekanit të FSHS për miratim. Për çdo veprimtari monitoruese dhe vlerësuese përgatit paketën me instrumentet dhe metodologjinë e përpunimit të të dhënave dhe informacionit. Në përfundim të çdo viti akademik përgatit raportin e veprimtarisë vjetore të NJSC për sigurimin e cilësisë dhe ia paraqet dekanatit të FSHS dhe KSC të FSHS. Komunikimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit, si dhe përdorimi i të dhënave të monitorimit dhe vlerësimit kryhen në përputhje me Politikën e sigurimit të cilësisë së UT dhe FSHS (fq.3). (Materiali 33/2.13, e-ASCAL).</p> <p>Sipas Rregullores së Sigurimit të Cilësisë të FSHS (2020), Neni 22 “Komunikimi dhe publikimi i rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit”, pika 4, mësohet se “Komunikimi dhe publikimi kryhet në këto mënyra: a) Raportet e monitorimit u komunikohen organeve, strukturave dhe autoriteteve përkatëse të FSHS; b) Raportert e vlerësimit</p>

	<p>të brendshëm bëhen publike; c) Raportert e vlerësimit të jashtëm bëhen publike; d) Vendimet e akreditimit institucional dhe të programeve bëhen publike; e) Vlerësimi i programeve të studimit, vlerësimi i lëndëve dhe mësimdhënies publikohen në mënyrë të përmbledhur; f) Raportet e vlerësimeve individuale u komunikohen individualisht individëve; g) Rezultatet e vlerësimit të arritjeve u komunikohen individualisht studentëve”.</p> <p>Referuar dokumentit të DPP-së mbi “Format për raportin vjetor për veprimtaritë e kryera”, pika 2 e saj, mësohet se “Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit bëhen të njohura nga strukturat përgjegjëse dhe diskutohen në tërësi pikat e forta dhe të dobta të nxjerra nga vlerësimet në mbledhjet e departamentit” (fq. 2). (144/ 4.11 Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit; e-ASCAL).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë të FSHS (2020), Neni 13 “Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë bazë” lidhur me sigurimin e cilësisë, pika g, përshkruan se “Drejtuesi i departamentit përdor informacionin e vlerësimit për qëllime të përmirësimit të veprimtarisë së njësisë që drejton, të përmirësimit të programeve të studimit dhe të promovimit të personelit akademik”.</p> <p>Në Nenin 23 të kësaj Rregullore, “Për përdorimin e të dhënave të monitorimit dhe të vlerësimit”, specifikohet se “Të dhënat e monitorimeve dhe vlerësimeve të parashikuara në këtë rregullore, përdoren për: a) përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm; b) akreditim; c) përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, të mësimdhënies, të kërkimit, të shërbimeve dhe të menaxhimit; d) planifikimin vjetor dhe strategjik të FSHS; e) përmirësimin e performancës së personelit akademik, ndihmëskademi dhe administrativ”.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në Rregulloren e programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018), Neni 21 “Format e mësimit”, pika 1, përshkruhet se “Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, seminarëve, detyrave të kursit, prezantimeve, projekteve të kërkimit, posterave, praktikës”.</p> <p>Referuar programeve lëndore të programit të studimit Bachelor në Psikologji, veçanërisht rubrikës “Format e kontrollit të dijeve”, vërehet se përveç testimit/provimit si një formë e vlerësimit të rezultateve të nxënit, theksi vihet në përfshirjen e metodave që sigurojnë aktivizimin dhe pjesëmarrjen e studentëve në diskutime, ushtrime praktike, detyra kursi individuale, esse, punë në grupe, angazhim në punë të pavarura kërkimore, prezantim të detyrave studimore, etj. (Materiali 134/4.3. Programet e lëndëve të programit të studimit Bachelor në Psikologji; e-ASCAL).</p> <p>Nga takimi me stafin akademik dhe studentët dëshmohet se sistemi i transmetimit të dijeve bazohet kryesisht në leksionet, seminarët dhe praktika profesionale, të cilat organizohen në mënyrë interaktive duke përdorur metoda dhe teknika të ndryshmetë mësimdhënies dhe të nxënit, si: lojë me role, brainstorming, diskutim në grup, raste studimore, vëzhgime në situata praktike, refleksione, nxitje e mendimit kritik dhe zgjidhjes problemore, prezantime në PowerPoint, etj, duke mbështetur jo vetëm një të kuptuar më të mirë të tematikave që diskutohen në leksione dhe seminare, por edhe duke siguruar lidhjen e nevojshme të teorisë me praktikën (informacion nga takimet në kuadër të vizitës në institucion, korrik 2022). Gjithashtu, një formë tjetër e transmetimit të dijeve është edhe përfshirja e studentëve në konferenca kombëtare/ndërkombëtare të organizuara nga FSHS/DPP, si dhe në workshope profesionale, apo orë mësimi të hapura, konsultime tematike dhe veprimtari të tjera të miratuara nga institucioni.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e</p>	<p>Personeli akademik i FSHS/DPP ka përfutuar ndër vite nga projekte të mobilitetit dhe trajnimet në fushën e mësimdhënies në AL, duke pasuruar dhe përmirësuar më tej metodat e mësimdhënies në përgjigje të diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar metoda dhe mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies në AL, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>

<p>programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Referuar dokumentit “<i>Relacion mbi zhvillimin e mësimdhënies në programin Bachelor në Psikologji</i>” (2020-2021), mësohet se stafi akademik që mbulon programin e studimit të marrë në vlerësim, ka marrë trajnim në fushën e TIK për realizimin e mësimdhënies online nëpërmjet platformes elektronike TEAMS, e cila vijon të shfrytëzohet nga stafi për komunikim me studentët, për detyrat me shkrim, shpërndarjen e literaturës online, konsultime me grupe të vogla studentësh, etj, si një mundësi alternative e mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, që i përgjigjet diversitetit të nevojave të studentëve për të nxënë. (Materiali 122/3.18 Raport për veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik.pdf e-ASCAL).</p> <p>Gjatë takimit me studentët, GVJ pati mundësi të bashkëbisedojë edhe me një studente me AK, e cila shpjegoi se institucioni mbështet përpjekjet e saj për të përfituar arsimim të barabartë, si dhe pedagogët lehtësojnë procesin e të nxënës duke përdorur forma dhe metoda të ndryshme të mësimdhënies në përgjigje të studentëve me nevojave të veçanta.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>FSHS/DPP si pjesë e UT-së, mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Sipas dokumentit “<i>Format për raportin vjetor për veprimtaritë e kryera</i>”, pika 3.2 e saj, DPP sqaron se “<i>Meqënëse UT ka një zyrë koordinimi për projektet Erasmus+ pranë rektoratit, të gjitha trajnimet në lidhje me këtë program janë zhvilluar në nivel universiteti dhe jo njësie bazë</i>” (fq. 6).</p> <p>Në pikën 3.3 të këtij raporti, DPP informon se “<i>Ka pasur disa shkëmbime përvojash në fushën e mësimdhënies midis stafit të DPP dhe profesorit të huaj. të mbuluara nga projektet Erasmus+</i>”. Në pikën 3.4 DPP shpjegon se “<i>Departamenti ka zhvilluar konferenca në fushën e pedagogjisë dhe psikologjisë të mbështetura nga buxheti i fakultetit</i>” (Materiali 144/ 4.11, Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit; e-ASCAL).</p> <p>Referuar dokumentit “<i>Relacion mbi zhvillimin e mësimdhënies në programin Bachelor në Psikologji</i>” (2020-2021), mësohet se stafi akademik që mbulon programin e studimit të marrë në vlerësim, ka marrë trajnime të mbështetura institucionalisht për të përmirësuar kompetencat e tij në fushën e teknologjisë informatike me synim realizimin e mësimdhënies online nëpërmjet platformës elektronike TEAMS, të cilën shumica e</p>

	<p>tyre vijojnë ta shfrytëzojnë për komunikim me studentët, për detyrat me shkrim, shpërndarjen e literaturës online, konsultime, njoftime, etj. (Materiali 122/3.18 Raport për veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik.pdf e-ASCAL).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Referuar tabelës mbi “Të dhënat e stafit të Fakultetit, Departamentit dhe programit të studimit për vitin akademik 2021-2022” (Material nr. 5, Seksioni “Vizita dy ditore në IAL, dhe domumentacioni shtesë, e-ASCAL), mësohet se aktualisht Departamenti i Psikologji Pedagogjisë ka në përbërje të tij 23 Personel Akademik Efektiv (PAE), nga të cilët 6 mbajnë titullin Prof.Dr., 4 janë Prof.Asoc.Dr., 12 kanë gradën Dr. , si dhe 105 Personel Akademik me Kontratë (PAK), nga të cilët 6 mbajnë titullin Prof/Dr., 4 Prof.Asoc. Dr., 43 kanë grade Dr., 3 Proc. Dr., dhe 49 MSc. Gjithashtu, DPP ka në përbërje të tij edhe një Personel Ndihmësakademik (PN).</p> <p>Bazuar në CV-në e personelit akademik që mbulon programin e studimit Bachelor në Psikologji, mund të vërehet se secili prej tyre spikat për nga niveli i kualifikimit në fushat e specialitetit. Shumica e PA me kohë të plotë dhe të pjesshme mban grada e tituj shkencorë dhe një pjesë e tyre demonstroi një prodhimtari të admirueshme në fushën e publikimeve shkencore dhe metodologjike (Materiali 130/3.26 Lista e titujve të publikuara nga stafi i Departamentit Pedagogji-Psikologji, e-ASCAL).</p> <p>Nga krahasimi i të dhënave të CV-së së PA dhe syllabuseve të lëndëve që ata zhvillojnë, vërehet një përputhje midis fushës akademike dhe kërkimore të titullarit të lëndës/modulit dhe profilit të programit lëndor dhe studimor që ai zhvillon.</p> <p>FSHS/DPP respekton procedura dhe kriteret (të përgjithshme, të veçanta dhe preferenciale) të parashikuara në dokumentin “Manualin për punësimin e personelit në UT” (2022), për përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për t’i angazhuar si staf akademik me kohë të plotë ose të pjesshme në realizimin e programit të studimit Bachelor në Psikologji (Materiali 163/1.12, Manuali për punësimin e personelit në UT, e-ASCAL). Ky tregues përbën një element të rëndësishëm për të siguruar cilësinë e mësimdhënies në realizimin e veprimtarive mësimore të programit Bachelor në Psikologji. Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi nga takimi me studentët, se stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit të</p>


	<p>programit të studimit Bachelor në Psikologji. DPP krenohet me profesoratin e saj, një pjesë e të cilëve janë personalitete me emër në fushën e psikologjisë dhe pedagogjisë, të njohur kombëtarisht për kontributin e dhënë ndër vite në AL, në drejtim të ndërtimit dhe përmirësimit të kurrikulave, përgatitjes së teksteve universitare, një pjesë e të cilave përdoren jo vetëm nga stafi akademik i DPP, por edhe nga pedagogë të institucioneve të tjera të arsimit të lartë në vend.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Sipas dokumentit “Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT-së (2021)”, “Vlerësimi i personelit akademik në njësitë përbërëse të Universitetit bëhet nga grupe të ndryshëm vlerësuesish...” (fq.9). Në pikën 4 të këtij dokumenti “Për parimet e vlerësimit” specifikohet se “Përgjithësisht vlerësimi bëhet nga disa aktorë, që janë drejtuesi i njësisë bazë, vetë personi (anëtar i personelit akademik), studentët dhe grupi i vlerësimit të njësisë bazë...(fq. 8). Në vijim të dokumentit, në Tabelën nr. 1 janë pasqyruar subjektet që bëjnë vlerësimin e personelit akademik, duke përfshirë vetëvlerësimin dhe vlerësimin nga studentët (fq. 10). Në Aneksin nr. 1, është paraqitur “Formulari i planifikimit të objektivave të performancës, sipas veprimtarive për personelin akademik/drejtues” që materializon procesin e vetëvlerësimit nga ana e personelit akademik. “Mbi bazën e objektivave të parashikuara, personeli angazhohet për realizimin e tyre në kohë dhe me cilësi. Në fund të vitit akademik, secili pedagog plotëson pasqyrën e realizimit të objektivave të parashikuara, të cilat duhet të jenë të dokumentuara në dosje të veçantë pranë njësisë bazë. Kjo tabelë analizohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe grupi i vlerësimit/përgjegjës i lëndës, të cilën e gjejnë atë korrekte ose jo, dhe firmosin nëse është e saktë” (fq.19) (Dokumenti 14/1.13 Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së (2021).</p> <p>Në Aneksin nr. 3 të Manualit, është pasqyruar “Formati vlerësimit nga studentët” (fq. 29), ku tregohet se UT/FSHS garanton të drejtën e studenëve për t’u përfshirë në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve (Dokumenti 14/1.13 Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së (2021). Aneksi nr. 3, Formatit vlerësimit nga studentët (fq. 29); e-ASCAL).</p> <p>Gjithashtu, referuar dokumentit “Format për raportin vjetor për veprimtaritë e kryera”, pika 2 e saj, informohet se “Përgjegjësi i departamentit përmes koordinatoreve të</p>

	<p><i>programeve dhe studentëve monitoron dhe vlerëson vazhdimisht mësimdhënien, ku çdo semester zhvillon pyetësonin e studentëve, si dhe harton raporte mbi pyetësonin e studentëve dhe të pedagogëve” (fq. 2). (144/ 4.11 Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit; e-ASCAL).</i></p> <p>Tërësia e procedurave të vlerësimit dhe vetëvlerësimit e ndihmojnë personelin akademik të reflektojë mbi objektivat e parashikuar dhe realizimin e tyre, si nga ana sasiore ashtu edhe nga ana cilësore, si dhe të fuqizojë kulturën e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Në dokumentin “Kodi i etikës së UT” (2011), Neni 6 “Përhapja e dijeve dhe liria akademike”, në pikën 1, përcaktohet se “Personeli akademik gëzon liri akademik në kërkimet, në punimet shkencore dhe metodologjinë e mësimdhënies. Pedagogët duhet t’i përmbahen përdorimit të ndërgjegjshëm të lirisë akademike, duke iu nënshtruar një programi mësimor të miratuar. Ata duhet të realizojnë me performance të lartë kërkimin, mësimdhënien dhe praktikën, nëpërmjet leximit, studimit, eksperimentit, vëzhgimit, shkëmbimit dhe vetëvlerësimit objektiv duke zgjedhur metoda dhe mënyra efikase, të dobishme, të kuptueshme dhe frytdhënëse për studentët” (fq. 4). (Materiali 156/ 1.5 Kodi i Etikes UT (2011), e-ASCAL).</p> <p>Refruar programeve lëndore të përgatitura nga titullarët e lëndëve përkatëse, vërehet se theksi është vënë në përdorimin e metodave interaktive dhe diskutimit, duke synuar që orët e mësimit të jenë tërheqëse dhe gjithëpërfshirëse. Ndeshet një larmishmëri e formave të përdorura në mësimdhënie, si: lojë me role, studim rasti, fokus-grupe, brainstorming, diskutim mbi detyrat studimore, refleksione dhe analiza, etj., që e vënë studentin në një pozicion aktiv gjatë orës së mësimit (Dokumenti 136/4.3 Programet mësimore të lëndëve të programit 2018-2019-2020, e-ASCAL).</p> <p>Studentët e programit Bachelor në Psikologji kanë adresuar komente pozitive për pedagogët e tyre, gjatë takimit/vizitës në institucion, lidhur me metodat interaktive të përdorura gjatë leksioneve, seminareve dhe veprimtarive të tjera mësimore.</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë</p>	<p>Në dokumentin “Kodi i etikës së UT” (2011), Neni 6 “Përhapja e dijeve dhe liria akademike”, në pikën 3, kërkohet se “Pedagogët duhet të përmirësojnë vazhdimisht metodologjinë në mënyrë që të kenë efektivitet në mësimdhënie, të inkurajojnë studentët për të vepruar në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.a

Web site: www.ascal.al

udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.

mënyrë të lirë dhe të pavarur, si dhe t'u shpjegojnë atyre metodat e vlerësimit” (fq. 4). (Materiali 156/ 1.5 Kodi i Etikes UT (2011), e-ASCAL).

Sipas “Manualit të vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT-së (2021), lidhur me elementet që përmirësojnë cilësinë e veprimtarisë mësimore, institucioni inkurajon pesonelin akademik që të angazhohet në “mbështetjen e studentëve nëpërmjet këshillimit dhe orientimit ... mbikqyrjes së detyrave individuale, punës kërkimore, etj.” (fq 6) (Dokumenti 14/1.13 Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së (2021).

Bazuar në syllabuset lëndore të programit të studimit Bachelor në Psikologji, vërehet se titullarët e lëndëve/moduleve kanë përfshirë forma dhe metoda të mësimdhënies, të tilla si: diskutimi, punimi i detyrave individuale, ese reflektuese, studime rasti, etj, që inkurajojnë sensin e autonomisë së studentëve.

Gjithashtu, FSHS/DPP mirëpret ushtrimin e të drejtës së studentit për ankimim, të sanksionuar në Rregulloren e FSHS (2018), Neni 37 “Ankimimi”, pika 1, ku specifikohet se “Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit...”, dhe pika 4 “Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin e provimit...” (Materiali 174/2.4 Rregullore e FSHS, e-ASCAL).

Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se procesi i mësimdhënies dhe të nxënies në FSHS realizohet në një klimë pozitive. Pedagogët respektojnë lirinë e mendimit të studentëve, duke krijuar kushte të favorshme që stimulojnë arsyetimin e thellë dhe të menduarit kritik e krijues të tyre.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Prej vitit 2014, FSHS është vendosur dhe kryen veprimtarine e saj mesimore shkencore në një godinë të re dhe të rikonstruktuar plotësisht në funksion të një procesi bashkëkohor të ndërveprimit akademik. <i>(Materiali 54/2.33 - Raporti i ekspertit për infrastrukturën (mbrojtja nga zjarri, higjiena, sigurimi i godinës, e-ASCAL).</i></p> <p>Sipas dokumentit “Të dhëna për infrastrukturën FSHS”, Fakulteti i Shkencave Sociale zhvillon aktivitetin e tij në një godinë me katër kate. Godina ka në dispozicion një sipërfaqje prej 7977 m² në total, ku 7154 m² shrytëzohen për mjedise për zhvillimin e mësimimit të programve të studimit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë, dhe 823 m² janë zyra për stafin. Gjenden 6 salla leksionesh, 16 klasa për seminarët, 2 salla për aktivitete promovuese, 1 sallë për praktikë lëndore/profesionale, 1 sallë interneti, 2 salla për bibliotekën, 1 mjedis për fotokopjime e librari, 1 zyrë informacioni për studentët, 4 koridore, 4 mjedise mbështetëse, 1 mjedis për aktivitete të qeverisë studentore, 14 nyje hidrosnitare për studentët. Këto mjedise përdoren nga 2690 studentë. Hapësira për një student rezulton afërsisht 2.7 m²/për student.</p> <p>Në dokumentin “Të dhëna për infrastrukturën FSHS” shënohet gjithashtu, se në këtë fakultet mësimi zhvillohet me dy turne <i>(Materiali 53/2.33 Të dhëna për infrastrukturën FSHS, e-ASCAL).</i></p> <p>Fakti që në godinën e FSHS, mësimi zhvillohet me dy turne, tregon se numri i sallave për leksione, seminare dhe veprimtari të tjera mësimore nuk është plotësisht i mjaftueshëm. Nga kqyrja e mjediseve mësimore, gjatë vizitës në institucion, u vërejt se sallat e leksioneve dhe seminareve në dispozicion të procesit mësimor, janë të pajisura me videoprojektor dhe internet. Mjediset janë të ajrosura, të pastra dhe mirëmbahen nga stafi i kontraktuar për këtë shërbim.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Nga kqyrja e mjediseve mësimore, gjatë vizitës në institucion, u vërejt se ambientet në mbështetje të procesit mësimor janë arraduar sipas standardeve të kërkuara dhe funksionale. Ato janë të ndriçuara dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimor, si videoprojektorë. Sallat e leksioneve janë të pajisura me internet. Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor një sallë informatike të vendosur në ambientet e bibliotekës, si dhe një mjedis për fotokopjime e librari për studentët. Ambientet e FSHS janë të mbuluara me sinjal wifi në mënyrë që studentët dhe pedagogët të aksesojnë lirisht në web.</p>

<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Universiteti i Tiranës ofron për personelin akademik dhe studentët platformën online “Microsoft Teams” (<i>Dokumenti 1.15 Udhëzues i UT-së për përdorimin e sistemit të mësimi në distancë</i>). Personeli akademik sqaron se kjo platformë ka nisur të përdoret fillimisht në përgjigje të kushteve të izolimit nga pandemia Covid19, por gradualisht kjo infrastrukturë është konsoliduar dhe vijon të përdoret nga pedagogët dhe studentët për nevoja mësimore, si: leksione, literaturë online, materiale shtesë audio-vizive, njoftime, konsultime, etj.</p> <p>UT/FSHS është abonuar në platforma online dhe shfrytëzon bibliotekat online për nevoja mësimore dhe kërkimore, si EuroPS – Services; Publications UNRISD; Springer; Journals.Sage Pub; Wiley dhe U-library-COBISS (<i>Dokumenti 2.31 dhe 2.32 Relacioni mbi Fondin e Bibliotekës së FSHS dhe Buxheti për Bibliotekën për vitin e fundit</i>).</p> <p>Ambjentet e FSHS janë të mbuluara me sinjal wifi në mënyrë që studentët dhe pedagogët të aksesojnë lirisht në web.</p> <p><i>Megjithatë, GVJ sugjeron që FSHS mund të ngrejë një laborator të IT në mbështetje të procesit mësimor, si dhe të zhvillimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave të studentëve në fushën e TIK.</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Psikologji ofrohet në gjuhën shqipe. Nga shqyrtimi i programeve lëndore të programit të studimit, rezulton se literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve, në gjuhën shqipe dhe angleze (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. Lidhur me këtë element të programit lëndor, janë evidentuar disa praktika të mira të përditësimit të literaturës. Gjenden disa syllabuse që kanë përfshirë rishikimin e ciklit të leksioneve ose botime të 5 viteve të fundit si: 2017; 2018; 2019 dhe 2020 (<i>Materiali 136/4.3.3 “Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit 2020-2021”, fq. 167; 172; 178; 212; 229; e-ASCAL</i>).</p> <p>Një pjesë e syllabuseve kanë nevojë të përditësojnë në mënyrë të vazhdueshme literaturën duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse kryesisht të 5 viteve të fundit.</p> <p>Gjithashtu, janë vërejtur raste kur literatura bazë e detyruar dhe ndihmëse/rekomanduar dominohen kryesisht nga botime në gjuhë të huaj angleze (<i>Materiali 136/4.3.3 “Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit 2020-2021”, fq. 150-151; 161; 242-243; e-ASCAL</i>).</p>

	<p>Për këto raste, gjatë takimit në institucion, stafi akademik arsyetoi se studentët zotërojnë gjuhën angleze dhe punojnë lehtësisht me literaturën në gjuhë të huaj. Përvec kësaj, shpjeguan se titullarët e lëndëve kanë përgatitur cikle të leksioneve në gjuhën shqipe. Ndërkohë, studentët pohuan gjatë takimit në institucion se ata nuk ndihen të mbingarkuar me literaturën bazë dhe të rekomanduar në gjuhë angleze.</p> <p><i>Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë fondin e të librave (fizik dhe elektronik) që numëron aktualisht biblioteka e institucionit, <u>GVJ sugjeron që të rritet përpjekja e përbashkët e stafit akademik për të siguruar përditësimin në vazhdimësi të literaturës bazë dhe ndihmëse në syllabuset lëndore, si dhe t'ju vihet në dispozicion studentëve në gjuhën e programit të studimit.</u></i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>FSHS ka dy salla bibliotekë me një sipërfaqe 189.5 m². Kapaciteti i bibliotekës plotëson nevojat për lexim/studim të studentëve dhe personelit akademik. Biblioteka është e pajisur me tetë kompjutera dhe internet. Në fondin e bibliotekës janë rreth 7343 tituj fizik gjithsej, dhe 3906 libra fizik gjithsej, si dhe 154 periodike revista/buletine shkencore në shqipe dhe në gjuhë të huaj. Fondi i librave gjendet në format hardcopy dhe elektronik dhe duket se plotëson nevojat e të gjithë përdoruesve. Tituj në gjuhë shqipe janë gjithsej 2573, ndërsa në gjuhë të huaj, kryesisht, anglisht, fengjisht, italisht, janë gjithsej 1333 tituj. Rreth 869 tituj fizik janë vetëm për fushën e Psikologjisë. Literature e përditësuar e viteve të fundit përmbledh një fond prej 496 titujsh. (<i>Materiali 50/2.29 Informacion për bibliotekën, e-ASCAL</i>).</p> <p>Publikime të stafit akademik të Departamentit të Pedagogjisë Psikologjisë- të viteve të fundit, përfshihen libra mësimor, manual të ndryshme për fushën akademike dhe të shërbimeve psiko-sociale, monografi etj, janë aktualisht 47 tituj (<i>Dokumenti 81/ 3.26 Botime te stafit te brendeshem departamenti i psikologji-pedagogji</i>).</p> <p>Studimet kërkimore të realizuara nga studentët e doktoraturës në bashkëpunim me stafin akademik përbëjnë një fond të pasur prej 157 titujsh. Gjithashtu, në bibliotekë ka tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse për studentët, përkthime të ndryshme, fjalorë, online. Biblioteka është pasuruar edhe me revista shkencore në fushën e shkencave sociale, por edhe në fusha të tjera të studimit e kërkimit shkencor. Pasurimi i literaturës në përputhje me kurrikulat mësimore është process i vazhdueshëm, që kryhet nëpërmjet blerjeve të planifikuara,</p>

	<p>dhurimeve, artikujve shkencore, tezave të diplomave, si dhe nëpërmjet pasurimit periodik me kolanën e botimeve me revista shkencore (2.31 Buxhetimi për pasurim të bibliotekës FSHS).</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Sociale ka në dispozicion një sërë platformash e bibliotekash online që u japin mundësi studentëve dhe stafit akademik ta shfrytëzojnë në kohë reale, duke mundësuar akses në libra, revista e artikuj shkencore të viteve më të fundit. Në këtë kuadër mund të përmenden abonimet me akses të financuar nga FSHS, të tilla: EuroPS-Services; Publications UNRISD; Springer; Journals Sage Pub; Wiley. Sipas bisedës me punonjësen e bibliotekës, procedura e aksesimit të këtyre adresave elektronike kërkon që përdoruesi (studenti/pedagogu) të pajiset me një username dhe një fjalëkalim. Gjithashtu, për pedagogët dhe studentët është mundësuar akses i lirë në: Libraria digjitale JSTOR; UNRISD website publications; Katalogu online në platformën Cobiss.net Albania (akronim UTFSHS).</p> <p>Për pedagogët është mundësuar akses në revistat (online) si: History and Theory; International Journal of Human Rights; Social and legal Studies; European Journal on Criminal Policy and Research crime, laë and social change</p> <p>Me ndihmën e Ambasades Franceze në Tiranë, është mundësuar akses në: http://www.cairn.info/; http://www.persee.fr/; https://www.erudit.org/; http://www.revues.org/; Açueil - Archive ouverte HAL (Materiali 50/2.29 Informacion për bibliotekën, e-ASCAL).</p> <p>Libraritë elektronike janë të pasura e të përditësuara në fondin e librave, ku studentët mund të lexojnë dhe shkarkojnë libra, revista, raste studimore dhe publikime të ndryshme të autorëve më të njohur, duke mundësuar të lexuarin, studimin dhe të eksploruarit online, sipas interesave të tyre mësimore. Studentët dhe stafi akademik kanë akses në shfrytëzimin online të faqeve elektronike. Link-et janë instaluar tek kompjuterat e salles së leximit në bibliotekë, dhe ato mundësohen jo vetëm në bibliotekë, por edhe nga distanca përmes, website Fakultetit të Shkencave Sociale.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike</p>	<p>Referuar të dhënave për infrastrukturën e FSHS, vërehet se mungojnë laboratorët lëndore (Materiali 53/2.33 Të dhëna për infrastrukturën FSHS, e-ASCAL).</p> <p>Për realizimin e detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike të studentëve, institucioni ka vënë në dispozicion</p>

<p>shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>sallën e kompjuterave, mjediset fizike dhe virtuale të bibliotekës, dhe salla të tjera mësimore të cilat janë komode dhe të pajisura me internet (<i>Informacion i siguruar gjatë vizitës në institucion, korrik 2022</i>).</p> <p><u>GVIJ sugjeron që në ardhmen të konsiderohet mundësia për të krijuar një laborator të dedikuar lëndëve me natyrë praktike në fushën e psikologjisë.</u></p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platformën online “Microsoft Teams”. Kjo platformë ka filluar të përdoret për mësimdhënien në distancë gjatë situatës së pandemisë Covid-19. Stafit ka marrë trajnime në këtë fushë dhe vijon ta përdorë platformën online “Microsoft Teams”, duke inkurajuar studentet që të eksplorojnë hapësirën e-learning, të shkarkojnë materialet mësimore të hedhura nga pedagogët, si: leksione, materiale shtesë audio-vizive, botime online, etj., si dhe të ruajnë komunikimin e vazhdueshëm me stafin akademik për njoftime, informime dhe konsultime.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët, shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar. Ky proces realizohet nëpërmjet domain-it zyrtar të UT-së (outlook), E-student, emer.mbiemer@unitir.edu.al. Ky sistem kërkon që fillimisht përdoruesit të regjistrohen dhe në vijim mund të aksesojnë sistemin në çdo kohë dhe vend, duke shkëmbyer informacion në lidhje me procesin mësimor, sezonin e provimeve, pikët e grumbulluara në lëndë e module të ndryshme, etj.</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Në dokumentin “<i>Korniza konceptuale e programit të studimit Bachelor në Psikologji</i>”, Pika 9 “Provim/Temë diplome” shpjegohet se “Për të fituar diplomën e studimeve Bachelor në Psikologji, studentët përveç shlyerjes së detyrimeve në lëndët përkatëse, duhet t’i nënshtrohen provës përfundimtare e cila realizohet me: provim formimi ose temë diplome (sipas kriterëve të përcaktuara me vendim DPP). Për realizimin e temës së diplomës, studenti udhëhiqet nga supervizori shkencor që është pedagog me kohë të plotë ose të pjesshme pranë DPP i caktuar me miratim departamenti (Fq.10) (<i>Materiali 132/ 4.1 Korniza konceptuale e programit të studimit, e-ASCAL</i>).</p> <p>Për të lehtësuar dhe orientuar studentët në procesin e propozimit, punimit, paraqitjes dhe mbrojtjes së temës së diplomës, FSHS/DPP ka përgatitur dokumentin “<i>Paketa e</i></p>



	<p>provës finale për mbrojtjen e diplomës, Bachelor në Psikologji” (2018). Në këtë dokument përfshihen shpjegime, udhëzime, kërkesa teknike e etike, si dhe shëmbuj konkret për të siguruar standardet e një punimi diplome. Në dokument janë paraqitur edhe fushat e përgjithshme që orientojnë studentët në përcaktimin e temës së diplomës (fq 4). Gjithashtu, dokumenti përcakton edhe përgjegjësitë e studentit dhe përgjegjësitë e udhëheqësit, i cili mes të tjerash i kërkohet (b) “të japë mbështetjen profesionale dhe konsulencën e nevojshme që t’i mundësojë kandidatit të arrijë standard të larta të punimit”. (Material 138/4.5 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit, e-ASCAL).</p> <p>Gjatë takimit në institucion, studentët dhe stafi akademik pohuan se personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), si dhe asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>UT ka ngritur organet, autoritetet dhe strukturat/njësitë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si: Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Universiteti, Ekipin e Vlerësimit të Brendshëm të UT, të cilat promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>UT ka hartuar “Manualin e vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT” (2021), ku përcaktohen mënyrat dhe metodat e vlerësimit të personelit akademik të UT, të të gjitha kategorive, duke filluar nga personeli me i ri e deri tek profesorët (fq. 6). Vlerësimi i performancës individuale të personelit akademik krijon mundësinë që të rritet motivimi dhe shkalla e angazhimit të tij në realizimin e procesit mësimor, si</p>


	<p>dhe kërkimit shkencor me standarde dhe cilësi të lartë. Niveli i arritjes që rezulton nga vlerësimi synon të reflektohet në përfitime, korrigjime ose rekomandime për të ardhmen ndaj anëtarëve të personelit akademik (fq.7).</p> <p>UT ka zhvilluar “<i>Paketën e instrumenteve të cilësisë</i>” (2020), ku janë pasqyruar pyetësorë, anketa, etj. që aplikohen në procesin e vlerësimit dhe monitorimit të punës së personelit akademik në drejtim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe kërkimit shkencor (<i>Materiali 165/1.14 Paketa e instrumenteve të cilësisë, e-ASCAL</i>).</p> <p>Gjithashtu, UT ka miratuar në parim “<i>Rregulloren mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmësakademik dhe administrativ të UT</i>” (2022) 158/1.7 Rregullore për vlerësimin e performancës së personelit ndihmësakademik dhe administrativ në UT, e-ASCAL).</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>FSHS/DPP, si pjesë e UT ka ngritur struktura përgjegjëse të cilat zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p> <p>FSHS ka ngritur organet, autoritetet dhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si: Komisioni/Komiteti i Sigurimit të Cilësisë (KSC) dhe Njësia e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në nivel fakulteti, e cilat bazon punën e saj në Rregulloren Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të UT, Rregulloren e NJSC (2020), dhe udhëzimet përkatëse të ASCAL. Komisioni i përhershëm i sigurimit të cilësisë së FSHS përgjigjet për politikën e vlerësimit dhe zbatimit të procedurave të menaxhimit të cilësisë, si dhe këshillon dekanatin e FSHS për çështje të cilësisë (<i>Urdhër i Brendshëm nr. 14/2, datë 15.07.2021, Materiali 32/2.12 ose 182/2.12 Vendim i FSHS për ngritjen e Njësive të Sigurimit të Cilësisë; e-ASCAL</i>).</p> <p>NJSC është një strukturë ndihmësakademike me karakter administrativ që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e FSHS. Kjo njësi ka si mision të planifikojë, të organizojë dhe të publikojë veprimtarinë në kuadër të sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti dhe për programet e studimit (<i>Urdhër i Brendshëm nr. 14/1, datë 15.07.2021, Materiali 32/2.12 ose 182/2.12 Vendim i FSHS për ngritjen e Njësive të Sigurimit të Cilësisë; e-ASCAL</i>).</p> <p>Bazuar në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë të FSHS (2020), Neni 13 “<i>Përgjegjësitë e drejtuesit të njësive bazë</i>” lidhur me sigurimin e cilësisë, pika c, përkthyer se “Drejtuesi i</p>

	<p>departamentit i propozon dekanit anëtarin e Grupin e Vleresimit të Brendshëm (GVB) të FSHS-së dhe përbërjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të Njësisë Bazë, (GVB NJB).</p> <p>Në Regulloren e DPP (2021), Neni 8, “Përgjegjësitë e drejtuesit të DPP”, pika 8.3, gërma “m”, “Për kompetencat administrative të drejtuesit të departamentit”, përshkruhet se “bën vlerësimin e performancës së personelit akademik të departamentit, bazuar në “Manualin e vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT” (në proces hartimi).</p> <p>Referuar dokumentit “Format për raportin vjetor për veprimtaritë e kryera”, pika 2 e saj, informohet se “Përgjegjësi i departamentit përmes koordinatorëve të programeve dhe studentëve monitoron dhe vlerëson vazhdimisht mësimdhënien, ku çdo semester zhvillon pyetësorin e studentëve, si dhe harton raporte mbi pyetësorin e studentëve dhe të pedagogëve” (fq. 2). (144/ 4.11 Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit; e-ASCAL).</p> <p>FSHS/DPP dëshmon se është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët, për cilësinë e programeve të studimit që ofron.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Në dokumentin “Kodi i etikës së UT” (2011), Neni 6 “Përhapja e dijeve dhe liria akademike”, në pikën 1, përcaktohet se “Personeli akademik gëzon liri akademik në kërkimet, në punimet shkencore dhe metodologjinë e mësimdhënies. Pedagogët duhet t’i përmbahen përdorimit të ndërgjegjshëm të lirisë akademike, duke iu nënshtruar një programi mësimor të miratuar. Ata duhet të realizojnë me performancë të lartë kërkimin, mësimdhënien dhe praktikën, nëpërmjet leximit, studimit, eksperimentit, vëzhgimit, shkëmbimit dhe vetëvlerësimit objektiv duke zgjedhur metoda dhe mënyra efikase, të dobishme, të kuptueshme dhe frytdhënëse për studentët” (fq. 4). (Materiali 156/ 1.5 Kodi i Etikes UT (2011). e-ASCAL).</p> <p>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse në FSHS/DPP mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies përmes krijimit të hapësirave për organizimin e leksioneve të hapura me lektorë të ftuar vendas dhe të huaj, trajnimeve, simpoziumeve e konferencave, projekteve të mobilitetit, projekteve ndërkombëtare që kanë në fokus eksperimentimin me metoda të reja në AL. Një projekt i tillë është projekti LECU për “Competency-oriented</p>

	<p><i>Methodology</i>”, realizuar në bashkëpunim me Zurich University of Teacher Education, Switzerland, etj. (Materiali 189/2.18 Analize vjetore e punes se FSHS 2019-2020; 2020-2021, e-ASCAL).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Referuar dokumentit “<i>Politika të Zhvillimit Profesional të Personelit Akademik të FSHS</i>” (2020), çështja III “<i>Parimet e politikës</i>”, mes të tjerash theksohet se “<i>Strategjia e zhvillimit profesional të FSHS do të jetë proaktive dhe e përgjegjeshme ndaj nevojave të fakultetit, dhe do të kërkojë të sigurojë personel që të ketë interes për zhvillim të vazhdueshëm profesional që të zotërojë aftësi për t`u përditësuar me të rejat e fushës dhe ato të pedagogjisë së arsimit të lartë, për të ofruar një mësimdhënie dhe kërkim cilësor në një mjedis me kërkesa që ndryshojnë vazhdimisht</i>” (fq. 4). (Dokumenti 42/2.21 <i>Politika të Zhvillimit Profesional të Personelit Akademik të FSHS</i> (2020), e-ASCAL).</p> <p>FSHS/DPP zbaton politikën e saj të zhvillimit profesional duke krijuar mundësi të ndryshme për stafin akademik e ndihmësakademik, si dhe për studentët që përfshihen në programe mobiliteti ERASMUS+ në fushën e mësimdhënies, në projekte kërkimore e shkencore të përbashkëta, workshope, konferenca, tryeza të rrumbullakta, simpoziume, leksione të hapura me lektorë të ftuar, trajnime me temë kërkimin në fushën e mësimdhënies në AL, etj.</p> <p>Sipas tabelës përmbledhëse me të dhëna për mobilitetin e studentëve dhe pedagogëve të FSHS/DPP në kuadër të programit ERASMUS+, mësohet se gjatë 5 viteve të fundit kanë përfituar 19 pedagogë nga programet e mobilitetit dhe 31 studentë. (Material 75/3.20 <i>Të dhëna për mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve 2016-2022</i>, e-ASCAL).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik deklaroi se institucioni krijon mundësi që stafi akademik dhe ndihmësakademik të marrë pjesë pa pagesë në konferencat që organizon UT dhe FSHS. Gjithashtu, ata u shprehen se institucioni financon pedagogët një herë në dy vjet për një pjesëmarrje në një konferencë jashtë vendit, duke përfshirë udhëtimin, akomodimin dhe fee të konferencës. Në FSHS/DPP, personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë</p>	<p>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse në FSHS/DPP trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive</p>



<p>vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. Në dokumentin “Politika të Zhvillimit Profesional të Personelit Akademik të FSHS” (2020), janë pasqyruar llojet e veprimtarive që përmban programi i zhvillimit profesional në FSHS (fq. 8), të tilla si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kurs trajnimi për certifikatë për mësimdhënie në arsimin e lartë; 2. Kurse të shkurtra sipas nevojave të identifikuara në mbështetje të zbatimit të risive pedagogjike; 3. Konferenca, seminare, shkollë verore, telekonferenca webinar, etj., për të mbështetur zhvillimin e përmbajtjes së lëndës, ekspertizën pedagogjike, zhvillimet më të fundit në fushën e kërkimit; 4. Ditët e zhvillimit profesional të organizuara me bazë fakulteti ose departamenti, sipas nevojave të identifikuara paraprakisht; <ul style="list-style-type: none"> - Dita e zhvillimit profesional për nismat e fakultetit që synojnë të njohin PA me nismat e reja, programe shkëmbimi dhe projekte studimore; - Dita e zhvillimit profesional për mësimdhënien, të nxënit dhe kërkimin, organizuar me bazë departamenti dhe që synojnë t’i japin mundësi PA që të shkëmbejnë përvojën dhe praktikat më të mira; - Dita e zhvillimit profesional për shërbimet digjitale, organizuar me bazë fakulteti dhe përfshin personelin ndihmësakademik me karakter administrativ; 5. Vizita studimore në universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit; 6. Pjesëmarrje individuale ose në grup, në rrjete dhe shoqata profesionale. <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se UT/FSHS motivon dhe mbështet trajnimin e stafit në universitete perëndimore në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit që UT ka me universitete ndërkombëtare dhe projekte, të tilla si: Erasmus+ KA1, etj. Stafi akademik vlerësoi si një përvojë të dobishme trajnimin e organizuar institucionalisht për përdorimin e platformës Microsoft Teams për mësimdhënien online. Gjithashtu, ata veçuan si të rëndësishme për rritjen e tyre profesionale edhe trajnimet me profesorë të huaj në kuadër të shkëmbimit të experiencave.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë</p>	<p>Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik dëshmon se është përgjegjës për zbatimin e programit të studimeve dhe angazhohet për përmirësimin e mësimdhënies dhe</p>

<p>përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>implementimin e metodave të reja. Këto detyrime rrjedhin edhe nga marrëdhëniet e punës që ka stafi akademik me UT/FSHS, të përcaktuara qartë në dispozitat ligjore të AL, Kodin e Punës, Statutin e UT, Kodin Etik dhe rregulloret e tjera të veçanta.</p> <p>Referuar CV të stafit që mbulon programin e studimit, konstatohet një përpjekje dhe angazhim i vazhdueshëm i personelit akademik dhe ndihmësakademik, për të marrë pjesë në konferenca kombëtare ose ndërkombëtare, programe trajnimi/kualifikimi, programe shkëmbimi, projekte kërkimi, etj, që synojnë rritjen e ekspertizës së tyre mësimdhënëse dhe kërkimore në fushën/profilin përkatës. (Dokumenti 150/4.16 për CVtë Personelit Akademik Bch në Psikologji, e-ASCAL).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik shpjegoi se çdo pedagog është përgjegjës për rritjen e tij profesionale, rishikimin e programeve lëndore, përditësimin e literaturës, përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies, ekperimentimin me metoda të reja, cilësinë e kërkimit shkencor, etj.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Në dokumentin “Kodi i etikës së UT” (2011), Neni 6 “Përhapja e dijeve dhe liria akademike”, në pikën 1, përcaktohet se “Personeli akademik gëzon liri akademik në kërkimet, në punimet shkencore dhe metodologjinë e mësimdhënies. ... Ata duhet të realizojnë me performance të lartë kërkimin, mësimdhënien dhe praktikën, nëpërmjet leximit, studimit, eksperimentit, vëzhgimit, shkëmbimit dhe vetëvlerësimit objektiv duke zgjedhur metoda dhe mënyra efikase, të dobishme, të kuptueshme dhe frytdhënëse për studentët” (fq. 4). (Materiali 156/ 1.5 Kodi i Etikës UT (2011), e-ASCAL).</p> <p>Në dokumentin “Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT-së (2021), Aneksi nr. 1, është paraqitur “Formulari i planifikimit të objektivave të performancës, sipas veprimtarive për personelin akademik/drejtues” që materializon procesin e vetëraportimit nga ana e personelit akademik. Objektivat e performancës përfshijnë edhe elemente të procesit mësimor. Mbi bazën e objektivave të parashikuara, personeli angazhohet për realizimin e tyre në kohë dhe me cilësi. Në fund të vitit akademik, secili pedagog plotëson pasqyrën e realizimit të objektivave të parashikuara, të cilat duhet të jenë të dokumentuara në dosje të veçantë pranë njësisë bazë. Kjo tabelë analizohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe grupi i vlerësimit/përgjegjës i lëndës, të cilën e gjejnë atë korrekte ose jo, dhe firmosin nëse është e saktë” (fq.19) (Dokumenti 14/1.13</p>

	<p><i>Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së (2021).</i></p> <p>Kjo praktikë pune synon nxitjen e kërkesave personale të stafit akademik dhe ndihmësakademik në drejtim të planifikimit/parashikimit të rritjes profesionale dhe të vetëraportimit të rezultateve të arritura në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë të të nxënimit përmes një ndërveprimit të vazhdueshëm me studentët dhe nevojat e tregut të punës. Stafi akademik aplikon metoda bashkëkohore në mësimdhënie, duke përdorur teknologjinë e informacionit që mundësohet edhe nga institucioni (Platforma Microsoft Teams dhe logjistika mbështetëse). Kjo lehtëson mësimdhënien në lëndë të caktuara dhe sipas specifikave të temave, e bën mësimin më interaktiv dhe interesant për studentët. (Material189/ 2.18 Analiza vjetore e punës e FSHS, e-ASCAL). Nismat për aplikimin e formave dhe metodave të reja të mësimdhënies, bëhen pjesë e diskutimit në nivel departamenti, dokumentohen dhe përfshihen në raportet e analizës vjetore.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Në FSHS, kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p> <p>Rregullore e programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018) është një dokument i posaçëm i hartuar nga FSHS/DPP, që në kreun III, “<i>Vlerësimi i studentit</i>”, përcakton kriteret dhe mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive të studentëve (<i>Dokumenti 110/3.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor ne psikologji 2018</i>).</p> <p>Rregullore e Diplomimit në FSHE, është një dokument i posaçëm që përshkruan procedurat provimit final të diplomës</p>

	<p>për programet Bachelor dhe Master Profesional. (Dokumenti 181/ 2.11 Rregullore e diplomimit, e-ASCAL).</p> <p>Për studentët të cilët zgjedhin sipas kriterëve përkatëse të mbrojnë temë diplome, DPP vendos në dispozicion të tyre “Paketën e provës finale për mbrojtjen e diplomës Bachelor në Psikologji” (2018) që përbën një dokument rregullator të posaçëm i cili përmban udhëzime për procedurat e përgatitjes së punimit, udhëzime për strukturën dhe metodologjinë e kërkimit; specifikimet teknike për punimin, udhëzime për monitorimin e përgatitjes së punimit; udhëzime për prezantimin dhe vlerësimin e punimit të diplomës’ përmban përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në realizimin e kësaj veprimtarie dhe rregullat etikës së kërkimit. (Dokumenti 138/4.5 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit, e-ASCAL).</p> <p>Rregullore e praktikës profesionale (2018) është një dokument rregullator që përfshin kriteret, udhëzimet, procedurat e sistemin e vlerësimit të rezultateve të praktikës profesionale për studentët e programit Bachelor në Psikologji. (Dokumenti 137/4.4 Paketa e praktikës për programin e studimit, e-ASCAL).</p> <p>Këto dokumente janë publike dhe të njohura nga të gjithë studentët, stafi akademik dhe ndihmësakademik.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Si pjesë e UT, personeli akademik i FSHS zbaton “Kodin e Etikës” (2021), Nenin 6 “Për përhapjen e dijes dhe lirisë akademike”, pika 4 që përcakton se “Çdo pedagog duhet t’u shpjegojë paraprakisht studentëve objektivat e kursit, duke e realizuar këtë nëpërmjet leksioneve, demonstrimit, praktikës e provimit”. Sipas Rregullores së programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018), Neni 26 “Kritere dhe procedura të vlerësimit”, pika 1, përcakton se “Kriteret dhe format e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor, në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve”. (Dokumenti 110/3.6 Rregullore e programit të studimit, e-ASCAL).</p> <p>Në syllabuset e lëndëve/moduleve që zhvillohen në programin Bachelor në Psikologji, në kategorinë “Forma e kontrollit të dijeve”, është përshkruar metodologjia e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve. Në fillim të çdo lënde, titullari i lëndës informon studentët rreth përmbajtjes së programit lëndor dhe mënyrës së testimit/vlerësimit. (Dokumenti 4.3 Programet mësimore të lëndëve të programit bachelor në Psikologji 2018-2019-2020).</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e</p>	<p>Sipas Rregullores së programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018), Neni 26 “Kritere dhe procedura të</p>

<p>shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>vlerësimit”, pika 2, “Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet: a) me provim me shkrim; me gojë ose i kombinuar duke u specifikuar më parë në programin e lëndës; b) me detyra kursi, projekte, postera; c) i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi” (fq. 11). Programi i studimit përmbyllet me provën finale të diplomimit. (Dokumenti 110/3.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor ne psikologji 2018).</p> <p>Referuar programeve lëndore (syllabuset) të cilat zhvillohen në programin e studimit Bachelor në Psikologji, kategorisë “Forma e kontrollit të dijeve”, vërehet se i gjithë procesi përfshin kontrollin e vazhdueshëm të njohurive, kontrollin e ndërmjetëm dhe kontrollin përfundimtar, ku studenti vlerësohet sipas këtyre komponentëve: frekuentimi i lëndës dhe pjesëmarrja aktive, detyra e kursit, testi i pjesshëm dhe provimi përfundimtar. (Materiali 4.3 - Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, e-ASCAL).</p> <p>Diversiteti i formave dhe mënyrave të vlerësimit, i japin mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="549 916 740 1016">Niveli i përmbushjes</th> <th data-bbox="740 916 951 1016">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="951 916 1158 1016">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1158 916 1361 1016">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="549 1016 740 1077"></td> <td data-bbox="740 1016 951 1077"></td> <td data-bbox="951 1016 1158 1077"></td> <td data-bbox="1158 1016 1361 1077" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi III.6</p>	
<p>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Vlerësimi i studentit në një lëndë të caktuar realizohet gjatë gjithë semestrit/vitit akademik dhe ka qëllim të nxisë studentin që të mësojë gjatë gjithë semestrit/vitit, të ndihmojë hap pas hapi studentin që të përmirësohet dhe të sigurohet një vlerësim përfundimtar sa më objektiv. Në syllabusin e çdo lënde që zhvillohet në programin Bachelor në Psikologji, në kategorinë “Forma e kontrollit të dijeve”, është përcaktuar qartazi se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive të studentit përfshin forma dhe mënyra të ndryshme, me raporte të caktuara, që realizohen gjatë gjithë vitit si: kontrolli i vazhdueshëm (paraqitja e punimit studimor, frekuentimi dhe aktivizimi), kontrolli i ndërmjetëm (testimi në mes të semestrit) dhe provimi përfundimtar (me shkrim/gojë ose i kombinuar). Rezultati</p>

	<p>përfundimtar reflekton vlerësimet e realizuara gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të lëndës, duke u bazuar në një sistem pikëzimi i cili bëhet në mënyrë individuale nga secili pedagog, në varësi të natyrës që ka lënda, dhe duke respektuar një rreze të paracaktuar pikëzimi, sipas të cilës provimi final përlllogaritet nga 40% – 50% të vlerësimit total. Rezultati përfundimtar konvertohet në notë. (4.3. Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, e-ASCAL).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Testimi përmes sistemit elektronik “Microsoft Teams” është aplikuar vetëm në kushtet e pandemisë globale. Stafi akademik dhe studentët pohojnë se aktualisht sistemi përdoret për të marrë përgjigjet e vlerësimeve në një lëndë të caktuar, por jo për testim. Sipas Rregullores së programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018), Neni 29 “Komunikimi i vlerësimeve”, shprehet se “Vlerësimet për lëndë të veçanta komunikohen nga sekretaria e shkollës ose nga sistemi elektronik i fakultetit” (fq. 13) (Dokumenti 110/3.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor ne psikologji 2018). Kjo mënyrë e komunikimit të vlerësimeve ndihmon në eliminimin e abuzimit me vlerësimet.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në Rregulloren e FSHS (2018), Neni 34 “Mënyra e zhvillimit të provimit”, pika 2 përcakton se “Studentët merren në provim nga një komision i përbërë nga dy pedagogë të lëndës, nga të cilët njëri duhet të jetë i brendshëm” (fq. 10) (Dokumenti 174/ 2.4 Rregullore e FSHS, e-ASCAL). Sipas Rregullores së programit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018), Neni 28 “Zhvillimi i provimeve”, pika 3 shprehet se “Komisioni i vlerësimit si rregull përbëhet nga dy pedagogë, ndërsa kur lëndën e zhvillojnë me shumë se dy pedagogë, të gjithë ata janë anëtarë të komisionit të vlerësimit” (fq. 12). (Dokumenti 110/3.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor ne psikologji 2018).</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Në Rregulloren e FSHS (2018), Neni 34 “Mënyra e zhvillimit të provimit”, pika 4, përcaktohet se “Provimet me shkrim bëhen në fletë të sekretuara”(fq. 10), dhe Neni 35 “Procedurat e verifikimit dhe sekretimit”, gërma “c” përcakton se “Vendosja e studentëve në sallë bëhet mbi bazën e listës emëroretë kandidatëve të renditur sipas rendit alafabetik dhe në mënyrë progressive”. Pika 2 e Nenit 35 specifikon se “Për provimet që zhvillohen me shkrim: provime të lëndës dhe provime të diplomës ndiqet e njëjta procedure sekretimi. (a) Sekretimi bëhet nëpërmjet sekretimit të thjeshtë ose me sistemin Bar Code, sipas modelit të përcaktuar nga FSHS (fq.11). (Dokumenti 174/ 2.4 Rregullore e FSHS, e-ASCAL).</p>

	<p>Nga takimi në institucion me personelin akademik dhe ndihmësakademik, GVJ mësoi se “Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi. Në sallën e provimit nuk lejohen të hyjnë persona të tjerë, përveç anëtarëve të komisionit të provimit /pedagogëve të lëndës, monitoruesve të ngarkuar nga drejtuesi i departamentit. Tezat janë të sekretuara dhe provimi realizohet duke ruajtur anonimatin e çdo studenti. Pasi korigjohen testet e provimit, dorëzohen në Sekretarinë Mësimore (SN) e cila bën çsekretimin e tyre dhe nxjerr rezultatin për çdo student. Komisioni i ngritur dhe i miratuar nga përgjegjësi i departamentit monitoron procesin e çsekretimit nga SM. Ky proces asnjëherë nuk kryhet në mënyrë individuale, por në praninë e të dy pedagogëve të lëndëve”.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga takimi në institucion me personelin akademik dhe ndihmësakademik, GVJ mësoi se “Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale mund të shoqërohet me komente nga pedagogu përkatës (nëse është e nevojshme), për të sqaruar studentin dhe ndihmuar atë që të përmirësohet në të ardhmen. Kjo procedurë realizohet në kuadër të konsultave të cilat janë të detyruara për pedagogun dhe realizohen menjëherë pas përfundimit të procesit të vlerësimit dhe shpalljes së rezultateve. Gjithashtu, pedagogu i lëndës, pas provimit dorëzon në departament tezën origjinale dhe çelësin e zgjidhjes së tezës, të cilat mund t’i vihen në dispozicion studentit, nëse dëshiron të qartësohet për përgjigjet dhe vlerësimin e marrë.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik në FSHS/DPP janë shprehur në dokumentin “Paketa e proves finale për mbrojtjen e temës së diplomës Bachelor në Psikologji” (2018), për evitimin e plagjiaturës dhe kopjimit. Në kapitullin “Kërkesa etike”, dokumenti thekson se “Në aspektin e etikës profesionale, studentët duhet të respektojnë sa më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Punimi duhet të jetë original; - Kërkohet që të shënohet referenca përkatëse, nëse përdoren ide të tjerëve; - Në rastet kur pandershmëria akademike ka ndodhur, kjo i bëhet e ditur përgjegjësit të departamentit për veprime të mëtejshme; (Materiali 138/4.5 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit, e-ASCAL) <p>Në Rregulloren e FSHS (2018), Neni 59 “Kuptimii shkeljeve disiplinore”, specifikohet se “Shkelje të rregullave konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që</p>

	<p><i>cënojnë personalitetin e të tjerëve, rregullat dhe normat etiko-morale të shoqërisë si: kopjimi në provime, falsifikimi i dokumenteve të ndryshme ...” (Materiali 174/ 2.4 Rregullore e FSHS, e-ASCAL).</i></p> <p>Gjatë vizitës në institucion, nga takimi me personelin akademik dhe ndihmësakademik, GVJ mësoi se “Plagjiatura apo kopjimi në provime mund të shmanget në FSHS sepse stafi respekton dhe zbaton me korrektesë rregullat lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kushtet e sekretimit të tezës së provimit nga sekretaria mësimore; - monitorimin e procesit të provimit nga komisioni i përbërë nga dy pedagogë të lëndës; - moslejimin e përdorimit të së njëjtës tezë provimi me grupe që zhvillojnë provim në orare të ndryshme; - mospërsëritjen e së njëjtës tezë brenda të njëjtit vit akademik (përfshirë edhe sezonin e riprovimit), etj; <p>Për sa i përket shmangjes së plagjiaturës dhe kopjimit në detyrat lëndore të punuara individualisht ose në grup nga studentët, stafi akademik shprehet se ata bashkëpunojnë ngushtësisht me studentët nga fillimi deri në përfundim të detyrës, monitorojnë, mbështesin dhe vlerësojnë hap pas hapi punën e tyre me qëllim përmirësimi. Gjatë këtij procesi ekziston mundësia për të parandaluar ose evidentur në kohë rastet e këtij fenomeni.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>FSHS/DPP bazohet në rregulloret përkatëse për të siguruar që rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve të bazohen në meritë dhe të jepen në kohën e përcaktuar. Në Rregulloren e ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018), Neni 26 “<i>Kritere dhe procedura të vlerësimit</i>”, pika 4, përcakton se “<i>Nota vendoset në bazë të pikëve</i>”, Pika 5 shprehet se “<i>Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem prej dhjetë notash</i>”, dhe pika 6 specifikon se “<i>Vlerësimi do të kryhet sipas një sistemi të detajuar pikëzimi</i>”. (Dokumenti 110/3.6 Rregullore e programit të studimit. e-ASCAL).</p> <p>Në programin lëndor (syllabusin), në seksionin “<i>Forma e kontrollit të dijeve</i>”, është përfshirë një tabelë e detajuar pikëzimi për vlerësimin e studentëve, të ndarë në kategori: shkalla e pikëve, nota numerike, përshkrimi i notës, nota me shkronja sipas ECTS. Zbatimi i një sistemi të detajuar pikëzimi tregon se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të bazuara në meritë. Gjatë vizitës në institucion, personeli akademik dhe ndihmësakademik shpjegoi</p>

	<p>se rezultatet e provimeve jepen në kohë sipas përcaktimeve në “Rregulloren e FSHS (2018), Neni 36 “Për sistemin e vlerësimit”, pika 3,që shprehet se “Rezultatet e provimit u bëhen të qarta studentëve nga komisioni në përfundim të provimit me gojë dhe për provimet me shkrim brenda 15 ditëve nga data e zhvillimit të provimit. Rezultatet komunikohen individualisht”. (Materiali 174/ 2.4 Rregullore e FSHS, e-ASCAL).</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>UT/FSHS garanton bazuar në dokumentet e saj rregullatore, të drejtën e studentëve për t’u njohur me vlerësimin dhe për të kërkuar rishikim/përmirësim të vlerësimit përkatës.</p> <p>Rregullorja e UT (2015), Neni 49 shprehet se “Rezultatet e provimit u bëhen të njohur studentëve nga komisioni në përfundim të provimit me gojë dhe për provimet me shkrim brenda 15 ditëve nga data e zhvillimit të provimit. *Në këtë rast rezultatet e provimit afishohen për çdo grup (!). Ndërsa, Neni 54 “Rishikimi i notës” shprehet se “Studenti ka të drejtën e rishikimit të notës në çdo vit akademik deri në tre lëndë nga detyrimet e atij viti. Për rishikim note, studenti provohet vetëm njëherë dhe vetëm në sezonin e riprovimeve duke mbetur në fuqi nota me të cilën studenti vlerësohet në fund. Kërkesa për rishikim note i paraqitet dekanatit/ drejtorisë para sezonit të riprovimeve. Studenti i vitit të fundit ka të drejtë të rishikojë deri në 4 lëndë përfshirë këtu edhe lëndë nga vitet paraardhëse” (fq.30-31).</p> <p>Në Rregulloren e FSHS (2018), Neni 36 “Sistemi i vlerësimit”, pika 3, përcaktohet se “Rezultatet e provimit u bëhen të qarta studentëve nga komisioni në përfundim të provimit me gojë dhe për provimet me shkrim brenda 15 ditëve nga data e zhvillimit të provimit. *Rezultatet komunikohen individualisht”. Në Nenin 40 “Përmirësimi i notës”, përcaktohet se “Studenti ka të drejtën e përmirësimit të notës nëpërmjet rihyrjes në provim në çdo vit akademik, deri në tre lëndë nga detyrimet e atij viti. Për përmirësimin e notës studenti provohet vetëm njëherë dhe vetëm në sezonin e riprovimeve duke mbetur në fuqi nota me të cilën studenti vlerësohet në fund. Studenti i vitit të fundit ka të drejtë të rishikojë deri në 4 lëndë përfshi këtu edhe lëndë nga vitet paraardhëse”(Dokumentimi 174/2.4 Rregullore e FSHS, e-ASCAL).</p> <p>Në rast se një notë është raportuar gabim, institucioni respekton përcaktimet e Rregullores së ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018), Nenin 30 “Dokumentimi i vlerësimeve”, Pikën 4 që shprehet se “Një notë e raportuar mund të ndryshojë vetëm nëse rezulton se është bërë një gabim gjatë regjistrimit. Pedagogu duhet të dorëzojë një vërtetim me shkrim ku pranohet</p>

	<p><i>gabimi. Vërtetimi miratohet nga Dekani i FSHS. Ndryshimi pranohet brenda një periudhe kohore prej 24 orësh nga data e dhënies së vlerësimit. Kur shfaqen paqartësitë lidhje me ndonjë gabim të mundshëm të një note të paraqitur nga një pedagog i cili nuk është më pjestar i trupës mësimore, Dekani i FSHS ngre një komision të posaçëm për të zgjidhur problemin dhe autorizon ndryshimin e mundshëm”. (Dokumenti 110/3.6 Rregullore e programit të studimit, e-ASCAL).</i></p> <p><i>GVJ rekomandon të rakordohen / harmonizohen përcaktimet në dokumentet rregullatore në nivel universiteti, fakulteti, departamenti dhe programe studimi lidhur me mënyrën e komunikimit të rezultateve të provimit.</i></p> <p><i>(Rregullore e UT (2015), Neni 49, shprehet: Rezultatet e provimit afishohen për çdo grup; Rregullore e FSHS (2018), Neni 36 shprehet: Rezultatet komunikohen individualisht).</i></p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Çdo kërkesë, ankimim i studentit, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm sipas përcaktimeve në “Rregulloren e FSHS (2018), Neni 37 “Ankimimi”, Pika 4 ku thuhet se “Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa paraqitet me shkrim te përgjegjësi i departamentit ose sekretaria e departamentit, brenda 48 orësh nga marrja dijani e rezultatit të provimit. Përgjegjësi i departamentit pasi bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni dekanin”. Sipas pikes 5 të Nenit 37 të Rregullores “Dekani brenda 48 orësh nga marrja dijani për ankesën nga përgjegjësi i departamentit, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit”. (Materiali 174/ 2.4 Rregullore e FSHS, e-ASCAL).</p> <p>Gjatëvizitës në institucion, GVJ u informua nga studentët se institucioni trajton me seriozitet kërkesat dhe rastet e ankimimit te tyre lidhur me rezultatin e vlerësimit apo çështje të tjera që shqetësojnë studentët. Staf i akademik tregoi gjithashtu, se institucioni zbaton përcaktimet sipas Rregulloreve përkatëse lidhur me kërkesat apo ankimimet e studentëve. Autoritetet drejtuese të FSHS/DPP dëshmuuan se çdo kërkesë, ankimimi, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>


Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Për studentët, fitimi i një diplome Bachelor në Psikologji përbën hapin e parë për të filluar një karrierë shpërblyese për të ardhmen në këtë fushë. Ndërkohë që tregu i punësimit (Urdhri i Psikologut) kërkon një diplomë Master për të ushtruar role të ndryshme të profesionit të psikologut, diploma Bachelor në Psikologji është dizenuar për të përgatitur studentët për arsimim të mëtejshëm.</p> <p>Programi i studimit “Bachelor në Psikologji” i prezanton studentët me mundësi për të eksploruar dhe thelluar njohuritë nga disiplina të ndryshme të fushës së psikologjisë.</p> <p>Sipas dokumentit “Korniza konceptuale të programit të studimit Bachelor në Psikologji”, Pika 3 programi i studimit ofron “njohuritë bazë në fushat që lidhen drejtpërsëdrejti me shkencën e psikologjisë, si dhe të njohurive mbi degët më të aplikuara aktualisht të psikologjisë në botë e në vendin tonë. Gjithashtu, programi e pajis studentin me aftësitë kryesore të një psikologu të përgjithshëm” (fq.4). Në vijim të këtij dokumenti, Pika 7 “Për njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin”, specifikohet se “Dijet dhe njohuritë e përvetësuara në këtë program studimit janë të orientuara drejt përvetësimit të koncepteve bazë psikologjike, teorive klasike dhe analizave kryesisht makro e mikropsikologjike bazuar mbi paradigmen e zhvillimeve psikosociale të qënies njerëzore në disa drejtime si ai biologjik, konjitiv, psikosocial, mikrosistemet dhe makrosistemet. Lidhja e ngushtë e dijeve psikologjike me kontekstin bashkëkohor, teoritë dhe paradigmat e sipërpërmendura orientojnë zhvillimin e kompetencave për hulumtimin e dinamikave psikologjikenë një premisë kryesisht shumë holistike. Ky program studimi orienton studentët edhe drejt praktikave kërkimore, për të rritur aftësitë përshtatëse me tregun e punës ku researcher-i</p>

	<p><i>psikosocial (psikologu) po bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm” (fq. 9).</i></p> <p>Programi realizohet nga një staf akademik i kualifikuar me grada dhe tituj akademik, si dhe me përvojë në fushën e kërkimit dhe praktikave të shërbimit psikologjik (<i>Materiali 4.16.CV e personelit akademik te brendshem për programin e studimit, e-ASCAL).</i></p> <p>Programi siguron lidhjen e teorisë me praktikën duke ballafaquar dhe familjarizuar studentët me sfidat dhe kërkesat e tregut të punës. Programi zhvillohet në mjedise me një infrastrukture të përshtatëshme, të pajisur me teknologji që mbështesin mësimdhënien bashkëkohore, mbështetur me internet dhe wireless, me biblioteke të pasur me libra fizik dhe burime online. Nga kjo pikëpamje, përmbajtja e programit të studimit të marrë në vlerësim, dhe mënyra se si ky program zhvillohet/ofrohet nga FSHS/DPP, garanton thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Institucioni dëshmon se angazhohet dhe krijon kushte në mbështetje të programit të studimit me qëllim që studentët të zhvillojnë aftësi të veçanta praktike në fushën e teknologjisë së informacionit, përmes trajnimit të studentëve për të përdorur sistemin “Microsoft Teams” për qëllime mësimore.</p> <p>Programi i studimit nuk ka një lëndë/modul të dedikuar zhvillimit të aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Por, programi mundëson studentët të përdorin teknologjinë bashkëkohore dhe të zhvillojnë aftësitë për të komunikuar e ndërvepruar në funksion të arritjes së objektivave mësimorë teoriko- praktikë dhe studimor. Programi përfshin “Gjuhën e huaj e specialitetit” e cila zhvillohet si lëndë me zgjedhje dhe jo e detyruar për të gjithë studentët. (<i>Materiali 133/4.2 Plani mësimor i programit të studimit, e-ASCAL).</i></p> <p><i>Megjithatë, GVJ sugjeron të rishikohet përmbajtja lëndore e planit mësimor të programit Bachelor në Psikologji me qëllim përmbushjen në mënyrë të plotë të kriterit 2 të standardit III/7.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>DPP, njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit, realizon në mënyrë periodike analizën e punës. Në fund të semestrit, DPP kërkon nga pedagogu i çdo lënde apo moduli të raportojë në lidhje me arritjen e objektivave të lëndës, si dhe të paraqesë rekomandimet për përmirësim në të ardhmen. Të dhënat e grumbulluara dhe rekomandimet e mundshme përfshihen në raportin e analizës vjetore të DPP.</p>

	<p><i>(Materiali 188/2.18 Analizë vjetore e punës së FSHS 2019-2020, 2020-2021, e-ASCAL).</i></p> <p>Kjo praktikë vlerësohet nga GVJ si një tregues pozitiv i angazhimit institucional për të inkurajuar personelin akademik të analizojë, shqyrtojë dhe reflektojë mbi objektivat përkatëse, të rishikojë në mënyrë të vazhdueshme përmbajtjen lëndore dhe metodologjinë e mësimdhënies, si dhe të hartojë programe lëndore që thelbësisht synojnë zhvillimin e kompetencave dhe aftësitë e studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik në institucion, GVJ mësoi se pedagogu i çdo lëndë në fund të semestrit para provimit përfundimtar realizon seancë konsultimi me studentët për çështjet kryesore të trajtuara gjatë lëndës/modulit dhe orienton studentin për provimin përfundimtar. Gjithashtu, në përfundim të lëndës studentët prezantojnë edhe detyrat e kursit (individuale/ në grup) të cilat trajtojnë çështje teoriko-praktike të rëndësishme dhe orientojnë studentët drejt diskutimit për të gjetur mundësi për implementimin e tyre.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar dokumentit “Raporti vjetor për punët e kryera” (2019-2020, 2020-2021), vërehet se stafi akademik ka përfituar dhe është angazhuar në ngjarje të ndryshme shkencore, të cilat janë realizuar në UT/FSHS përgjatë vitit akademik, të tilla si: konferenca, simpoziume, workshope, seminare shkencore, leksione të hapura me të ftuar dhe personalitete të larta të vendit dhe të huaj, tavolina të rrubullakëta, veprimtari promovuese, etj. <i>(Materiali 188/2.18-1/2 Analizë vjetore e punës së FSHS 2019-2020-2021, e-ASCAL).</i></p> <p>Një pjesë e veprimtarive të organizuara jashtë programit të studimit Bachelor në Psikologji, kanë bërë bashkë studentët dhe pedagogët e tyre. Shëmbull është tryeza e rrubullakët mbi organizimin orëve të hapura me lektor të ftuar në platformën elektronike “Microsoft Teams” për mësimin në distancë që iu përgjigjej jo vetëm nevojave imendiate të insitucionit në kushtet e pandemisë globale, por edhe nevojave në vazhdimësi për të përdorur teknologjinë e informacionit në funksion të qëllimeve të procesit të mësimdhënies e mësimnxënies. <i>(Materiali 188/2.18-1/2 Analizë vjetore e punës së FSHS 2019-2020-2021, e-ASCAL).</i></p> <p>FSHS/DPP disponon të dhëna të detajuara për tematikat e trajtuara me studentët në kuadër të veprimtarive ekstrakurrikulare, me qëllim formimin profesional të tyre dhe për afrimin me zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë. Këto veprimtari organizohen jashtë strukturës së programit të</p>

<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>studimit me ekspertë të fushës së psikologjisë apo lektorë të ftuar nga institucione homologe. (Materiali 7/3. Dokument që vërteton trajnimin profesional të studentëve, e-ASCAL).</p> <p>Stafi akademik që mbulon programin e studimit Bachelor në Psikologji, është i kualifikuar dhe i prirur për të realizuar një mësimdhënie mbi bazë kompetencash duke u dhënë mundësi studentëve të zhvillojnë dhe aplikojnë njohuritë e marra në praktikat e tyre profesionale. Kjo prirje gjen pasqyrim në hartimin e programeve lëndore dhe shprehet në mënyrë të veçantë në formulimin e rezultateve të pritëshme të të nxënit që parashikohen të arrijnë studentët në përfundim të programit lëndor. Gjenden shëmbuj të mirë të formulimit të rezultateve të pritshme të të nxënit, ku përdoren folje të matëshme, të tilla si: Në përfundim të programit lëndor, studenti do të jetë në gjendje - të identifikojë, të dallojë, të krahasojë, të diskutojë, të demonstrojë, të përdorë, të shkruajë, të hartojë, të interpretojë, të realizojë, të planifikojë, të analizojë, të argumentojë, të vlerësojë, të aplikojë, etj, duke vënë theksin tek demonstrimi / përdorimi / aplikimi i aftësive dhe kompetencave në situata praktike. Por, ndeshen edhe raste të programeve lëndore që përdorin formulime të përgjithëshme, të tilla si: të njohë, të kuptojë, të dijë, të zotërojë, etj, të cilat duket se orientojnë më tepër studentët te përfitimi i njohurive, sesa demonstrimi i aftësive dhe kompetencave në situata praktike (Materiali 134/4.3, Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit; e-ASCAL).</p> <p><i>Në këtë aspekt, sugjerohet të rishikohet formulimi i rezultateve të pritëshme të të nxënit duke specifikuar aftësitë dhe kompetencat që duhet të demonstrojnë / përdorin/ aplikojnë studentët në situata praktike në përfundim të programit lëndor.</i></p> <p>Lidhur me aspektin metodologjik të mësimdhënies, studentët dhe pedagogët shpjeguan gjatë vizitës në institucion se leksionet, seminarët dhe veprimtaritë e tjera mësimore, realizohen mbi bazë kompetencash, duke ju dhënë mundësi studentëve që të zhvillojnë njohuritë dhe shprehjet e nevojshme profesionale në situata praktike. Stafi akademik dhe studentët treguan se në shumicën e lëndëve mësimore, veçanërisht të lëndëve karakterizuese, mësimdhënia realizohet duke përdorur metoda interaktive, si: lojë me role, punë në grupe, analiza, reflektim dhe diskutim mbi raste klinike/raste studimore, etj.</p>
--	--




<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara. Në programet lëndore/syllabuset, në kategorinë “Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit”, vërehet se shumica e titullarëve të lëndëve kanë projektuar mësimdhënien e tyre dhe të nxënit e studentëve të bazuar në diskutimet, studimet e rastit, punën në grup dhe nxitjen e mendimit kritik dhe kreativ në përvetësimin e dijeve, interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara të lidhura me lëndën. (Materiali 134/4.3. Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, e-ASCAL).</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Si pjesë e UT, personeli akademik i FSHS zbaton “Kodin e Etikës” (2021), Nenin 6 “Për përhapjen e dijeve dhe lirisë akademike”, Pika 2 që përcakton se “Çdo pedagog duhet të njohë dhe respektojë kontributet shkencore të kolegëve dhe studentëve” dhe Pika 3 që shprehet se “Pedagogët duhet të përmirësojnë vazhdimisht metodologjinë në mënyrë që të kenë efektivitet në mësimdhënie, të inkurajojnë studentët për të vepruar në mënyrë të lirë dhe të pavarur, si dhe t’u shpjegojnë atyre metodat e vlerësimit”.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve, jo vetëm përmes inkurajimit të diskutimit të lirë në auditor dhe veprimtari zhvilluese jashtë programit të studimit, por edhe nëpërmjet mbështetjes me literature dhe udhëzime për realizimin edetyrave me natyrë studimore të cilat punohen individualisht ose në grup.</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative dhe nismat studentore. FSHS inkurajon përfshirjen e studentëve në projekte studimore apo botime të artikujve dhe punëve shkencore në bashkëpunim me pedagogët e tyre. GVJ evidentoi se institucioni mbështet bashkëpunimin me studentën në kuadër të konferencave dhe ngjarjeve të tjera shkencore në nivel kombëtar/ndërkombëtar, organizuara nga FSHS, duke mirëpritur pjesëmarrjen dhe prezantimet e ideve të tyre në bashkëpunim me pedagogët. Pjesëmarrja e studentëve të fakultetit në këto aktivitete realizohet pa asnjë pagesë nga ana e tyre. Megjithatë, UT/FSHS/DPP ka të gjitha mundësitë dhe kapacitetet akademike për të qënë avangardë me praktikat bashkëkohore në universitetet e vendeve të zhvilluara, të cilat krahas përfshirjes së studentëve në ngjarjet shkencore dhe</p>

	projektet kërkimore të financuara nga institucioni ose më gjërë, e kanë kthyer në traditë akademike mbështetjen dhe organizimin e Konferencave të Studentëve. Do të ishte një shëmbull inkurajues për çdo institucion tjetër të arsimit të lartë në Shqipëri që FSHS/DPP të mbështeste financiarisht organizimin e Konferencës së Studentëve të Psikologjisë (në nivel kombëtar/ndërkombëtar).			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. Sipas tabelës përmbledhëse me të dhëna për mobilitetin e studentëve dhe pedagogëve të FSHS/DPP në kuadër të programit ERASMUS+, mësohet se gjatë 5 viteve të fundit kanë përfituar 19 pedagogë nga programet e mobilitetit dhe 31 studentë. <i>(Material 75/3.20 Të dhëna për mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve 2016-2022, e-ASCAL).</i> Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se FSHS është pjesë e projektit Erasmus+ KA107 që mundëson mobilitetin e stafit dhe studentëve të UT-së. Thirrjet për aplikim të stafit dhe studentëve në programe shkëmbimi publikohen herë pas here në faqen zyrtare të UT https://unitir.edu.al/ dhe FSHS https://fshs-ut.edu.al/ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	FSHS ka hartuar procedura të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. Paketa e provës finale për mbrojtjen e diplomës Bachelor në Psikologji (2018) është një dokument rregullator i posaçëm që orienton studentët për procedurën e propozimit, punimit dhe prezantimit të punimit të diplomës <i>(Dokumenti 138/4.5 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit, e-ASCAL).</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli	FSHS/DPP, përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, dhe personeli akademik që mbulon këtë




akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.

program, asistojnë studentët tyre, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. FSHS ka publikuar Rregulloren e Diplomimit në FSHE që përshkruan procedurat e provimit të final të diplomit. (Dokumenti 181/ 2.11 Rregullore e diplomimit, e-ASCAL).

Për studentët të cilët zgjedhin sipas kriterëve përkatëse të mbrojnë temë diplome, DPP vendos në dispozicion të tyre "Paketën e provës finale për mbrojtjen e diplomës Bachelor në Psikologji" (2018), që përbën një dokument rregullator të posaçëm i cili përmban udhëzime për procedurat e përgatitjes së punimit; udhëzime për strukturën dhe metodologjinë e kërkimit; specifikimet teknike për punimin, udhëzime për monitorimin e përgatitjes së punimit; udhëzime për prezantimin dhe vlerësimin e punimit të diplomës përmban përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në realizimin ekësaj veprimtarie dhe rregullat etikës së kërkimit. (Dokumenti 138/4.5 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit, e-ASCAL).

FSHS/DPP ka caktuar një Koordinator të programit të studimit i cili është përgjegjës për të monitoruar ecurinë e ndërveprimit të studentëve me pëdagogët udhëheqës përkatës, si dhe sigurimin që studentët disponojnë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin ndihmues përkatës.

Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.

Për zhvillimin e provimit final të diplomimit, DPP ndjek procedura të parashikuara në Rregulloren e Diplomimit në FSHE, Neni 6 "Procedura të provimit të diplomës" që shprehet se "Për zhvillimin e provimit të diplomës në programet Bachelor dhe Master Profesional, hartohet programi përkatës. Për hartimin e programit të diplomës departamenti ngre një komision ad-hoc. Programi i provimit të formimit përmban pyetje nga lëndë të kategorive A, B, C. Nga kategoria C përjashtohen lëndët me zgjedhje. Diskutimi i programit të provimit të formimit bëhet më pas nga departamenti ose departamentet bashkëpunuese për programin. Programi i miratuar nga departamenti përgjegjës për programin i dërgohet për miratim dekanit të FSHS. Programi i provimit të diplomës u vihet në dispozicion studentëve në muajin dhjetor të vitit akademik përkatës. Provimi i diplomës, si rregull, zhvillohet me shkrim. Paketa e provimit përmban pyetje të tipit objektiv ose të tipit objektiv dhe subjektiv. Ato kompozohen mbi bazën e bankës së pyetjeve të hartuara nga të gjithë pedagogët që zhvillojnë lëndët e përfshira në programin e provimit të formimit. Për provimin e diplomës ngrihet një komision.

	<p><i>Komisioni i provimit të diplomës përbëhet nga 3-5 anëtarë dhe miratohet nga drejtuesi i departamentit dhe zëvendësdekani që mbulon programin.” (Dokumenti 181/ 2.11 Rregullore e diplomimit, e-ASCAL).</i></p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se mbështetur në procedurat e mësipërme, Komisioni i provimit të diplomës administron numrin e pikëve për pyetjet e lëndëve të kategorisë A, B, C, sipas kriterit të peshës që zenë në planin mësimor, si p.sh., për lëndë të kategorisë A (20 pikë), për lëndë të kategorisë B (70 pikë), për grupin e lëndëve të kategorisë C (10 pikë). Në secilën kategori mund të ofrohet numër i ndryshëm pyetjesh nga 5 deri në 10 pyetje. Përgjithësisht respektohet balanca në testimin e njohurive të dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet e kategorisë A, B, C në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit të marrë në vlerësim tregon sesiguron një rol mbështetës dhe orientues në drejtim të përgatitjes së studentëve për provimin e përgjithshëm përfundimtar, duke qenë të hapur të ndihmojnë studentët me konsultime, nëse ata kanë pyetje apo paqartësi në lidhje me lëndët e tyre.</p> <p>Përsa i përket përgatitjes së temës së diplomës, personeli akademik njih dhe zbaton përcaktimet e “Rregullores së Diplomimit në FSHE”, Neni 7 “Për procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës”, si dhe udhëzimet dhe përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në këtë veprimtari, të parashikuara në “Paketën e provës finale për mbrojtjen e diplomës Bachelor në Psikologji” (2018).</p> <p>Bazuar në këto dokumente, përgatitja e punimit të diplomës kryhet sipas një plani të dakordësuar ndërmjet udhëheqësit shkencor dhe studentit. (Dokumenti 181/ 2.11 Rregullore e diplomimit, e-ASCAL). Nga udhëheqësi i temës së diplomës kërkohet të japë mbështetjen e duhur profesionale dhe konsulencën e nevojshme që të mundësojë kandidatin të arrijë standarde të larta të punimit. Gjithashtu, nga udhëheqësi kërkohet që të mbajë takime të rregullta me studentit (një në muaj) për të dhënë këshilla dhe për të qënë në dijeni të ecurisë së punimit, si dhe të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar studentin, në përgatitjen e prezantimit të punimit të tij para komisionit të mbrojtjes (fq.6). (Dokumenti 138/4.5 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit, e-ASCAL).</p>

<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>FSHS/DPP asiston studentët brenda dhe jashtë institucionit për kryerjen e punimeve të tyre studimore. FSHS si pjesë e UT, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike, qendra të shërbimit psiko-sociale, agjensi e biznese private, organizata të ndryshme joqeveritare, të cilat krijojnë mundësi jo vetëm për realizimin e praktikave profesionale, por edhe për realizimin e punimeve studimore nga ana e studentëve. Në këtë kuadër mund të përmendet rasti i bashkëpunimit me IEVP Penale për qëllime studimore (Autorizim për hyrje me Nr. prot.7930 datë 23/07/2021). FSHS/DPP asiston studentët brenda institucionit për kryerjen e punimeve studimore, duke ofruar seanca metodologjike, konsulta me pedagogët udhëheqës, akses në bibliotekat online, sallë leximi dhe kompjuter në bibliotekë, mjedis të mbuluar me WiFi.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit:</p>	<p>Përsa i përket përgatitjes dhe mbrojtjes së temës së diplomës, personeli akademik i cili udhëheq studentin njeh dhe zbaton përcaktimet e “Rregullores së Diplomimit në FSHE”, Neni 7 “Për procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës”, si dhe udhëzimet dhe përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në këtë veprimtari, të parashikuara në “Paketën e provës finale për mbrojtjen e diplomës Bachelor në Psikologji” (2018). (<i>Dokumenti 138/4.5 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit, e-ASCAL</i>).</p> <p>Sipas “Paketës së provës finale për mbrojtjen e diplomës Bachelor në Psikologji” (2018), pedagogut udhëheqës i kërkohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të japë mbështetjen e duhur profesionale dhe konsulencën e nevojshme që të mundësojë kandidatin të arrijë standarde të larta të punimit; - të mbajë takime të rregullta me studentit (një në muaj) për të dhënë këshilla dhe për të qënë në dijeni të ecurisë së punimit; - të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar studentin, për përgatitjen e prezantimit të punimit të tij para komisionit të mbrojtjes; - të bëjë kritikën e duhur për punën e studentit dhe komentet konstruktive brenda kohës së caktuar dhe në kohën e mbrojtjes së punimit të konfirmojë se punimi i plotëson kërkesat dhe standardet e kërkuara për fitimin e diplomës;
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së</p>	<p>Sipas “Rregullores së Diplomimit në FSHE”, Neni 6 “Procedura të provimit të diplomës” që shprehet se “Për provimin e diplomës ngrihet një komision. Vlerësimi i studentit</p>

diplomës, studenti vlerësohet me notë.

bazohet në pikët totale të fituara prej tij për të gjitha pyetjet e paketës së provimit. Pikët konvertohen në note. Notat pasqyrohen në procesverbalin e provimit dhe konfirmohen me firmën e secilit anëtar të Komisionit të provimit. Kryetari i Komisionit të provimit i përcjellë Sekretarës mësimore procesverbalin. Studentët njoftohen individualisht për vlerësimin.


Në Nenin 7 të Rregullores së Diplomimit në FSHS, "Për procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës", pika 10 shprehet se "Mbrojtja e punimit të diplomës është publike dhe kryhet para një komisioni të miratuara nga drejtuesi i departamentit dhe zëvendësdekani që mbulon programin. Komisioni përbëhet nga 3-5 anëtarë. Komisioni funksionon kur janë prezentë 2/3 e anëtarëve të tij. Prezantimi zgjat 10-15 minuta. Komisioni i bën pyetje studentit dhe më pas vlerëson cilësinë e punimit. Vlerësimet kryhen me pike sipas skedës së vlerësimit që përfshihet në Paketën e punimit të diplomës. Pikët konvertohen në note. Nota regjistrohet në procesverbalin e mbrojtjes së diplomave. Procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit. Vlerësimi i komunikohet çdo studentit diplomant individualisht". (Dokumenti 181/2.11 Rregullore e diplomimit, e-ASCAL).

Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Në përfundim të studimeve të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Kjo procedure është e përcaktuar në Rregulloren e FSHS (2018), Neni 42 "Diploma", që shprehet se "FSHS pajis studentët që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi me diplomën përkatëse, e cila është një dokument zyrtar. Diplomat për ciklin e parë dhe të dytë shoqërohen me Suplementin e Diplomës. Suplementi i Diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të arsimit të lartë. Ai përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës. Përmbajtja dhe forma e diplomës është përcaktuar në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Përmbajtja dhe forma e diplomës së Suplementit të Diplomës është përcaktuar në Statutin e UT, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Diploma plotësohet me shkrim të qartë dhe me bojë teknike. Ajo nëshkruhet nga Dekani dhe Rektori i UT. Nënshkrimi i

	<p>Rektorit shoqërohet me vulën e UT". (Dokumenti 174/2.4 Rregullore e FSHS, e-ASCAL).</p> <p>Gjithashtu, procedura është përcaktuar në Rregullore të ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018), Neni 32 "Marrja e diplomës", pika 5 ku përshkruhet se "Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni". (Materiali 110/3.6 Rregullore e programit të studimit, e-ASCAL).</p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, studentit i vihet në dispozicion kopje zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. Gjatë vizitës në institucion GVJ mësoi se "Kopja zyrtare e programit të studimit Bachelor në Psikologji përfshin syllabuset e këtij programi. Ajo vihet në dispozicion të studentëve në varësi të kërkesës së bërë dhe për interesa të studimit. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore harton dhe pajis studentin me Supplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dheanglisht).</p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>UT/FSHS ruan për një periudhë të pacaktuar/pa afat kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. Nga takimi me personelin në Sekretarinë Mësimore, GVJ mësoi se FSHS disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vetë institucionit. Këto të dhëna administrohen në përputhje me Udhëzuesin mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, përhapjes, ruajtjes dhe masave të sigurisë të të dhënave personale. (Dokumenti 10/1.9 Privatësia UT, e-ASCAL).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.

GVJ duke iu referuar dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni dhe atij të marrë gjatë vizitës në FSHS, konkludon se institucioni ka ngritur dhe ka funksionale Zyrën e Burimeve Njerëzore. Kjo zyrë është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit Bachelor në Psikologji. Të dhënat e institucionit për angazhimin e personelit akademik janë dhënë për një periudhë kohore 3-vjeçare, respektivisht për vitet akademike:

Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021		2019-2020	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	2	-	2	-	2	-
Prof. Asoc.	3	-	3	-	3	-
Dr./PhD.	13	6	13	11	13	12
Msc.	-	22	-	14	-	13
Totali	18	28	18	25	18	25

Nga sa më sipër GVJ konstaton se, numri i personelit akademik efektiv dhe me kontratë të angazhuar në këtë program studimi është i njëjtë për periudhën tri vjeçare 2019-2022 dhe në përputhje me profilin e programit të studimit në të cilin kontribuojnë. Në lidhje me dokumentat dhe procedurën që përmban dosja specifike për stafin akademik me kohë të plotë, me kohë të pjesshme dhe administrativ, institucioni vepron në bazë të:



“Manuali për punësimin e personelit në UT”

(Dokumenti 1.2 Statuti i UT, 2018; Dokumenti 1.3 Rregullore e UT, 2016; Dokumenti 1.12 Manuali për punësimin e personelit në UT)

Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit

Institucioni ka një procedurë rekrutimi për personelin akademik e cila bazohet në Statutin e UT, Rregullore e UT, *“Manualin mbi punësimin e personelit në Universitetin e*

<p>akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p><i>Tiranës</i>”. UT ka hartuar një procedure të detajuar për rekrutimin e personelit akademik. Kjo procedurë kalon në 17 hapa që fillon me përcaktimin e kriterëve të veçanta të punësimit duke u bazuar në nevojat aktuale që ka njësia bazë, më pas në kriteret e përgjithshme të punësimit të personelit akademik me kohë të plotë, më pas vazhdon me hapat e tjerat që vijnë me vendimin në nivel departamenti për përcaktimin e kriterëve, rishikimin e këtij vendimi nga Rektori, shpallja në Agjencinë e Prokurimit Publik si dhe në faqen zyrtare të njësisë, krijimin e komisionit ad-hoc, përgatitja e short listave, marrja e vendimit nga komisioni ad-hoc në bazë të kriterëve të përcaktuara nga baza ligjore në fuqi mbi rregullat dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik, etj. Ligjin Nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Ligji për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, Ligji Nr.9887 dt.10.03.2008 ndryshuar me ligjin Nr.48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” etj. (Dokumenti 1.12 Manuali për punësimin e personelit në UT)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriterëve të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Procedurat e përcaktuara nga institucioni në lidhje me afatet, kriteret e përgjithshme dhe specifike për tu bërë pjesë e stafit akademik, janë konform Statutit të Universitetit të Tiranës, Rregullores së Përgjithshme të UT-së, Manualit për punësimin e personelit në UT dhe në linjë me udhëzimet dhe legjislacionin për arsimin e lartë në vend. Kriteret shpallen publikisht në faqen online të FSHS dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Institucioni në fillim të vitit akademik publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik. Kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për pedagogë përcaktohen nga departamenti konform ligjit për arsimin e lartë dhe udhëzimeve të tjera në fuqi. Kriteret e rekrutimit të personelit akademik publikohen në faqen zyrtare web https://fshs-ut.edu.al, pas identifikimit të nevojave. (Dokumenti 1.2 Statuti i UT, 2018; Dokumenti 1.3 Rregullore e UT, 2016; Dokumenti 1.12 Manuali për punësimin e personelit në UT)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret e përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në</p>	<p>Institucioni ndjek procedura rekrutimi korrekte të shpalljeve publike në Agjencinë e Prokurimit Publik, si dhe përmes mjeteve të komunikimit që institucioni ka në dispozicion si faqja e universitetit dhe rrjetet sociale, sipas të gjitha kriterëve. Vlerësimi bëhet mbështetur në thirrjen ku përfshihen kriteret e përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen</p>

përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	e programit të studimit. Procedura që ndjek departamenti i Pedagogji-Psikologjisë përbëhet nga disa hapa si ngritja e komisionit ad-hoc “Komisioni i vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit akademik”, i propozuar nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale dhe i miratuar nga Rektori i Universitetit të Tiranës, të cilët bëjnë përzgjedhjen përfundimtare të personelit akademik. Emërimi i personelit akademik bëhet nga Rektori. (Dokumenti 1.2 Statuti i UT, 2018; Dokumenti 1.3 Rregullore e Universitetit të Tiranës; Dokumenti 1.12 Manuali për punësimin e personelit në UT)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Fakulteti i Shkencave Sociale në UT angazhohet në drejtim të përmirësimit të kushteve të përshtatshme për të realizuar detyrat e gjithsecilit sipas rolit dhe përgjegjësisë. Nga vizita në FSHS, GVJ konstatoi se kapacitetet infrastrukturore në dispozicion, sallat e departamenteve, zyrat, zyrat individuale të drejtuesve, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme (poste pune, kompjuter, sistem kondicionimi dhe ndriçimi) janë tregues të një mjedisi të përshtatshëm. Bazuar në informacionet e marra nga takimet me stafin si dhe nga informacioni i siguruar nga RVB rezulton se mësimi fizikisht në auditor zhvillohet në përputhje me rregulloret e brendshme si dhe ligjet në fuqi. Kushte të tilla sigurojnë krijimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave. (Dokumenti 2.33 Raporti i ekspertit për infrastrukturën (Mbrotjtja nga zjarri, higjena, sigurimi i godinës; Dokumenti 4.13 Të dhëna për infrastrukturën)
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Programi i studimit Bachelor në Psikologji është nën administrimin e Departamentit të Pedagogji-Psikologjisë pranë Fakultetit të Shkencave Sociale. GVJ gjatë vizitës në institucion në takimin me stafin e institucionit konstatoi që Drejtoria e kërkimit shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me jashtë është njësi që njofton departamentin në lidhje me thirrje të ndryshme për konferenca shkencore ndërkombëtare,

	<p>projekte kërkimore, trajnime, vizita studimore, etj, në përputhje me kornizën dhe statutin. Stafi akademik mbështetet në cdo iniciativë për të realizuar konferenca jashtë vendi, vizita studimore, etj. Shqyrtimi i dokumentacionit tregoi se institucioni realizon disa nisma të cilat angazhojnë dhe nxisin stafin akademik për zhvillim profesional. Stafi përfshihet në organizimin dhe realizimin e konferencave shkencore, projekteve kërkimore, mobilitete në kuadër të programit Erasmus + etj. Institucioni mbështet përmes skemës së financimit të kërkimit shkencor stafin akademik që realizon botime të artikujve shkencor të indeksuara në Scopus. (Dokumenti 2.21 Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik 2020; Dokumenti 4.11 Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit; Dokumenti 2.19 Raport periodik i NJSBC)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë në FSHS ka organizuar trajnime të vazhdueshme në lidhje me përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie kryesisht në lidhje me mësimin online, për të cilat FSHS ka realizuar dhe udhëzues. Stafi akademik, gjithashtu, është pjesë e trajnimeve dhe workshopeve të ndryshme që realizohen nga OJF, institucione të ndryshme etj. Gjithashtu marrja pjesë e stafit në programet Erasmus + krijon mundësi për të përfituar nga eksperiencia dhe shkëmbimi i metodave inovative të mësimdhënies. (Dokumenti 2.21, Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik 2020; Dokumenti 4.15 Raport për Trajnime të stafit akademik në kohën e Pandemisë Covid 19).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar. Bazuar në informacionin e dosjes së vet-vlerësimit dhe takimeve apo informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Departamenti i Pedagogjisë-Psikologjisë, ka angazhuar staf akademik me kohë të plotë me tituj dhe grada, po ashtu staf akademik me kohë të pjesshme, si dhe staf ndihmës akademik. Stafi akademik i programit të studimit “Bachelor në Psikologji” merr pjesë dhe organizon konferenca të ndryshme ndërkombëtare, kombëtare etj. Përgjatë vitit 2021-2022 personeli akademik me kohë të plotë i përfshirë në program ka qënë: 2 Prof. Dr dhe 3 Prof.Assoc 13 Dr, ndërsa si lektor me kontrate ka rekrutuar 6 me gradën Dr dhe 22 me Msc. Formimi profesional i personelit akademik është në përputhje me përmbushjen e objektivave të programit të studimit. (Dokumenti 2.22 Politika e FSHS për zhvillimin profesional të</p>

	<i>personelit akademik; Dokumenti 4.11 Të dhënat për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Sociale e përmbush këtë kriter nga pikëpamja e sipërfaqes dhe mjediseve të nevojshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Mjediset e godinave plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral. Mësimi në Programin e studimit Bachelor në Psikologji ka në dispozicion salla leksioni, seminari, zyra dhe bibliotekë të cilat kanë infrastrukturën e duhur për një proces normal të të nxënit. Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me videoprojektor dhe mjete të tjera logjistike. Nga vizita në institucion grupi i GVJ konstaton se mjediset e përshkruara në dokumentacion ishin deri diku të mjaftueshme dhe të përshtatshme për realizimin e proceseve akademike. <i>(Dokumenti 2.33 Raporti i ekspertit për infrastrukturën (Mbrojtja nga zjarri, higjena, sigurimi i godinës; Dokumenti 4.13 Të dhëna për infrastrukturën)</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset mësimore në Fakultetin e Shkencave Sociale janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimit në kushte bashkëkohore. Biblioteka e këtij fakulteti që është në funksion të zbatimit të këtij program studimi, është e kompletuar me pajisje kompjuterike (video-projektor dhe kompjutera të lidhur me internet) dhe është e aksesueshme për të gjithë studentët. GVJ konstaton se biblioteka ka një numër të pakët të kompjuterave në raport me studentët e FSHS. <i>GVJ sugjeron që të merren masa nga FSHS në këtë drejtim.</i></p>

	<i>(Dokumenti 2.33 Raporti i ekspertit për infrastrukturën (Mbrojtja nga zjarri, higjena, sigurimi i godinës; Dokumenti 4.13 Të dhëna për infrastrukturën)</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	<p>Të gjitha aktivitetet në funksion të programit të studimit Bachelor në Psikologji realizohen në FSHS. Fakulteti ka salla leksionesh dhe seminaresh të pajisura me mjetet e nevojshme të teknologjisë. Në rast të aktiviteteve ku ka pjesmarrje të gjërë, FSHS, ka në dispozicion një sallë të madhe Aula Magna.</p> <p><i>(Dokumenti 2.33 Raporti i ekspertit për infrastrukturën (Mbrojtja nga zjarri, higjena, sigurimi i godinës; Dokumenti 4.13 Të dhëna për infrastrukturën)</i></p>
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	<p>Mjediset mësimore në Fakultetin e Shkencave Sociale janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, të tilla si laptopë, PC, projektor, wireless, të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimin në kushte bashkëkohore. Laboratori i informatikës, që gjendet brenda Bibliotekës së FSHS që është në funksion të zbatimit të këtij program studimi, është kompletuar me disa pajisje kompjuterike (video-projektor dhe kompjutera të lidhur me internet) dhe është i aksesueshëm për studentët.</p> <p><i>Megjithatë, GJVJ sugjeron që është e domosdoshme që për këtë program studimi DPP të krijojë një laborator më vete, i cili të këtë kompjutera të mjaftueshëm për të gjithë studentët e grupit duke ndihmuar në realizimin me sukses të disa lëndëve. (Dokumenti 2.33 Raporti i ekspertit për infrastrukturën (Mbrojtja nga zjarri, higjena, sigurimi i godinës; Dokumenti 4.13 Të dhëna për infrastrukturën)</i></p>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	<p>Fakulteti i Shkencave Sociale disponon një listë marrëveshjesh me institucione shtetërore, private dhe OJF për kryerjen e praktikave profesionale pranë tyre, ku të gjitha këto institucione e kanë të integruar funksionin e psikologut në organikën e tyre. Duke iu referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të praktikës profesionale për programin e studimit Bachelor në "Psikologji" konstatohen 37 marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike si Universiteti i Zadarit, Universiteti i Lozanës, DAR Tiranë, ZAV në Tiranë, Shërbimi social shtetëror etj., si dhe me disa institucione jopublike si OJF, universitete etj.</p> <p><i>(Dokumenti 3.27 Marrëveshje e praktikës profesionale e Departamentit Pedagogji-Psikologji për programin e studimit</i></p>

	<i>Bachelor në Psikologji; Dokumenti 3.17 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit e partnerëve për praktikën profesionale).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Sociale ka hapësira dhe u jep mundësi studentëve të bëjnë kërkime online apo të studiojnë materiale fizike në një mjedis me hapësira dhe kushte komode për studim. Ajo është e pajisur me tavolina studimi, kompjutera dhe internet pa limit përmes sistemit wi-fi për të gjithë studentët dhe anëtarët e personelit që duan të shfrytëzojnë mjediset e bibliotekës për shfletim të literaturës për nevoja të ndryshme. FSHS disponon një Bibliotekë e cila ka një fond librash, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, duke përfshirë edhe tituj të fushave të ndryshme, ndër të cilat ka dhe tituj të fushës së psikologjisë, sociologjisë dhe filozofisë. Krahas literaturës fizike, institucioni përdor materiale ndihmëse dhe informuese për studentët si dhe forma e leksioneve në Pdf të cilat i vihen në dispozicion studenteve nëpërmjet faqes online. Çdo student ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë dhe të aksesojë bibliotekën online. Siç është lartpërmendur është e nevojshme që të merren masa për shtimin e numrit të kompjuterave në këtë sallë.</p> <p><i>(Dokumenti 2.29 Informacion mbi Bibliotekën; Dokumenti 2.30 Buxhetimi për pasurimin e bibliotekës në vitin e fundit në nivel Fakulteti, 2021; Dokumenti 2.31 Dokumentat për blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS, 2022)</i></p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e</p>	<p>Kapaciteti që ka biblioteka nuk garanton mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët e programit të studimit. Për fushën e psikologjisë janë më shumë libra në versionin online sesa në atë të printuar. Megjithatë vihet re një përpjekje nga FSHS për të shtuar titujt e librave hard-copy në Bibliotekë. Nga Dokumenti "Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS" mund të konstatohet</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43428

E-mail: info@ascal.a

Web site: www.ascal.al

<p>përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>se nga i gjithë fondi i blerjes së librave për UT në vitin 2022, ku janë blerë në total 539 tituj, rreth 42 tituj i përkasin fushës së psikologjisë.</p> <p><i>GVJ sugjeron që është e nevojshme që FSHS të bëjë përpjekje të mëtejshme për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</i></p> <p><i>(Dokumenti 2.30 Buxhetimi për pasurimin e bibliotekës në vitin e fundit në nivel fakulteti; Dokumenti 2.31 Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik dhe studentët e programit të studimit Bachelor në “Psikologji” kanë në dispozicion të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies platformat elektronike të aksesimit në tre bibliotekat online.</p> <p>FSHS, UT është abonuar në platforma online dhe shfrytëzon bibliotekat online për nevoja mësimore dhe kërkimore, si EuroPS – Services; Publications UNRISD; Springer; Journals.Sage Pub; Wiley dhe U-library-COBISS.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se pranë bibliotekës të FSHS kishte një numër të konsiderueshëm tekstesh online në fushën e psikologjisë, të cilat mund të përdoren nga stafi dhe studentët. FSHS bën përpjekje për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit, duke përfituar edhe nga donacionet e pedagogëve me botimet e tyre.</p> <p><i>(Dokumenti 2.29 Informacion mbi Bibliotekën; Dokumenti 2.30 Buxhetimi për pasurimin e bibliotekës në vitin e fundit në nivel fakulteti; Dokumenti 2.31 Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS)</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka e FSHS është e pajisur me laptop të cilët kanë të instaluar të gjitha programet kompjuterike të nevojshme. Biblioteka është e pajisur me dy salla, sallën multi mediale e pajisur me 8 kompjutera si dhe sallën e leximit me 72 poste pune. Shërbimet e bibliotekës ofrohen pa pagesë për të gjithë studentët e FSHS dhe për personelin e institucionit. Për t’u bërë anëtar i bibliotekës mjafton një regjistrim i thjeshtë me një kartë identiteti dhe studenti hap librezën e bibliotekës. Përmes saj, studentët dhe stafi kanë të drejtë të tërheqin libra nga biblioteka për afate të përcaktuara. Biblioteka on-EuroPS – Services; Publications UNRISD; Springer; Journals.Sage Pub; Wiley dhe U-library-COBISS ofrojnë gjithashtu akses shfrytëzimi të barabartë për të gjithë studentët si fizikisht ashtu dhe në biblioteka on-line.</p>

	<i>(Dokumenti 2.29 Informacion mbi Bibliotekën; Dokumenti 2.30 Buxheti për pasurimin e bibliotekës në vitin e fundit në nivel fakulteti; Dokumenti 2.31 Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS)</i>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	FSHS parashikon një buxhet vjetor për pasurimin me literaturë të fundit në bazë të kërkesave të stafit akademik paraqitur nga Departamenti i Pedagogjisë- Psikologjisë realizohet në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të UT, sipas kërkesave të hartuara nga stafi akademik i departamentit të psikologjisë për shtimin e titujve në bibliotekë në mbështetje të programit të studimit Bachelor në Psikologji. <i>(Dokumenti 2.30 Buxheti për pasurimin e bibliotekës në vitin e fundit në nivel fakulteti; Dokumenti 2.31 Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS)</i>			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka e FSHS ka të punësuar staf të mjaftueshëm për të ndihmuar studentët gjatë kërkimit dhe leximit në bibliotekë, konkretisht 2 punonjëse: përgjegjëse biblioteke dhe klasifikatore. Biblioteka punon gjatë orarit 08.00-18.00. Studentët njihen me orarin në mjediset e institucionit dhe në hyrje të bibliotekës. Gjatë vizitës në biblioteke, konstatuam që edhe gjatë sezonit të provimeve biblioteka ka të njëjtat orare. <i>(Dokumenti 2.29 Informacion mbi Bibliotekën)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Referuar RVB-së, dhe vizitave në Institucion i gjithë informacioni në lidhje me studentët e FSHS menaxhohet nëpërmjet sistemit informatik nga sekretaria mësimore dhe stafi i IT-së. Duke iu referuar dhe nenit 5, të Rregullores së sekretarisë mësimore konstatuam se sekretaria rregjistron elektronikisht të dhënat e tre rregjistrave bazë; rregjistron studentët në sistemin elektronik të sekretarisë mësimore; rregjistron studentët e transferuar; studentët e diplomuar; si dhe rregjistron studentët në grupet mësimore. Gjithashtu, sekretaria bën kalimin e studentëve në vite pasardhëse sipas

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@ascal.a


	<p>numrit të parashikuar, ruan në formë elektronike procesverbalet e vlerësimit. Në këtë sistem kanë qasje pedagogët të cilët hedhin të dhëna për frekuentimin e studentëve dhe vlerësimet e provimeve. Po ashtu, dhe studentët kanë qasje duke përdorur llogarinë e tyre. Gjithashtu, falë këtij sistemi informatik sekretaria nxjerr të dokumente elektronike mbi bazën e të dhënave, sic parashikon pika 2 e nenit 5, të Rregullores së sekretarisë mësimore. Këto dokumente përshijnë vërtetime në lidhje me statusin e studentit; lista notash të studentit, raporte statistikore në lidhje me ecurinë e studentëve si dhe në lidhje me numrin e studentëve sipas programeve mësimore.</p> <p><i>(Dokumenti 1.10 Rregullore për funksionimin e sistemit informatic në UT; Dokumenti 2.9 Rregullore e Sekretarisë mësimore 2018)</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>FSHS nuk ka një platformë e cila ti shërbejë drejtpërsëdrejti sistemit të brendshëm të menaxhimit që administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. I gjithë dokumentacioni dhe aktiviteti i personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrative menaxhohet dhe ruhet në zyrën e Burimeve Njerëzore. Në këtë zyrë secili pedagog ka dosjen e tij personale të përditësuar me zhvillimet që stafi ka bërë gjatë punës së tij kërkimore-shkencore, në drejtim të fitimit të gradës apo titujve akademik.</p> <p><i>(Dokumenti 1.12 Manuali për punësimin e personelit në UT; Dokumenti 2.20 Informacion për politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit akademik)</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Marrja e informacionit dhe njohja me dokumentacionin për personelin dhe studentët bëhet në përputhje me ligjin nr.887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, udhëzuesin e UT “Privatësia”, gjithashtu dhe në përputhje me Rregulloren e UT për “Mbrojtjen, përpunimin dhe sigurimin e të dhënave personale në UT”. Secili pedagog dhe studentet është i pajisur me adresë emaili zyrtare me anë të së cilës aksesojnë në sistem.</p> <p><i>(Dokumenti 1.8 Rregullore e UT për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT; Dokumenti 1.9 Privatësia në UT)</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të</p>	<p>Nga hulumtimi i dokumentacionit, në FSHS e vetmja platformë që funksionon është Microsoft Team. Ajo mundëson monitorimin e aktivitetit akademik nga strukturat e NJSBC-së dhe jo vetëm. Nëpërmjet kësaj platforme merren të</p>

komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	<p>dhëna dhe realizohen raporte mbi aktivitetin e përdorimit të saj nga anëtarët e personelit akademik.</p> <p><i>(Dokument 1.15 Udhëzues i UT-së për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të programit të studimit Bsc në Psikologji, GVJ konstatoi se aktualisht nuk ka një sistem institucional funksional që të mund të monitoroj në kohë reale aktivitetin mësimor të personelit akademik dhe administrativ. Raportimi i aktiviteteve të ndryshme në FSHS realizohet përmes email-it zyrtar por edhe përmes strukturave të cilat janë përgjegjëse për administrimin dhe shpërndarjen e këtij informacioni. Gjithashtu, informacioni në lidhje me aktivitetet e ndryshme që lidhen me këtë program studimi publikohen dhe në faqen zyrtare në internet https://fshs-ut.edu.al.</p> <p><i>GVJ sugjeron krijimin e një portali të dedikuar për studentët të cilët do të kenë mundësi të informoheshin në kohë reale për procesin e mësimin, programet, materialet lëndore, literaturën e rekomanduar etj.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Në faqen zyrtare të FSHS janë të publikuara të dhëna mbi Departamentin e Pedagogjisë- Psikologjisë si dhe programet që ky department ofron. Në këtë seksion gjendet dhe plani mësimor i këtij programi studimi. Në seksionin studentët gjendet informacion në lidhje me: orarin mësimor; datat e provimeve; struktura mësimore; udhëzim për provimet; manuali i microsoft teams për studentët; broshura informative.</p> <p>Në seksionin e kërkimi dhe botime ka informacion në lidhje me botimin në revistën shkencore të FSHS, informacion në lidhje me konferenca, projekte dhe programet e shkëmbimit.</p> <p>Në seksionin e lajmërimeve konstatohet që FSHS pasqyron në website cdo aktivitet që organizon, gjithashtu, publikohen thirrje të ndryshme për trajnime, konferenca, mobilitete etj.</p> <p>Informacioni është i disponueshëm në gjuhën shqipe. https://fshs-ut.edu.al/.</p> <p>Ndërsa informacioni në website të UT, në lidhje me FSHS është shqip dhe anglisht.</p> <p>https://unitir.edu.al/eng/cikli-i-i-bachelor/</p> <p>https://unitir.edu.al/eng/fakulteti-i-shkencave-sociale/</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet përfundimisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ bazuar në DVV konstaton se raporti financiar hartohet në nivel institucioni çdo vit. Ai përgatitet nga administratori dhe i dërgohet për njohje Bordit të Administrimit të UT. Raportet përmbajnë të dhëna të hollësishme për llogaritjen e kostove të programit Bsc në Psikologji dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi (Dokumenti 3.22 Të dhëna që lidhen e kostot e programit të studimit, plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi)</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit të programit të studimit përfshin në mënyrë të hollësishme të gjitha detyrimet financiare, pagat, shpenzimet, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës, si edhe aksesin në bibliotekën on-line. Ky plan financimi i programit të studimit Bachelor në Psikologji është hartuar duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit të veprimtarive mësimore dhe shkencore edhe duke ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre dhe shpenzimet në drejtimin që ato do përdoren. (Dokumenti 3.22 Të dhëna që lidhen e kostot e programit të studimit, plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme</p>	<p>Njesia e Auditimit të Brendshëm, ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Urdhrit të Ministrit të Financave nr 100 date 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”. Institucioni kryen auditim të përvitshëm</p>




financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni kryen auditim të brendshëm me anë të Zyrës së Auditit të brendshëm. Zyra e Auditit të brendshëm është njësi administrative e ngritur dhe funksionale brenda institucionit e cila ka si mision kontrollin e procedurave dhe rregullavë të vendosura në rregulloren e funksionimit të zyrës së financës dhe auditit të brendshëm.			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarrëvajtjen normale të tij.	Duke iu referuar RVB së, konstatojmë se FSHS ka të dokumentuara raportet financiare të tre viteve të fundit, procedurat e të cilave fillojnë të kryhen gjatë periudhës Mars-Maj. Rektorati përgatit raportin financiar të realizuar, mbështetur në planifikimet e kryera në programin financiar. Ky raport miratohet nga Bordi i Administrimit. Në përfundim të kësaj faze realizohet edhe një analizë që planifikon ndërhyrjet e nevojshme në të ardhmen për mbarrëvajtjen e programeve të studimit. <i>(Aneks 2.18-1 Analize vjetore e punës së FSHS 2020-2021)</i>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Duke iu referuar dhe numrit të studentëve të rregjistruar çdo vit në këtë program studimi, konstatojmë si GVJ se ky program ka qëndrueshmëri financiare të mjaftueshme për përmirësim të ndjeshëm dhe gjenerim të të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. <i>(Dokumenti 2.18 Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave sociale 2019-2020, 2020-2021)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.a




Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Programi i studimit është ndërtuar dhe bazuar në rregulloren e vet përkatëse të programit të studimit, në rregulloren e universitetit, si dhe në Ligjin e Arsimit të Lartë. Në rregulloren e këtij programi studimi përcaktohen qartë të gjitha organet, rolet dhe përgjegjësitë e tyre për mbarëvajtjen e plotë të këtij program studimi. Kjo rregullore i bashkangjitet dokumentave të tjera të FSHS dhe DPP dhe i shërben edhe studentëve të këtij program studimi për t'u bere me dije për te drejtat dhe detyrimet e tyre për gjatë të gjithë kohës së studimit pranë këtij institucioni.</p> <p><i>(Dokumenti 3.6 Rregullore e programit të studimit; Dokumenti 1.3 Rregullore e UT, 2016; Dokumenti 3.3 Rregullore e Departamentit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se politikat, kriteret dhe procedurat nga hyrja në dalje e studentëve garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë, dhe më pas për të gjithë studentët përgjatë zhvillimit të programit të studimit. Pranimi i studentëve për çdo vit akademik kryhet në përputhje me kriteret dhe kuotat e propozuara dhe të miratuara për çdo program studimi, të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit. Studentët e ardhshëm informohen paraprakisht në lidhje me programet e studimit dhe me kriteret e pranimin në UT. Informacioni u përcillet maturantëve në formë të ndryshme. Zyra e Këshillimit të Karrierës organizon "Ditët e Hapura", ku ftohen maturantë nga e gjithë Shqipëria për të marrë informacion të plotë për programet e studimit, kriteret e pranimin, mënyrën e aplikimit, ambientet, infrastrukturën etj. Informacion më i zgjeruar në lidhje me programet e studimit jepet përmes broshurave të publikuara nga UT dhe nga FSHS, përmes fletëpalosjeve, si dhe në faqen e internetit të FSHS. UT-ja mban kontakte me MASR-në dhe Drejtoritë Rajonale të Arsimit lidhur me informimin e nxënësve të shkollave të mesme. Pranimi i studentëve të ciklit të parë koordinohet gjithashtu me portalin e maturantit "U-Albania". Portali u mundëson të gjithë studentëve të ardhshëm të marrin informacion mbi kriteret e pranimin, kurrikulën, kuotat dhe tarifën e studimit. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve paraqiten në Rregulloren e Universitetit të Tiranës, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave sociale, si dhe në rregulloren e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në</p>

	<p>Psikologji. Të gjitha kriteret, kërkesat dhe kuotat e pranimit bëhen transparente për të gjithë kandidatët në kohë reale në website të UT, FSHS si dhe në këndet e informacionit në FSHS. Një proces i tillë siguron transparencë dhe drejtësi ndaj kandidatëve për student.</p> <p><i>(Dokumenti 3.6 Rregullore e programit të studimit; Dokumenti 1.3 Rregullore e UT, 2016; Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS)</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në faqen zyrtare të FSHS dhe të UT janë të shpallura të gjitha informacionet që lidhen me procedurat e pranimit bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, dokumentacioni që kërkohet, kohëzgjatja e programit dhe numri i krediteve që fiton studenti. E gjithë procedura është paraqitur në mënyrë transparente. Procedurat që lidhen me transferimin, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku përmes informacionit në faqen e FSHS mbi këtë procedurë dhe dokumentat e kërkuar për transferimin e studimeve konform rregullave dhe ligjeve në fuqi.</p> <p>Ref 1: https://drive.google.com/file/d/1FDxNWN0tebnzLoU5PQ2r6CBIP5X4CbSv/view</p> <p>Ref 2: https://fshs-ut.edu.al/?p=9361</p> <p><i>(Dokumenti 4.9 Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit pranon kandidatët në varësi të kapaciteteve infrastrukurore dhe akademike të FSHS, UT dhe sipas kriterëve specifike që mund të propozohen nga Departamenti dhe miratohen në Senatin Akademik. Numri maksimal i studentëve që mund të regjistrohen dhe mënyrat e përzgjedhjes së tyre, bëhen publike çdo fillim viti akademik para fillimit të regjistrimeve. https://fshs-ut.edu.al</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Vendimet për kriteret specifike dhe të përgjithshme, për pranimin në programin e studimit, janë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, aktet nënligjore dhe procedurat që ndiqen në maturën shtetërore. Pranimi i studentëve në programin Bachelor Psikologji është rregulluar nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave, me anë të të cilit vendoset nota mesatare në hyrje për çdo vit akademik. Në vitin akademik 2018-2019 nota mesatare në hyrje ishte 7, ndërsa për vitin akademik 2019-2020 është 7.5. Në dokumentat rregullatorë, të institucionit, është e shprehur, që përveç shtetasve shqiptarë, mund të regjistrohen dhe shtetas të huaj.</p>



	<i>(Dokumenti 3.13 Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit; Dokumneti 3.14 Vendim për miratimin e kritereve të pranimit për programin e studimit)</i>			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni realizon një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi, për të gjithë të interesuarit që duan të vazhdojnë studimet e tyre në UT, FSHS. Format më të cilat realizohen udhëzimi i studentëve, në lidhje me kriteret e përgjithshme/të veçanta, për t'u regjistruar në programin e Psikologjisë, janë të shumta si ture në Gjinnaze, këshillimi në hollin e FSHS gjatë periudhës së regjistrimeve, informacion në website, në rrjete sociale etj.</p> <p>Për të gjithë studentët e rinj të regjistruar realizohet Java e Orientimit. Gjatë kësaj jave realizohen takime për shpjegimin e sistemit të studimeve, rregulloreve dhe procedurave administrative të UT; njihen me ambientet ku do të zhvillohet mësimi etj. Kriteret e programeve të studimit publikohen dhe i vihen në dispozicion palëve të interesuar nëpërmjet rrugëve dhe instrumenteve të ndryshme të komunikimit.</p> <p><i>(Dokumenti 3.16 Broshura informative për maturantët, Departamenti i Pedagogjisë-Psikologjisë)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet në përbuzet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuara, rregullores së programit të studimit, faqes zyrtare të webit si dhe në takimin e zhvilluar me stafin akademik, konkludon se informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe në aktet e tjera rregullatore.</p> <p><i>(Dokumenti 3.6 Rregullore e programit të studimit; Dokumenti 1.3 Rregullore e UT, 2016; Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS; Dokumenti 3.13 Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit; Dokumneti 3.14 Vendim për miratimin e kritereve të pranimit për programin e studimit)</i></p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje	Nga informacioni i shqyrtuar GVJ konkludon se FSHS ndjek procedurat në lidhje me transferimin e studimeve në përputhje

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.a

Web site: www.ascal.al

<p>me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>dhe me bazën ligjore në fuqi, saktësisht udhëzimi i MASR, nr.17, datë 30.07.2019. Studentët informohen në lidhje me transferimin e studimeve, kur është e mundur, njohjen e kualifikimeve apo studimeve të pjesshme të realizuara në një institucion tjetër të arsimit të lartë. FSHS ofron informacion në lidhje me procesin e ekuivalentimit të studimeve, me universitetet e tjera jashtë vendit. Kriteret e transferimit të studimeve dhe ekuivalentimit janë të parashtruara në rregullore të studimeve.</p> <p><i>(Dokumenti 3.6 Rregullore e programit të studimit; Dokumenti 1.3 Rregullore e UT, 2016; Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Nga takimet e realizuara me stafin akademik, studentët si dhe dokumentacioni i shqyrtuar, GVJ konstaton se përcaktimi i formës së vlerësimit të dijeve për lëndët specifike, bëhet nga pedagogu i lëndës si dhe pasqyrohet në programin e lëndës, përkatësisht sipas <i>Nenit 26</i> të Rregullores së programit të studimit. Silabuset janë në dispozicion të studentëve në të gjithë format, si elektronikisht, ashtu dhe fizikisht në sekretarinë mësimore. Studentët pohuan se njihen me format e vlerësimit të njohurive, nga komunikimi i drejtpërdrejtë me pedagogët, qysh në fillim të procesit mësimor kur bëhet dhe prezantimi i përgjithshëm i lëndës.</p> <p><i>(Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS; Dokumenti 3.6 Rregullore e programit të studimit; Dokumenti 4.3.1 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit 2018-2019; Dokumenti 4.3.2 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit 2019-2020; Dokumenti 4.3.3 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit 2020-2021)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit FSHS ka miratuar kriteret që duhen plotësuar për të shkuar drejt provimit të formimit apo mbrojtjes së punimit të diplomës. Dokumenti për punimin e diplomës, përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, dhe të gjitha fazat që të shpien në mbrojtjen e diplomës. Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura që në fillim të cdo viti akademik.</p> <p><i>(Dokumenti 2.11 Rregullore e diplomimit; Dokumenti 4.5 Paketa për punimin e diplomës Bachelor në Psikologji)</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura</p>	<p>GVJ, konkludon se, UT dhe FSHS ofron informacione në mënyrë periodike të organizuara, në website si dhe në ditët e informimit të studentëve përmes vizitave në shkolla të mesme të qyteteve të ndryshme. Veprimtari të tilla, të njohura si "<i>Ditët e hapura</i>", në FSHS, kanë për qëllim të njohin maturantët me programet e studimit që ofrohen nga FSHS si dhe i ftojnë në</p>



për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>“Javën e orientimit”. Gjatë javëve të regjistrimit FSHS, përmes grupeve të punës të përbërë nga staf akademik informon maturantët që janë të interesuar të studiojnë në FSHS. Nga sa konstatohet FSHS ka prioritet gjithashtu dhe promovimin e programit Bachelor në Psikologji online, në website si dhe në rrjetet sociale. Gjithashtu, në fillim të vitit akademik cdo student pajiset me fletëpalosje të FSHS. https://fshs-ut.edu.al/?page_id=8049</p> <p>(Dokumenti 3.16 Broshurë FSHS, UT)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	GVJ konstaton se informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit i vihet në dispozicion studentëve nëpërmjet këshillimit me stafin akademik gjatë fazës së interesimit për programin e studimit; informacionit që merret në Sekretarinë mësimore, në rregulloren e programit të studimit, në website të FSHS etj. Çdo veprimtari në lidhje me marketingun e programit të studimit kryhet sipas politikës së Marketingut të DPP, në FSHS, UT. Në këtë politikë janë të përcaktuara qartë format e komunikimit të informacionit në lidhje me programin e studimit si përmes TV, media sociale, radio, përmes pedagogëve dhe studentëve, fletëpalosjeve, posterave, roller baner. Gjithashtu, kjo politikë parashikon seminare konferenca ditë të hapura si dhe aktivitete sensibilizuese. Një rol shumë të rëndësishëm gjatë këtij procesi luan dhe Zyra e Karrierës e cila organizon takime informuese me studentët. (Dokumenti 3.16 Politika e marketingut për programin e studimit)
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët,	Duke iu referuar RVB si dhe takimeve gjatë vizitë në institucion konstatuam se FSHS vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion mbi kurrikulën dhe programin e studimit, i cili mund të merret në faqen zyrtare të institucionit, ose gjatë fazës së regjistrimit, gjatë ditëve të orientimit. Departamenti i

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.a

<p>përbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Pedagogji-Psikologjisë në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës, organizon takime informuese me studentët si dhe u prezanton studentëve Broshurat. Syllabuset e lëndëve mësimore përbajnë informacione të detajuara mbi ngarkesën, temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar.</p> <p><i>(Dokumenti 3.16 Broshurë FSHS, UT; Dokumenti 4.3.1 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit 2018-2019; Dokumenti 4.3.2 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit 2019-2020; Dokumenti 4.3.3 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit 2020-2021)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Në shqyrtimin e dokumentacionit, si dhe nga intervistat me stafin akademik, GVJ konstatoi se ka një përpjekje të vazhdueshme nga FSHS, e konkretisht nga Departamenti i Pedagogjisë-Psikologjisë për të studjuar tregun e punës. FSHS organizon në mënyrë të vazhdueshme takime, sesione informuese, orë të hapura me përfaqësues të institucioneve të cilat ofrojnë mundësi punësimi. Studentët janë pjesë e vazhdueshme e këtyre takimeve. Përmes Zyrës së Karrierës, studentët informohen në lidhje me mundësitë për punësim falë këtij networku të ndërtuar. Duhet theksuar se studentët që diplomohen në Bachelor në Psikologji, për shkak të faktit se Psikologu është profesion i rregulluar, nuk mund të punësohen menjëherë pas përfundimit të ciklit të parë. Por takimet në network, me Bordin e punës, pjesmarrja në panairt e punës i ndihmon studentët të qartësohen rreth mundësive për praktika, stazhe, internshipe, etj.</p> <p><i>(Dokumenti 2.25. Rregullore e shërbimit të karrierës; Dokumenti 3.19 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit).</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konkludon se studentëve, nëpërmjet web-it, sekretarisë mësimore dhe stafit akademik, në mënyrë të vazhdueshme u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, numrin e lëndëve për çdo semestër, strukturën mësimore, si dhe informacion në lidhje me logjistikën dhe shërbimet që janë në funksion të realizimit me sukses të këtij programi studimi.</p> <p>https://fshs-ut.edu.al</p> <p><i>(Dokumenti 4.3.1 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit 2018-2019; Dokumenti 4.3.2 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit 2019-2020; Dokumenti 4.3.3 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit 2020-2021)</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.a

Web site: www.ascal.al


<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>GVJ ka konstatuar se FSHS përcjell informacionet në lidhje me programin e studimit përmes “Microsoft teams”, platformë në të cilën kanë akses stafi akademik dhe studentët. Kjo platformë ndihmon pedagogun të përcjelli informacion në lidhje me organizimin e lëndës edhe në formë elektronike, duke krijuar mundësi studentëve ta aksesojnë si informacion kur ti nevojitet. Për këtë platformë ka manual përdorimi si për stafin akademik ashtu dhe për studentët i cili është i disponueshëm në faqen zyrtare të FSHS.</p> <p>Linku për studentët: https://fshs-ut.edu.al/?p=5992 (Dokumenti 1.15 Udhezues UT per perdorimin e sistemit te mesimit ne distance)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>I gjithë informacioni i studentëve ndër vite menaxhohet nga sekretaria mësimore, kryesekretarja. Të gjithë të dhënat e studentëve gjenden të rregjistruara në databasen e sekretarisë mësimore si dhe në rregjistrin themeltar të notave. Gjatë vizitës në institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm u njoh me dosjet e studentëve dhe rregjistrin themeltar të tyre. Sekretaria disponon statistika për të diplomuarit në vite në hardcopy dhe elektronikisht. Referuar RVB dhe vizitës në institucion numri i studentëve të diplomuar për tre vite akademike në këtë program rezultoi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Viti akademik 2021-2022 - 97 studentë; • Viti akademik 2020-2021 -114 studentë; • Viti akademik 2019-2020 - 70 studentë; <p>Totali për një cikël studimi është 281 studentë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë,</p>	<p>Çdo student është i pajisur me dosjen personale, pavarësisht statusit që ka si student efektiv, i çrregjistruar nga programi i studimit, apo si ish student. I gjithë ky dokumentacion gjendet i arkivuar pranë sekretarisë mësimore, kryesekretarisë së</p>



Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.a

XB


<p>tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Fakultetit. Nga takimi me kryesekretaren GVJ konstatoi se çdo vit FSHS harton statistikatat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, të largimeve para përfundimit të programit apo të mospërfundimit me sukses të programit të studimit si dhe të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p> <p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion numri i studentëve të regjistruar për tre vite akademike në këtë program rezultoi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Viti akademik 2021-2022 - 117 studentë; • Viti akademik 2020-2021 -117 studentë; • Viti akademik 2019-2020 - 116 studentë; <p>Totali për një cikël studimi është 350 studentë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në FSHS se të dhënat statistikore burojnë nga Rregjistrari themeltar, Rregjistrari i rezultateve akademike si dhe Rregjistrari i diplomave. Të dhënat statistikore gjenden në FSHS në version elektronik dhe letër. Këto të dhëna raportohen rregullisht pranë MASR dhe rektoratit të UT. Nga RVB për programin Bachelor në Psikologji konstatohet se ka një rënie të notës mesatare në dalje për studentët e këtij program studimi.</p> <p><i>(Dokumenti 4.8 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe dalje për programin e studimit; Dokumenti 2.9 Rregullore e sekretarise mesimore)</i></p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sekretaria mësimore e FSHS përpilon, administron dhe mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e regjistrarit themeltar, të hartuar në mënyrë manuale dhe elektronike. Sekretaria mësimore administron regjistrat për çdo program studimi, regjistrin e diplomave, dosjet personale të studentëve, dokumentacionin e procedurave të transferimit apo çregjistrimit, regjistrin bazë të notave, procesverbalet e provimeve etj. Marrja e informacionit dhe njohja me dokumentacionin për personelin dhe studentët bëhet në përputhje me ligjin nr 887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, udhëzuesin e UT “Privatësia”, gjithashtu dhe në përputhje me Rregulloren e UT për “Mbrojtjen, përpunimin dhe sigurimin e të dhënave personale në UT”.</p> <p><i>(Dokumenti 2.9 Rregullore e sekretarise mesimore; Dokumenti 1.8 Rregullore e UT për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT; Dokumenti 1.9 Privatësia në UT)</i></p>


<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Duke iu referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion u konstatua se FSHS, harton raporte analitike periodike mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre. Informacioni transmetohet vit pas viti deri në diplomimin. (Dokumenti 3.18 Raporti vjetor DPP 2020-2021, 2019-2020; Dokumenti 4.8 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe dalje për programin e studimit)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Studentët përfaqësohen në organet drejtuese të institucionit sipas parashikimeve në Statutin e UT, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve. UT/FSHS inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrje, organizimin e lirë, dhe shprehjen e mendimit të tyre. Ndër strukturat kryesore të parashikuara në Nenin 129 të Statutit të UT, përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senatin akademik • Këshillin e etikës • Komisionet e përhershme të lejuara me Statut • Këshillat e studentëve <p>Sipas nenit 135 të Statutit “studentët kanë të drejtë të organizohen dhe në format tjera të njohura nga legjislacioni në fuqi dhe të realizojnë vetë ose në bashkëpunim me strukturat e Universitetit dhe njërive bazë aktivitete trajnimi, mësimore dhe/ose kërkimore-shkencore”. Gjithashtu, GVJ konstaton se studentët janë pjesë e komisioneve ad-hoc për hartimin e RVB të programit të studimit në rast akreditimi të programit të studimit. (Dokumenti 1.2 Statuti i UT, 2018)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e</p>	<p>Në të gjitha strukturat ku përcaktohet me ligj përfshirja e tyre, kemi një angazhim të shprehur qartë në lidhje me rolin e</p>

<p>studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>studentëve në UT. Studentët janë pjesë e NJSBC, gjithashtu edhe GVB. Në kuadër të procesit të akreditimit të IAL apo programeve të studimit, studentët janë pjesë e grupeve të punës, si dhe e grupit që shkruan raportin e vetëvlerësimit. Në kuadër të marrjes së masave për përmirësimin e programit të studimit FSHS realizon një sërë fokus grupesh me studentët, po ashtu dhe pyetësorë online ose hard copy për të marrë feedback në lidhje me kënaqësinë që kanë me mënyrën e realizimit të programit të studimit.</p> <p><i>(Dokumenti 1.2 Statuti i UT, 2018; Dokumenti 1.6 Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT; Dokumenti 1.11 Manuali i cilesise)</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Ngarkesa akademike e studentëve në këtë program studimi është hartuar dhe zbatohet duke respektuar ligjet dhe aktet nënligjore të institucionit dhe në harmoni dhe me udhëzimet dhe vendimet e MASR. Programet e studimit i nënshtrohen në mënyrë periodike rishikimit në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm, bazuar në parashikimet ligjore në fuqi. Shpërndarja e lëndëve nëpër semestra dhe ngarkesës së shprehur në kredite bëhet mbi parimin e një shpërndarje të balancuar në semestra (afërsisht 30 ECTS për semestër). Në programin Bachelor në Psikologji, studentët duhet të plotësojnë 30 ECTS, për të kaluar në vitin e dytë dhe 60 ECTS për të kaluar në vitin e tretë. Për studentët të cilët duan të transferojnë studimet e tyre në FSHS, UT, kriteret dhe procedurat që ndiqen në këtë rast janë të parashikuara në dokumentet rregullatorë të institucionit.</p> <p><i>(Dokumenti 3.6 Rregullore e programit të studimit; Dokumenti 1.6 Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT; Dokumenti 1.11 Manuali i cilesise; Dokumenti 2.6 Struktura e programeve te studimit FSHS per te 3 ciklet e studimit)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Studentët përfshihen në të gjitha komisionet e përcaktuara nga Statuti i UT. Duke pasur këtë përfshirje në vendimmarrje idetë dhe sugjerimet e tyre merren në konsideratë për të rishikuar dhe përmirësuar programin e studimit. GVJ konstatoi edhe gjatë vizitës në institucion përfshirjen e studentëve në procese të rëndësishme të zhvillimit të programit të studimit Bachelor në Psikologji.</p> <p><i>(Dokumenti 1.2 Statuti i UT, 2018; Dokumenti 1.6 Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT)</i></p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët si dhe nga kqyrja e dokumentacionit vërehet se studentëve u mundësohet transparenca dhe barazia në marrjen e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Në Rregulloren e UT,</p>



<p>vlerësimet e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>përcaktohet procedura në rast ankese nga student në nenin 51 dhe 50 të rubrikës Ankimi. Sipas këtij neni studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Për këtë duhet të drejtohet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja dijoni e rezultatit të provimeve. Ai bënë verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhejn i drejtohet dekanit. Ky i fundit brenda 48 orëve ngre një komision ad hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit Me miratimin e dekanit komisioni bënë vlerësimin përfundimtar.</p> <p><i>(Dokumenti 1.3 Rregullore e UT, 2016; Dokumenti 3.6 Rregullore e programit të studimit; Dokumenti 2.27. Informacion per bazen rregullatore te ankimimit te studenteve)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se institucioni ka Zyrën e Karrierës e cila është në shërbim të informimit të studentëve. Një rol shumë të rëndësishëm luan stafi akademik dhe ndihmës akademik në informimin e studentëve si dhe ofrimin e shërbimit ndaj tyre. Tutoriati dhe këshillimi akademik, në çdo departament janë gjithashtu në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve.</p> <p><i>(Dokumenti 2.25. Rregullore e shërbimit te karrieres; Dokumenti 2.26. Politika per mbështetjen e studenteve dhe strukturave te tyre organizative)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë</p>	<p>FSHS ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion vihet re se veprimtaria e kordinatorit të programit, njësia bazë dhe Zyra e Karrierës orientohen drejt informimit</p>

me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>të studentëve dhe këshillimit të tyre në momentin e regjistrimit me çdo informacion në lidhje me programet e studimit të ofruara, avantazhet që secili prej tyre ofron, mundësitë e punësimit në të ardhmen, etj. Po ashtu ky institucion me qëllim mbështetjen profesionalisht të studentëve dhe ti ndihmojë ata në planifikimin e karrierës ofron dhe udhëheqje dhe kujdestari (tutorat) për studentët. (Dokumenti 2.25. Rregullore e shërbimit të karrierës)</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Studentët kanë shërbim të vazhdueshëm të këshillimit të karrierës. Zyra e Karrierës është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore, mobilitete që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Shpeshherë realizohen panairë të ndryshme për punësim, ku studentët kanë akses të lirë pjesëmarrjeje dhe informohen mbi tregun e punës në përputhje me degën e studimit. Kjo zyrë ka krijuar kontakte të shumta me kompani private dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunon ngushtë jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale/intershipeve të studentëve pranë këtyre institucioneve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata. (Dokumenti 3.20 Të dhëna për mobilitetin e studentëve dhe të pedagogëve; Dokumenti 2.25. Rregullore e shërbimit të karrierës; Dokumenti 2.26. Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturave të tyre organizative)</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>GVJ konstatoi se Zyra e Këshillimit të Karrierës mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në UT ose institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Sipas rregullores së shërbimit të karrierës në FSHS, UT kjo zyrë sipas Nenit 6 "...merr feedback nga punëdhënësit për cilësinë e përgatitjes së të diplomuarve të FSHS-së, të punësuar prej tyre ... këtë dhëna kjo zyrë i pasqyron në raportin vjetor të shërbimit të karrierës dhe ia paraqet dekanit të FSHS-së". (Dokumenti 2.25. Rregullore e shërbimit të karrierës)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR


Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënljore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>GVJ konfirmon se në raport me politikat e institucionit për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe duke u mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera ligjore, në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit kemi disa element të dallueshëm. UT në zbatim të ligjit për arsimin e lartë si dhe në zbatim të Statutit të tij ka ngritur “Komisionin e përhershëm për sigurimin e cilësisë në nivel institucional”, si dhe “Ekipin e vlerësimit të brendshëm të njësisë kryesore” e ngritur ne vitin 2017. Në këto komisione janë përfshirë ekspertë të fushave të ndryshme. Strukturat në fjalë e realizon punën e saj duke u mbështetur në një dokument të rëndësishëm për funksionimin e saj siç është Rregullorja e NJSBC. Gjithashtu, në nivel të njësisë kryesore u konstatua që FSHS ka ngritur dhe komisionin e vlerësimit të performancës. Ky komision vlerëson performancën e të gjitha shërbimeve që FSHS ofron. Komisioni vepron në bazë të rregullores dhe strategjisë së UT.</p> <p><i>(Dokumenti 1.3 Rregullore e UT; Dokumenti 3.6 Rregullore e programit të studimit; Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së NJSBC; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS); Dokumenti 3.4 Strategjia e UT)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në FSHS, konstatoi se Sistemi i brendshëm i cilësisë, funksionon si një rrjet i mirëorganizuar dhe shtrin funksionin e tij në të gjitha departamentet e njësisë kryesore. Ky grup pune bashkëpunon dhe bashkërendon veprimet me Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë në nivel institucional. Ky komision ka në përbërje të tij staf akademik me eksperiencë në IAL si dhe student.</p> <p><i>(Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së NJSBC; Dokumenti</i></p>




bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 3.4 Strategjia e UT; Dokumenti 5.5 Raporti i vlerësimit të brendshëm)			
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Institucioni ka aplikuar për akreditim për programin e studimit në ASCAL konform rregullave në fuqi në vendin tonë. Ka ndjekur të gjitha procedurat zyrtare që lidhen me këtë proces. ASCAL ka ngritur grupin e punës, i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të jashtëm të akreditimit për këtë program studimi. Për sigurimin e cilësisë institucioni përdor instrumentet e ndryshme si pyetësorë me studentët, stafin akademik, takimet në grup për të garantuar ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme. (Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së NJSBC; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 5.5 Raporti i vlerësimit të brendshëm)			
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes planit të saj të veprimit synon që për këto qëllime të realizojë trajnime me stafin akademik dhe administrativ me fokus sigurimin e cilësisë në menaxhim, zhvillimin e projekteve kërkimore, ndërkombëtarizimin përmes programeve të mobilitetit për stafin dhe studentët. Pjesë e këtyre trajnimeve do të jenë zyra e burimeve njerëzore, njësisë për kërkimin shkencorë, departamentet dhe zyra e kujdesit për studentët, zyra e karrierës, kordinatorët e departamenteve dhe senati akademik. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në universitet, konstatohet se në strategjinë e zhvillimit institucional ka politika që synojnë përmirësimin e cilësisë për programin e studimit. Për këtë UT ka realizuar Rregulloren e KPSSC, Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Rregulloren e NjSC, Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, Rregulloren e njësisë kryesore, rregulloren e përdorimit të Teams, manualin e mësimdhënies online, manualin e hartimit të kurrikulave etj. (Dokumenti 1.10 Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT; Dokumenti 1.3 Rregullore e përditësuar e UT; Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS; Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së NJSBC; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS; Dokumenti 3.3 Rregullore e DPP)			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X



Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>UT ka ngritur në nivel departamenti struktura specifike për ruajtjen, përmirësimin dhe monitorimin e cilësisë. Grupet e sigurimit të cilësisë të ngritura në nivel departamenti janë komisione të ngritura Ad-hoc të cilat kanë në përbërje të tyre 2-3 anëtarë të stafit akademik të brendshëm. Këto komisione punojnë për rishikimin e kurrikulave, silabuseve në bashkëpunim me titullarët e lëndëve përkatëse. Gjithashtu, këto komisione kanë detyrë të hartojnë RVB për programin e studimit.</p> <p><i>(Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS; Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së NJSBC; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 2.15 Politika e sigurimit te cilesise FSHS)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se institucioni për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit angazhon titullarët, lektorët e lëndëve dhe asistent-lektorët në azhornimin e syllabuseve. Për të nxitur dhe monitoruar procese të tilla një rol kyç luan Departamenti, dhe zv Dekani i Fakultetit. Zv Dekani luan një rol të rëndësishëm në organizimin e procesit mësimor, rishikimin dhe vlerësimin sistematik për përmirësimin e planeve mësimore të programeve të studimit.</p> <p><i>(Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS; Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së NJSBC; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 2.15 Politika e sigurimit te cilesise FSHS)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni përdor metodologji vlerësimi si dhe instrumente matëse vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit Bachelor në Psikologji të tilla si: metoda të tërthorta pyetësorë të studentëve (2 herë në vit); fokus grupe, mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës pyetësorë për pedagogët, etj. Komisioni njofton në mënyrë zyrtare strukturat përgjegjëse dhe përgjatë procesit të monitorimit përdor format raporte që të japin mundësi të vlerësosh aspekte të ndryshme që lidhen me mënyrën sesi respektohen standartet nga strukturat</p>



	<p>përgjegjëse. Më pas departamenti realizon një analizë të detajuar në lidhje nga sa konstatohet nga NJSBC.</p> <p><i>(Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS; Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së NJSBC; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 2.15 Politika e sigurimit të cilësive FSHS)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>NJSBC pas realizimit të procesit monitorues, harton një raport, i cili u përcillet departamenteve për reflektim. Kjo nënkupton që departamentet mund të argumentojë dhe qartësojnë disa aspekte që lidhen me konstatimet e këtij komisioni. GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni dokumenton në formë shkresore rezultatet dhe raportet e vlerësimeve. Procedura që ndiqet është e tillë që pas përfundimit dhe mbledhjes së të dhënave informacioni / raporti i dërgohet çdo njësie bazë me qëllim marrjen e masave për përmirësime të mundshme në të ardhmen. Gjithashtu, departamentit i diskuton dhe ia komunikon personelit akademik.</p> <p><i>(Dokumenti 1.2 Statuti i UT, 2018; Dokumenti 1.6 Rregullore për sigurimin e cilësive në UT; Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS; Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së NJSBC; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 2.15 Politika e sigurimit të cilësive FSHS)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se formati i raporteve të vlerësimit përfshin të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit.</p> <p><i>(Dokumenti 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në NJSBC në FSHS; Dokumenti 2.18 Analizë vjetore e punës së FSHS)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve




<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Vlerësimi nga NJSBC bëhet në nivel njësie kryesore dhe si i tillë shtrihet në të gjithë programet e studimit dhe nuk hartohen relacione specifike në bazë programi, por nga analiza e përgjithshme secili nga Departamentet përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit evidenton elementët që lidhen me programet specifike. Këto vlerësime janë pjesë e vetëvlerësimeve në kuadër të akreditimit institucional dhe programeve të studimit.</p> <p><i>(Dokumenti 1.6 Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT; Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS; Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së NJSBC; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 2.15 Politika e sigurimit te cilesise FSHS)</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>UT në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies përmes monitorimit të silabuseve nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë, vlerësimit të pedagogëve si dhe përmes vlerësimeve paralele të provimeve apo detyrave të studentëve. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, u konstatua se institucioni për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda e instrumente të ndryshme të tilla si: pyetësori i studentëve, takimet në grup që zhvillohen nga drejtuesi i njësisë bazë. Instrumentat janë të hartuara në mënyrë të tillë që të masin dhe vlerësojnë të gjithë komponentët e programit të studimit.</p> <p><i>(Dokumenti 1.2 Statuti i UT, 2018; Dokumenti 1.6 Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT; Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS; Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së NJSBC; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 2.15 Politika e sigurimit te cilesise FSHS)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e</p>	<p>GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se ndër metodat të drejtpërdrejta të përdorura nga institucioni përfshijnë vlerësimet e drejtpërdrejta nëpërmjet nxjerrjes së statistikave të kalueshmërisë së studentëve, notës mesatare, rishikimit të vazhdueshëm të programeve mësimore si dhe rishikimit të kurikulave në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kërkesat e tregut të punës apo edhe kërkesave të personelit akademik apo studentëve. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë etj. Në këtë kuadër realizohen një sërë masash sic janë mbledhjet e vazhdueshme në</p>

arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.	<p>nivel departmenti, vlerësimi paraprak i provime, raporti përmbledhes nga drejtuesi i njësisë bazë etj.</p> <p><i>(Dokumenti 1.2 Statuti i UT, 2018; Dokumenti 1.6 Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT; Dokumenti 1.11 Manuali i cilesise; Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS; Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së NJSBC; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 2.15 Politika e sigurimit te cilesise FSHS)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni kryen vlerësime periodike ku për çdo semestër realizon vlerësimin me studentët përmes anketimeve; fokus grupe; takime me stafin dhe studentë etj. NJSBC në nivel njësie kryesore është struktura përgjegjëse për realizimin e procesit të vlerësimit. Gjithashtu, në kuadër të vlerësimit, realizimit dhe cilësisë së programit të studimit realizohen dhe monitorohen rezultatet e studentëve në provime, rezultatet e studentëve në realizimin e detyrave të ndryshme gjatë kursit, monitorim gjatë praktikës si dhe monitorimi procesit të mësimdhënies.</p> <p><i>(Dokumenti 1.2 Statuti i UT, 2018; Dokumenti 1.6 Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT; Dokumenti 1.11 Manuali i cilesise; Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS; Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së NJSBC; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 2.15 Politika e sigurimit te cilesise FSHS)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e</p>	<p>FSHS në UT përpiket të parashikojë dhe garantojë politika dhe procedura që sigurojnë rritjen e brendshme të cilësisë, kjo duke përfshirë edhe aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe</p>



<p>aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni garanton dhe bashkëpunon me ekspertë të jashtëm duke ruajtur dhe mbajtur në konsideratë përmirësimin e vazhdueshëm të paramentrave të cilësisë. Për këtë ekzistojnë dhe marrëveshjet e bashkëpunimit.</p> <p><i>(Dokumenti 1.2 Statuti i UT, 2018; Dokumenti 1.6 Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT; Dokumenti 1.11 Manuali i cilesise; Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS; Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së NJSBC; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 2.15 Politika e sigurimit te cilesise FSHS)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se detyrat dhe përgjegjësitë konkrete të palëve të përfshira në çështjet e cilësisë janë të parashikuara në rregulloren e NJSBC. NJSBC përmes aktiviteteve që ndërmer synon të garantojë sigurimin e cilësisë.</p> <p><i>(Dokumenti 1.6 Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT; Dokumenti 1.11 Manuali i cilesise; Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së NJSBC; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 2.15 Politika e sigurimit te cilesise FSHS)</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në përbërjen e grupit të vlerësimit të brendshëm janë të përfshirë anëtarë të personelit akademik dhe studentë. Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë është përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë përmes mbështetjes me informacione dhe akses në të gjitha dokumentat që disponon, grupi i vlerësimit të brendshëm. Personeli ndihmësakademik e administrativ ka mbështetur punën e grupit të vlerësimit të brendshëm përmes informacionit dhe statistikave që lehtësojnë procesin.</p> <p><i>(Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 2.15 Politika e sigurimit te cilesise FSHS)</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>UT, FSHS ka disa standarde të cilat i respekton për përzgjedhjen e anëtarëve në procesin e vlerësimit-NJSBC-së (si: kompetenca profesionale, paanshmëria, përfaqësimi për çdo njësi, rotacioni ...etj). Gjithashtu, edhe përfshirja e studentëve në këtë proces është në funksion të respektimit të integritetit dhe barazisë ndaj personelit dhe studentëve.</p> <p><i>(Dokumenti 1.2 Statuti i UT, 2018; Dokumenti 1.6 Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT; Dokumenti 1.11 Manuali i cilesise; Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS; Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së NJSBC; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 2.15 Politika e sigurimit te cilesise FSHS)</i></p>



<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Përbërja e GVB është e përbërë vetëm nga anëtare të brendshëm të departamentit dhe një student. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm apo bashkëpunëtorëve të ndyshëm, me të cilët departamenti bashkëpunon mund të ishte një mundësi e mirë për marrjen e opinioneve që do të përmirësonin cilësinë e këtij programi studimi.</p> <p><i>(Dokumenti 1.6 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT; Dokumenti 1.11 Manuali i cilësisë; Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS; Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së NJSBC; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS)</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.5</p>	
<p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Bachelor në Psikologji janë transparente. Politikat e institucionit në drejtim të mbështetjes dhe krijimit të lehtësirave në realizimin e një sërë veprimtarish të mbledhjes së informacionit në funksion të realizimit të një procesi korrekt të vlerësimit të brendshëm. Në funksion të trasparencës do të ishin të nevojshme vijimi i praktikës së mirë të nisur si diskutimet me stafin dhe studentët, fokusgrupet e ndryshme, etj. Këto veprimtari do të ndihmonin trasparencën në ndarjen e informacionit me palët e interesuara dhe të përfshira, dhe gjithashtu do të lejonin marrjen e një feedback-u mbi mundësinë e përmirësimit të punës së grupit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit.</p> <p><i>(Dokumenti 1.2 Statuti i UT, 2018; Dokumenti 1.6 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT; Dokumenti 1.11 Manuali i cilësisë; Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS; Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së NJSBC; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion, konstatohet se institucioni është i interesuar të ruajë dhe respektojë të dhënat e privatësisë, lirinë</p>

<p>studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>dhe etikën akademike –profesionale. Duke iu referuar RVB gjetjet e vlerësimit të brendshëm janë transparente dhe bëhen publike duke u hedhur në faqen e FSHS. Raportet janë pasqyruar të plota pa ndërhyrje në shmangien e dajles së të dhënave për personat që janë pjesë e të dhënave që kanë kontribuar në drejtim të mësimdhënies në këtë program studimi këto vite, megjithatë të dhënat personale të stafit akademik japin informacion mbi kualifikimin e titujt që mbajnë dhe nuk ka evidenca që na japin mundësi të gjykojmë mbi cënimin e lirisë për të dhënat personale.</p> <p><i>(Dokumenti 1.2 Statuti i UT, 2018; Dokumenti 1.6 Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT; Dokumenti 1.11 Manuali i cilesise; Dokumenti 1.19 Privatësia në UT; Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS; Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së NJSBC; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 2.15 Politika e sigurimit te cilesise FSHS)</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion, konstatohet se insitucioni sigurohet që raportet dhe rezultatet e vetëvlerësimit të programit përfshijnë edhe të dhëna mbi masat e marra nga planveprimi. Institucioni në këto dokumenta kryen dhe adresimin e masave që duhen analizuar dhe reflektuar. Grupi i vlerësimit të brendshëm ka paraqitur rezultatet e vlerësimit të tij për këtë program studimi. Në përmbyllje të raportit të tij ka një analizë mbi pikat e forta dhe afirmimet dhe pikat e dobëta.</p> <p><i>(Dokumenti 1.11 Manuali i cilesise; Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS; Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së NJSBC; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 2.15 Politika e sigurimit te cilesise FSHS)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>FSHS në UT në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, krijon grupin përmes delegimit të përgjegjësive, strukturave përgjegjëse dhe mbështet punën e grupit përgjatë kryerjes së detyrës. Raporti i vlerësimit të brendshëm të cilësisë pas përfundimit përdoret nga vet institucioni për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit, si dhe ndërmerren reagime nga ana e njësisë bazë në lidhje me pikat e dobëta të evidentuara nga grupi i vlerësimit të brendshëm.</p> <p><i>(Dokumenti 1.11 Manuali i cilesise; Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS; Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së NJSBC; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 2.15 Politika e sigurimit te cilesise FSHS)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në FSHS, GVJ konkludon se institucioni me anë të veprimtarive</p>


<p>periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>periodike si “Open days”, sesione trajnimi të shumta që realizon në fillim të çdo viti akademik, realizon shumë mirë informimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve dhe stafit akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit. Një sërë strukturash të ngritura me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e brendshëm të cilësisë përfshijnë në përbërje të tyre (NJSBC, GVB) staf akademik dhe studentë me qëllimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë si një detyrim që e kërkon baza ligjore në funksion të cilësisë në mësimdhënie si edhe nga rregulloret e UT, FSHS, statuti, etj.</p> <p><i>(Dokumenti 1.2 Statuti i UT, 2018; Dokumenti 1.6 Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT; Dokumenti 1.11 Manuali i cilesise; Dokumenti 2.4 Rregullore e FSHS; Dokumenti 2.13 Përshkrimi i veprimitarisë së NJSBC; Dokumenti 2.14 Rregullore e NJSBC në FSHS; Dokumenti 2.15 Politika e sigurimit te cilesise FSHS)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. UT/FSHS ka një përvojë të gjatë, të konsoliduar dhe vlerësohet si institucion lider në fushën e Arsimit Lartë në Shqipëri;
2. UT/FSHS/DPP që ofron programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, ka projektuar strategji të qarta për zhvillimin institucional, sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, zgjerimin e bashkëpunimeve dhe partneriteteve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe synon ndërkombëtarizimin e programit të studimit të marrë në vlerësim;
3. UT/FSHS ndjek procedura të qarta për rekrutimin e stafit akademik;
4. Stafi akademik që mbulon programin e studimit Bachelor në Psikologji është i kualifikuar me grada e tituj, dhe demonstroi përkushtim për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit



shkencor. Trupa akademike ka përvijë akademike dhe praktike që përshtatet me programin aktual dhe specifiken e lëndëve/moduleve që mbulon në programin e studimit të marrë në vlerësim;

5. FSHS/DPP përgjegjës për programin e studimit të marrë në vlerësim, demonstroi angazhim në projekte ndërkombëtare që mbështesin shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve;
6. FSHS/DPP, ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi në nivel institucional për organizimin dhe përmbushjen e qëllimeve të praktikës profesionale, si dhe veprimtarive të tjera mësimore për realizimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji;
7. UT/FSHS përfshin studentët në procese të ndryshme të ngritjes së cilësisë dhe vendimmarrjes. Struktura përkatëse e sigurimit të cilësisë aplikon vlerësimin periodik të lëndëve/moduleve nga ana e studentëve për të siguruar të dhëna mbi format e mësimdhënies dhe stafin akademik;
8. Infrastruktura fizike e FSHS-së është e përshtatshme për mbarëvajtjen e programit në vlerësim. Klasat janë të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimor;
9. FSHS është abonuar në platforma online dhe shfrytëzon bibliotekat online për nevoja mësimore dhe kërkimore, si EuroPS – Services; Publications | UNRISD; Springer; Journals.Sage Pub; Wiley dhe U-library-COBISS;
10. Studentët janë të kënaqur me klimën positive institucionale dhe ndërveprimin me stafin akademik të angazhuar në program;

b. Pika të dobëta:


1. Mospërputhje përsa i përket koherencës midis dokumenteve rregullatore të Institucionit, si Statuti i UT, Rregullore e UT, Rregullore e ciklit të parë Bachelor në Psikologji (2018) etj; (*Standardi I.2, kriteri 2, 3*)
2. Mospërputhje për disa kategori të veprimtarive formuese të programit të studimit Bachelor në Psikologji, me ngarkesën respektive në kredite të përcaktuara sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; (*Standardi II.1, kriteri 6*)
3. Mosmbulimi në masën 70% i ngarkesës mësimore të programit të studimit nga staf akademik efektiv, përcaktuar sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017, krijon pasiguri në planifikimin e ngarkesës vjetore dhe mund të çojë në zgjidhje të detyrueshme duke angazhuar staf akademik me kontratë, ose duke rritur ngarkesën e stafit efektiv; (*Standardi II.5, kriteri 2*)

Rekomandime:

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.a



1. Të sigurohet koherenca e nevojshme dhe të harmonizohen përcaktimet në dokumentet rregullatore në nivel universiteti, fakulteti, departamenti dhe programi studimor;
2. Të rishikohet rigrupimi i lëndëve në planin mësimor të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, sipas kategorive të veprimtarive formuese (A - E), dhe ngarkesës përkatëse në kredite, në përputhshmëri me aktet nënligjore në fuqi (VKM Nr. 41, datë 24.01.2018);
3. Të korrektohen gabimet teknike në Planin Mësimor lidhur me llogaritjen e totalit të orëve mësimore, si dhe të pasqyrohet në Planin Mësimor informacioni i nevojshëm për formën e kontrollit të dijeve/shlyerjes së lëndëve/moduleve, duke specifikuar lëndët që shlyen me provim (P) dhe lëndët/modulet apo praktika që shlyen me firmë (F);
4. Institucioni të të rekrutojë staf akademik efektiv, për të mbuluar ngarkesën e orëve në auditor mbi masën 70%, në përputhshmëri me aktet nënligjore në fuqi;
5. Të konsiderohet në të ardhmen mundësia për të krijuar një laborator të dedikuar lëndëve me natyrë praktike në fushën e psikologjisë, përfshi edhe laboratorin e informatikës;
6. Të shtohen përpjekjet institucionale për të parashikuar rritje të buxhetit për sigurimin e literaturës së nevojshme në mbështetje të programit të studimit të marrë në vlerësim;

Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor in "Psychology"

a. Strengths and Affirmations:

1. UT/FSS has a long, consolidated experience and is regarded as a leading institution in the field of Higher Education in Albania;
2. UT/FSS/DPP, which offers the first cycle study program Bachelor in "Psychology", has designed clear strategies for institutional development, ensuring the quality of teaching and scientific research, expanding collaborations and partnerships at the national and international level, as and aims at the internationalization of the study program under evaluation;
3. UT/FSS follows clear procedures for the recruitment of academic staff;
4. The academic staff covering the study program Bachelor in "Psychology" is qualified with degrees and titles, also demonstrates commitment to ensuring the quality of teaching and scientific research. The academic staff has academic and practical experience that adapts to the current program and the specificity of the subjects/modules it covers in the study program taken into assessment;
5. FSS/DPP responsible for the study program taken in evaluation, demonstrates engagement in international projects that support the exchange of academic staff and students;





6. FSS/DPP, has implemented a cooperation agreement at the institutional level for the organization and fulfillment of the goals of professional practice, as well as other educational activities for the realization of the first cycle study program Bachelor in "Psychology";
7. UT/FSS involves students in various quality improvement and decision-making processes. The relevant quality assurance structure applies periodic evaluation of courses/modules by students to provide data on teaching methods and academic staff;
8. The physical infrastructure of FSS is suitable for the smooth running of the program under evaluation. The classrooms are equipped with the necessary logistics for the realization of the learning process;
9. FSS is subscribed to online platforms and uses online libraries for teaching and research needs, such as Euro PS - Services; Publications | UNRISD; Springer; Journals. Sage Pub; Wiley and U-library-COBISS;
10. Students are satisfied with the positive institutional climate and the interaction with the academic staff engaged in the program;

b. Weaknesses:

1. Inconsistency in terms of coherence between the Institution's regulatory documents, such as the Statute of UT, Regulations of UT, Regulations of the first cycle study program Bachelor in "Psychology" (2018), etc; (*Standard I.2, criteria 2, 3*)
2. Inconsistency for some categories of formative activities of the study program Bachelor in "Psychology", with the respective load in credits determined according to D.C.M No. 41, dated 24.01.2018; (*Standard II.1, criterion 6*)
3. Failure to cover 70% of the teaching load of the study program by effective academic staff, determined according to D.C.M No. 418, dated 10.05.2017, creates uncertainty in planning the annual workload and may lead to mandatory solutions by engaging academic staff with a contract, or by increasing the workload of effective staff; (*Standard II.5, criterion 2*)

Recommendations:

1. To ensure the necessary coherence and harmonize the definitions in the regulatory documents at the university, faculty, department and study program level;
2. To review the regrouping of subjects in the curriculum of the first cycle study program Bachelor in "Psychology", according to the categories of formative activities (A - E), and the corresponding load in credits, in compliance with the by-laws in force (D.C.M No. 41, dated 24.01.2018);
3. To correct the technical errors in the Curriculum regarding the calculation of the total teaching hours, as well as to reflect in the Curriculum the necessary information for the form of knowledge control/repayment of subjects/modules, specifying the subjects that are completed by exam (E) and subjects/modules or internships that are completed with signature (S);
4. To recruit effective academic staff, to cover the workload of hours in the auditorium above 70%, in compliance with the laws in force;

5. To consider in the future the possibility of creating a laboratory dedicated to practical subjects in the field of psychology, including the computer laboratory;
6. To increase the institutional efforts to foresee an increase in the budget for the provision of the necessary literature in support of the study program taken in the evaluation;

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.a

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Handwritten signature and initials